Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (118). SHKURT 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.


Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

OPINION

Krasitja do t'u rikthejë blireve bukurinë

NGA **SELMAN MËZIU** - FAQE 12

BOTIME

Radika, një vështrim, ekologjik, legjislativ dhe hidrologjik

NGA **TOFIK JEGENI** - FAQE 18

RECENSË

"Shekspiri dhe Kanuni" në studimin e Xhafer Martinit

NGA **FEJZULLA GJABRI** - FAQE 20

ESE

Dua të bëhem doktoreshë si Sashenka Nazifi!

NGA **JERA ISAKAJ** - FAQE 19

Krenari dibrane

NGA **SUELA LALA** - FAQE 19

Skavica trazon Dibrën

Qeveria: Mbi Drin do të ndërtohen dy hidrocentrale

Ministri Gjiknuri: Jo Skavicës me një digë! Banorët në protesta: Nuk lejojmë ndërtimin e asnjë dige mbi Drin. Qeveria nis konsultimet me banorët. Bën publik projektet dhe deklaron nisjen e procesit për HEC-in në Katundin e Ri. Për njërin nga versionet e Skavicës, në kuotat 385 ose 395 metra është duke kërkuar financime sipas modelit partneritet publik-privat. KESH donatori kryesor.

HEC i Skavicës në kuotën 441 metra ka një vëllim ujor prej 2.3 miliardë metër kub dhe parashikohet që investimi t'i kalojë mbi 660 milionë euro. Përmbyten mbi 5800 hektarë tokë dhe zhvendosen mbi 10 000 persona. Qeveria është tërhequr përballë këtij investimi dhe parashikon ndërtimin e një HEC në kuotat 395 metra ose 385 metra. Në kuotën 395 metra, Skavica do të ketë një kapacitet ujor prej 532 milionë m3, ku përmbyten 2210 hektarë dhe zhvendosen 1460 persona. Në kuotën 385 metra vëllimi ujor është 319 milionë m3, përmbyten 1788 hektarë dhe zhvendosen 650 persona. Për sa u përket çmimeve të shpronësimeve, rreth të cilave opinioni publik mendon se është çështja kryesore e mosmarrëveshjeve, një metër katror tokë bujqësore kushton 350 lekë, ndërsa ajo urbane do të kushtojë 5000 lekë.

Speciale në faqet 2,3,9





Aktualitet / Kush po e pengon investimin ne Rrugen e Arbrit

Odiseja 20-vjeçare e Rrugës së Arbrit

Çfarë do të bëhet me Rrugën e Arbërit? Çfarë po ndodh me marrëveshjen? Pse deputeti Hoxha akuzon Kokëdhimën si sabotues të negociatave? Do të jepet rruga me koncension te shoqëria kineze apo qeveria shqiptare do të tërhiqet nga nënshkrimi i marrëveshjes? Kush po e rrit koston e rrugës dhe a kanë dorë nënkontraktorët shqiptarë? Pse u shkarkua Shkëlqim Cani nga posti i Ministrit të Financave? Çfarë roli do të luajë ai në karrigen për të cilën është votuar? Letër deputetëve: Dëshmoni se pavarësisht përkatësisë politike, Ju para së gjithash jeni përfaqësues të denjë të Dibrës. Një historik i shkurtër i Rrugës së Arbrit! Si nisi? Roli i shoqërisë civile, vendimet e ministrave dhe qeverive njëra pas tjetrës. Projekti, problemet, pengesat dhe premtimet e njëpasnjëshme gjatë fushatave elektorale.

Speciale nga Bashkim Lleshi, Hysen Likdisha, Gëzim Alpion, Bujar Karoshi - Faqe 4,5,7

profil

Lulzim Piku, përpunuesi i "arit të bardhë"

Ari i bardhë - kështu e quanin shpesh djathin në Itali, - thotë Lulzim Piku, baxhieri i talentuar nga Maqëllara e Dibrës. Ai shkoi në vendin fqinj si gjithë emigrantët e tjerë, vetëm 19 vjeç, pa pasur ndonjë zanat apo strehë ku të qëndronte. Ishte mjaft energjik dhe besonte se do t'ia dilte mbanë. Rajoni i Puljas, me pesë qytete dhe një popullsi gati sa e Shqipërisë, do të ishte stacioni i ri për djaloshin gjatë kohës që do të qëndronte.

NGA **OSMAN XHILI** - FAQE 6

sport

25 mijë dollarë për ekipin e fëmijëve

Agron Krifca, Burim Fudulli, Gazmend Kërkuti, Mumin Kosovrasti, Zeqo Papraniku, pavarësisht se nuk i lidh asnjë lidhje gjaku me njëri-tjetrin, as fisi, as shoqëria, as partia, i ka bashkuar dëshira për të ndihmuar fëmijët në Dibër, në mënyrë që ata t'i largohen rrugës dhe klubeve dhe të merren me sport.

FAQE 13

kujtese

Ditët e dhimbjes, 9 mars 1996

...Ishte 13 marsi, Nata e Verës, dita që ndan dimrin nga vera, ditë tradicionale që në Dibër fillon me mbledhje lulesh, me vendosjen e tyre mbi portat e shtëpive, me zjarre që flakërojnë tërë krahinën, me rite pagane që rrënjëzojnë në mijëravjeçarë...

NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 10-11

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin
www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

Ministri Gjiknuri: Në këtë model me dy diga, të paktën të japim me partneritet publik-privat një variant i cili nuk ka impakt në kaskadë, pra që quhet pjesa e Katundit të Ri. Ai nuk impakton operacionet normale të KESH-it.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (118). 1 - 29 Shkurt 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Selman MËZIU
Hajri SHEHU
Edmond HASANI
Fejzulla GJABRI
Zaim ELEZI
Marin Mema
Gëzim Alpion,
Dionis Xhafa
Edison BALLA
Mevlud BUCI
Renato TOTRAKU
Beqir SINA
Zabit LLESHI
Metush SKEJA
Jera ISAKAJ
Suela LALA
Rruzhdi BITRI
Halil RAMA
Sakip CAMI
Shemsi MANJANI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Jo Skavicës me **një digë**!

Nga **DAMIAN GJIKNURI**
*Ministër i Energjisë dhe Industrisë**



Nuk pretendoj që i di të gjitha sensibilitetet e zonës, por kam lexuar raporte të ndryshme për sensibilitetet e atyre banorëve. Vlerat që pretendohen për shpronësime janë të tilla që projektin e bëjnë të pamundur. Njerëzit atje do të privohen nga çdo lloj mënyre jetese për të ardhmen duke kërkuar një zhvendosje dhe kompensim. Vlera e tokës mund të shkojë shumë lart dhe projekti shkon në kuadrin e disa miliard dollarëve, që për mua pastaj bëhet utopi.

Njerëzit janë shumë më pak të informuar mbi impaktet që kanë skemat e ndryshme dhe shpeshherë është shumë e kollajshme që të biesh pre e spekulimeve, qoftë edhe me doza patriotike a thua sikur njëra palë po i nënvlerëson interesat kombëtare. Synimi është shumë i thjeshtë. Të bëjmë atë që është e mundshme, që është e realizueshme, në një kohë të arsyeshme.

Në lidhje me sfidat që kemi dhe politikat që kemi filluar të ndjekim për çështjen e Skavicës, ka disa zhvillime që janë bërë publike dhe kanë nxitur debat. Kjo çështje meriton të kuptohet nisur nga interesi për të zhvilluar gjenerimet shtesë dhe kapacitetet. Ka ide të shumta, ka shumë diskutime sesi do të jetë varianti më i mirë i shfrytëzimit të asaj që quhet Skavica apo pjesë e Drinit të Zi.

Një pjesë e tyre janë bërë në një kontekst të caktuar kohor dhe ka qenë një skemë e menduar që në kohën e diktaturës. Skemë që funksiononte ose mendohej që do të funksiononte edhe në mbështetje të politikave të asaj kohe për rritjen e kapaciteteve gjeneruese, rritjen e rezervuarit ose pjesa rregulluese e kaskadës. Por, nga shumë studime, mes të cilave edhe ai i vitit 2009 nga Sogreah por edhe nga konsulentë të tjerë, ka edhe implikime të mëdha mjedisore e sociale të cilat kthehen kosto financiare në ditët e sotme. Ka qenë një sfidë e vërtetë gjetja e zgjidhjes më të pranueshme, një vështirësi për shumë qeveri.

Nga këto studime të cilat janë të pranuara nga autoritetet shqiptare, kanë dalë zgjidhjet më optimale, ato që kanë qenë afër vlerësimit që kosto e marrë justifikon edhe përfitimet. Do të thotë, mbase skema më një digë, me nivelin 445 apo më vonë me 441 është një skemë që mund të krijojë më tepër kapacitet gjenerues si dhe aspektet rregulluese. Por, kostot sociale dhe mjedisore, sipas pikëpamjes sime janë të papërballueshme. Ajo mbetet një ëndërr e bukur, si ato projektet që kanë qindra vjet nëpër botë, diskutohen shumë por është shumë e vështirë të realizohen.

Duhet theksuar se studimi i Sogreah është bërë në vitin 2009, në kushtet kur çmimet e energjisë kanë qenë edhe më të larta. Tregu energjisë ka pasur një rënie vitet e fundit dhe me çfarë po duket edhe në vazhdim, nuk do të ketë ndonjë ngritje të çmimeve të energjisë, të tregtimit me shumicë të energjisë. Sot në rajon dhe në Europë ato kanë vajtur edhe në 30 euro mega. Nuk po marr rastin e Gjermanisë apo vende të tjera, por edhe në rajon po të shikojmë bursën, kemi çmim mesatar jo më shumë se 42-43 euro. Kjo e bën projektin akoma më pak fizibël nisur nga kostot që janë parashikuar, për atë që quhej diga e madhe dhe që krijonte një rezervuar të madh, me impakt shumë rregullator. Për mendimin ky version është pafinancueshëm. Me shumë specialistë ka pasur diskutime sesi do të ishte forma më e mirë e partnershipit për të zhvilluar kapacitetet e Drinit të Zi. Ka pasur një interes që shteti, po të themi Korporata Eletroenergjetike Shqiptare të kishte rolin kryesor në menaxhimin e kësaj kasakade. Do të thotë që shteti duhet të ishte ai që duhet të garantonte nëpërmjet Korporatës bërjen e këtij investimi. Një investim i cili do të kërkonte miliarda dollarë dhe me këto kosto të mëdha social-mjedisore siç janë zhvendosja e 10 mijë njerëzve, shpronësime që të themi të drejtën nuk janë çështje e kollajshme.

Nuk pretendoj që i di të gjitha sensibilitetet e zonës, por kam lexuar raporte të ndryshme për sensibilitetet e atyre banorëve. Vlerat që pretendohen për shpronësime janë të tilla që projektin e bëjnë të pamundur. Njerëzit atje do të privohen nga çdo lloj mënyre jetese për të ardhmen duke kërkuar një zhvendosje dhe kompensim. Vlera e tokës mund të shkojë shumë lart dhe projekti shkon në kuadrin e disa miliard dollarëve, që për mua pastaj bëhet utopi.

Janë këto sfida që e kanë mbajtur këtë potencial, për mendimin tim të pazhvilluar dhe që është një potencial i mirë energjetik. Ne kemi ndërmarrë një iniciativë nisur nga modeli më i pranueshëm. Të tillë e konsiderojmë shfrytëzimin me dy diga për të cilin do të bëhet edhe prezantimi këtu. Në këtë model me dy diga, të paktën të japim me partneritet publik-privat një variant i cili nuk ka impakt në kaskadë, pra që quhet pjesa e Katundit të Ri. Ai nuk impakton operacionet normale të KESH-it.

Pjesa e sfidës lidhet me financimin e Skavicës. Qëllimi i këtij takimi me donatorët ka qenë që nëpërmjet KESH të kërkojmë një asistencë, një konsulencë, një mbështetje financiare. Mendojmë që KESH-i në të ardhmen do të jetë një ndërmarrje shumë më fitimprurëse nisur nga liberalizimi i tregut të energjisë, detyrimi më i vogël që do të ketë ndaj konsumatorëve të rregulluar. Do të thotë që do ti optimizojë më mirë burimet e saj dhe do të ketë të ardhura të cilat mund ta bëjnë të mundur financimin e kësaj vepre nëpërmjet KESH-it, në një formë që do të jetë e pranueshme nga ana ekonomike. Patjetër, kjo do një studim më të detajuar fizibiliteti, që i ka munguar deri tani. Të jetë e mundur që KESH-i të marrë rolin dhe për të përcaktuar përfundimisht kush do të ishte të paktën tek këto nivelet e digave 395 apo 385? Ato nuk kanë ato implikimet e mëdha mjedisore apo sociale që dalin nga të dyja studimet si nga Sogreas, ashtu edhe nga një vlerësim që i ka bërë një konsulent i IFC-së. Kjo mund të ketë rol më të vogël rregullator, po do ketë kapacitet shtesë gjenerues, do të plotësojë nevojat e KESH-it edhe për energji. Unë mendoj se ky investim do ta lajë veten duhet shtuar prodhimin e mëtejshëm të Korporatës Elektroenergjetike dhe mundësinë që ata kanë për të tregtuar më shumë energji edhe në kuadrin e një politike tashmë të liberalizuar të tregut të energjisë.

Zhvillimet e kohës kërkojnë hapje, çlirimin e korporatës nga detyrimet publike që ka pas. Ky është një trend që po shkon në të gjithë Europën Juglindore dhe në Bashkimin Europian tashmë kjo është një normë, është mënyra sesi funksionojnë.

ÇFARË KA NDODHUR ME KATUNDIN E RI?

Është dhënë një bonus për një propozim të pakërkuar. Nuk është shpallur gara akoma. Gara do të jetë transparente dhe kompetitive për çdo kompani që është e interesuar. Nga vlerësimet që kanë bërë komisionet përkatëse, kemi patur si objektiv që të mos ketë një impakt në operacionet e KESH-it poshtë dhe pa impaktuar atë që quhet projekti i Skavicës, por jo më ajo e madhja. Jo më Skavica e madhe, por pjesa çfarë mbetet e Skavicës dhe këtu është synimi jonë që ta atraktojmë. I jemi drejtuar zyrtarisht institucioneve financiare në mënyrë që të detajojmë edhe mundësinë e një konsulence për të avancuar në këtë drejtim. Unë besoj se në krye të 2-3 viteve, korporata do të jetë në një gjendje shumë më të mirë financiare dhe jam i bindur që mund të gjejë një partnership që edhe ta financoj vet. Kuptohet nëpërmjet financimit të institucioneve financiare por që japin garanci për shlyerjen e këtij investimi dhe që investimi bëhet i pranueshëm.

Njerëzit janë shumë më pak të informuar mbi impaktet që kanë skemat e ndryshme dhe shpeshherë është shumë e kollajshme që të biesh pre e spekulimeve, qoftë edhe me doza patriotike a thua sikur njëra palë po i nënvlerëson interesat kombëtare. Synimi është shumë i thjeshtë. Të bëjmë atë që është e mundshme, që është e realizueshme, në një kohë të arsyeshme. Mund të kesh projekte që mund ti kesh si ëndrra edhe 50 apo 100 vjet të tjera por nuk do bësh ndonjë gjë. Koha kërkon investime, koha kërkon kapacitete shtesë gjeneruese dhe të gjitha këto kapacitete në funksion të një modeli ekonomik të qëndrueshëm. Modeli ynë ekonomik i energjisë, e thënë troç dështoi. Ne patëm krizën më të madhe që ka patur ndonjëherë Shqipëria në energji. Jo për shkak të mungesës së energjisë por për shkak të modelit ekonomik që u ngrit në vitin 2012-2013. Shyqyr gjërat që atëherë kanë filluar të marrin për mirë por që janë sfida të mëdha të cilat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Kuptohet, në një kuadër tjetër rregullator, i cili do të harmonizojë sesi investimet private do të jenë të qëndrueshme dhe ku shteti të marrë sa më pak risqe.

Është një lloj ekuacioni me disa variabla të cilët duhet të gjesh një ekuilibër në mënyrë që ta bëjë këtë funksional. Ky është qëllimi ynë, prandaj duam asistencën, konsulencën, që pikërisht të bëhet e mundur sesa fizibël është nga ana e KESH-it ky kapacitet shtesë dhe çfarë financimesh mund të mobilizojmë. Sa fizibël do të ishte si projekt dhe që realisht edhe qeveria shqiptare në këtë rast mund të merrte ndonjë risk, gjithmonë në funksion të politikave të saj energjetike.

** Fjalë e mbajtur në takimin me donatorët. Botohet me shkurtime.*
Redaktoi: B.Karoshi

HEC i Skavicës në kuotën 441 metra ka një vëllim ujor prej 2.3 miliardë metër kub dhe parashikohet që investimi t'i kalojë mbi 660 milionë euro. Përmbyten mbi 5800 hektarë tokë dhe zhvendosen mbi 10 000 persona. Qeveria është tërhequr përballë këtij investimi dhe parashikon ndërtimin e një HEC në kuotat 395 metra ose 385 metra. Në kuotën 395 metra, Skavica do të ketë një kapacitet ujor prej 532 milionë m3, ku përmbyten 2210 hektarë dhe zhvendosen 1460 persona. Në kuotën 385 metra vëllimi ujor është 319 milionë m3, përmbyten 1788 hektarë dhe zhvendosen 650 persona.

Skavica trazon Dibrën. Qeveria: Mbi Drin do ndërtohen edhe dy hidrocentrale

Nga **BUJAR KAROSHI**

Hidrocentrali i Skavicës vazhdon të mbetet në qendër të debatit mes opinionit publik dhe qeverisë. Ndërsa në terren, atje ku uji do të mbulojë qindra hektarë tokë dhe mijëra banorë të tjerë do të zhvendosen, pasiguria është rritur dhe protestat sapo kanë filluar. Një prej tyre e zhvilluar në Katund të Ri nën udhëheqjen e opozitës dhe një tjetër në Maqellarë, nuk kanë mundur që çështjen ta bëjnë të ndjeshme për publikun e gjerë. Ndërkohë që priten protesta të tjera, qeveria shqiptare ka filluar të lëvizë në drejtim të sqarimit të çështjes dhe gjetjen e mundësive për financimin e së paku dy projekteve energjetike, njëra i quajtur Skavicë në dy versione, në kuotat 395 ose 385 metra, dhe hidrocentrali i Katundit të Ri në kuotat e pandryshuar 445 metra.

Banorët që kanë marrë pjesë në protestat e Katundit të Ri dhe Maqellarës janë kundër ndërtimit të çfarëdolloj hidrocentrali, pavarësisht emërtimit Skavicë e madhe apo e vogël apo Katund të Ri. Të protestuesit vihet re një ngatërresë te emërtimi, pasi protestojnë në Katund të Ri dhe kundërshtojnë Skavicën. Në pamje të parë duket se ata janë të interesuar vetëm për detajet e shpronësimeve dhe zhvendosjeve të banorëve, por në fakt, përfaqësues të tyre janë kundër ndërtimit të çfarëdolloj dige tjetër mbi lumin Drin.

Më 21 shkurt, Ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Bashkinë e Dibrës organizuan takimin e parë konsultativ në formën e dëgjesës publike mbi ndërtimin e "HEC Katund i Ri". Takimi u zhvillua në një klasë shkolle, ku zëvendësministri Ilir Bejtja informoi qytetarët në lidhje me projektidenë për ndërtimin e hidrocentralit të Katundit të Ri, çfarë parashikon ky investim prej mbi 100 milionë eurosh dhe impakti ekonomik që do të ketë në zonë, pa pasoja të mëdha social-mjedisore.

"Kemi parë të gjitha mundësitë se si mund të zhvillohet nga pikëpamja energjitike pjesa e sipërme e Drinit përmbi Fierzë. Nga të gjitha, i vetmi segment që na ka rezultuar i mundshëm për t'u bërë me shumë pak dëme, por me përfitime për zonën si në punësim, ashtu edhe nga pikëpamja e balancimit të energjisë, furnizimit me cilësinë e duhur të energjisë elektrike është Katundi i Ri", - citohet të ketë thënë Bejtja në një deklaratë të shpërndarë nga zyra e shtypi e Ministrisë.

Sipas zëvendësministrit, elementi më i rëndësishëm në gjithë këtë propozim apo proces është dëgjesa me njerëzit të cilët direkt do të preken. Si të zgjidhen këto probleme me ndihmën e pushtetit lokal, me ndihmën e qeverisë qendrore, pa shkaktuar asnjë dëm, i cili do të përkeqësojë situatën në raport me atë çka është sot. Z.Bejtja ka theksuar se procesi po vëzhgohet nga konsulentë të BERZH dhe do të respektohen të gjitha standardet e transparencës për projekte të tilla, duke qenë edhe një shembull se si qeveria do të veprojë në të ardhmen.

Deklarata e Ministrisë së Energjisë thekson se përfaqësuesit e saj iu përgjigjën të gjitha shqetësimeve të banorëve, por përfaqësues nga shoqata për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi u ankuan se takimi nuk ka qenë i hapur dhe se në takim kanë qenë banorë që nuk preken direkt nga përmbytjet.



Kuotat e rezervuarit të HEC të Skavicës në kuotën 395m dhe HEC i Katundit të Ri në kuotën 445 m.

Megjithatë, Ministria ka njoftuar se një takim tjetër konsultativ do të zhvillohet gjatë muajit mars dhe për t'i paraprirë kësaj, në Peshkopi, më 5 mars do të mbahet një takim konsultativ mes anëtarëve të shoqërisë civile, me të cilët do të diskutohet se si do të vazhdojë në të ardhmen procesi i mbrojtjes së Luginës së Drinit të Zi.

DALIN DETAJET E PARA MBI PROJEKTET E SKAVICËS DHE KATUNDIT TË RI

Në fillim të shkurtit Ministria e Energjisë dhe Industrisë zhvilloi një takim me donatorë, ku dha informacione për projektet e saj në drejtim të investimeve në Kaskadën e Drinit të Zi. Ministri Damian Gjiknuri mbajti një fjalim (të cilin e gjeni të botuar në këtë numër), ku vuri theksin në pamundësinë financiare për ndërtimin e Skavicës sipas projektit të kohës së komunizmit, dhe theksoi qëndrimin e qeverisë shqiptare për të vazhduar financimin e dy hidrocentraleve të tjera mbi Drin, Skavicën në kuotat 395 metra ose 385 metra, si dhe hidrocentralin në Katund të Ri në kuotat 445 metra.

Agim Bregasi, drejtor i Politikave të Zhvillimit Ekonomik pranë kësaj Ministrie, theksoi se qeveria shqiptare, për vlerësimin e potencialit hidroenergjetik të Drinit, në bashkëpunim me Bankën Botërore kanë kontaktuar një shoqëri të huaj të specializuar për të bërë vlerësimin. Sipas saj, SOGREAH- shoqëria franceze, në vitin 2009, bazuar në analizën e të dhënave meteorologjike, hidrologjike, gjeologjike, mjedisore, ka bërë vlerësimin e potencialit energjetik të pashfrytëzuar mbi Drin. Ajo ka bërë vlerësimin e kostove për të gjitha versionet, si dhe vlerësimin paraprak mjedisor, duke arritur në konkluzionin se Skavica në kuotat maksimale 441 metra është me kosto të mëdha financiare, mjedisore dhe sociale dhe si i tillë është i pafinancueshëm.

Shoqëria franceze ka studiuar dy versionet e tjera të Skavicës. Në kuotën 385 metra, Skavica do të ketë një kapacitet ujor prej 319 milionë m3, me një fuqi të instaluar prej 119 MW, dhe kapacitet vjetor prodhimi prej 467 GWh. Në këtë kuotë sipërfaqja e përmbytur do të jetë 1788 hektarë dhe do të zhvendosen 650 persona.

Në kuotën 395 metra, Skavica do të ketë një kapacitet ujor prej 532 milionë m3, me një fuqi të instaluar prej 132 MW, dhe kapacitet vjetor prodhimi prej 488 GWh. Në këtë kuotë sipërfaqja e përmbytur do të jetë 2210 hektarë dhe do të zhvendosen 1460 persona.

Pavarësisht se cili variant i Skavicës do të përzgjidhet, HEC i Katundit të Ri do të ndërtohet në një kuotë 445 metra. Do të ketë një kapacitet ujëmbledhës prej 12.4 milionë metër kub, me një fuqi të instaluar prej 49 MW dhe prodhim vjetor prej 206 GWh. Ky hidrocentral do të përmbytë vetëm 87 hektarë tokë dhe do të zhvendosë nga banesat e tyre 150 persona.

Vlera e Investimit e HEC të Katundit të Ri do të jetë 99.5 milionë euro dhe sipas shoqërisë franceze, ndërtimi i tij është shumë efektiv.

Për sa u përket çmimeve të shpronësimeve, rreth të cilave opinioni publik mendon se është çështja kryesore e mosmarrëveshjeve, projekti, bazuar në çmimet e tregut në vitin 2008 - pra rreth 8 vite më parë, ka arritur në përfundimin se një metër katror tokë bujqësore kushton 350 lekë, ndërsa ajo urbane do të kushtojë 5000 lekë.

Qeveria shqiptare, ndërkohë që është duke kërkuar këshilla dhe mbështetje financiare për njërin nga versionet e Skavicës, duket e vendosur të vazhdojë procesin për Katundin e Ri. Pavarësisht se konsultimet publike sapo kanë filluar, në terren janë parë punonjës, të cilët i kanë vënë shenjat e piketimeve dhe së shpejti një tender, që duket se do të jetë formal, do të zhvillohet. Qeveria i ka dhënë një bonus një bashkimi shoqërish turke, e cila pritet të jetë edhe fituese e projektit.

Banorët në protesta kanë kundërshtuar veprimet e qeverisë në këtë drejtim, pasi ata nuk janë të qartë se çdo të bëhet me pronat dhe banesat e tyre. Ndërkohë që Katundi i Ri mundet të vazhdojë procesin, frika e tyre është se qeveria në të ardhmen do të vazhdojë edhe me Skavicën. Vlera e investimit për Skavicën mund të jetë mbi 350 milionë euro, të cilat qeveria shqiptare për momentin nuk i ka, por në të ardhmen edhe mund të gjenden. Aktualisht në shtyp po flitet se Qeveria po vazhdon gabim me hidrocentralin e Katundit të Ri, pas Shqipërisë i duhet një Skavicë në kuotat maksimale, për të cilat thuhet se janë së paku tre shoqëri kineze të gatshme për ta financuar, version të cilin banorët janë kundër kategorikisht. Por kur vendimi të mbetet në dorën e tyre, Drini (lumi) do t'i ketë marrë me vete të gjithë...

Banorët në protesta: Nuk lejojmë ndërtimin e asnjë dige mbi Drin. Qeveria nis konsultimet me banorët. Bën publik projektet dhe deklaron nisjen e procesit për HEC-in në Katundin e Ri. Për njërin nga versionet e Skavicës, në kuotat 385 ose 395 metra është duke kërkuar financime sipas modelit partneritet publik-privat. KESH donatori kryesor.

Për sa u përket çmimeve të shpronësimeve, rreth të cilave opinioni publik mendon se është çështja kryesore e mosmarrëveshjeve, projekti, bazuar në çmimet e tregut në vitin 2008 - pra rreth 8 vite më parë, ka arritur në përfundimin se një metër katror tokë bujqësore kushton 350 lekë, ndërsa ajo urbane do të kushtojë 5000 lekë.



Kuotat e rezervuarit të HEC të Skavicës në kuotat 385m, 395m dhe nivelin maksimal prej 441m.





Majtas, një faqe e hapur në rrjetet sociale që bën thirrje për të ndaluar ndërtimin e HEC të Skavicës dhe Katundit të Ri. Administratorët shkruajnë rreth faqes: "Ti themi të gjithë një zëri JO Katundit të Ri dhe Skavicës. Dibrën nuk e përçanë as Krajli e as Sulltana, nuk e mbyt dot Edi Rama."
Foto lart: Zyrtarë të MEI dhe përfaqësue të një zyre konsulente të huaj gjatë një vëzhgimi në terren (foto marrë nga faqja në FB *"Po Dibres Jo Skavices"*

Rruga e Arbërit nr. 118
kryesore

Një historik i shkurtër i Rrugës së Arbrit! Si nisi, roli i shoqërisë civile, vendimet e ministrave dhe qeverive njëra pas tjetrës. Projekti, problemet, pengesat dhe premtimet e njëpasnjëshme gjatë fushatave elektorale. Pse pengohet projekti herë pas here dhe shpresat e mëdhaja për koncensionin kinez. Një historik i shkurtër të përpjekjeve të anëtarëve të shoqërisë civile për ndërgjegjësimin e organeve vendimmarrëse, që nxjerr në pah mungesën e transparencës nga qeveritë shqiptare të tranzicionit...

Odiseja 20-vjeçare e Rrugës së Arbrit

Nga **BASHKIM LLESHI**

Udeshën mbi 10 vite përpjekje të shumë intelektualëve dibranë, të Shoqatave "Nisma Dibrane" në Peshkopi, "Bashkësia Dibrane" në Tiranë e "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe nga viti 1992, deri sa në fund të vitit 2002 u planifikua kryerja e studimit të fizibilitetit të Rrugës Tiranë-Dibër brenda vitit 2003.

Në këto përpjekje duhet veçuar sidomos kontributi i Shoqatës "Nisma Dibrane" me kryetar Iljaz Kacën, zevendës kryetar Hysen Ukën e Bujar Karoshin të cilët ishin nismëtarët e organizimit të intelektualëve e studjuesve të shumtë dibranë që i dërguan letra Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Ministrit të Ndërtimit e Turizmit, Ministrit të Mbrojtjes, Deputetëve të Dibrës, Prefektit dhe Institutit të Studimit e Projektimit të Rrugëve, ku me fakte argumentonin domosdoshmërinë e hapjes së kësaj rruge. Letra e 40 intelektualëve dibranë u botua në gazetën "Dita" (Bujar Karoshi 11 janar1996) dhe konfirmimi se kjo letër u muar në konsideratë nga Drejtoria e Rrugëve u botua në gazetën "Albania" (Bujar Karoshi 17 shkurt 1996).

Në janar të vitit 1998 përsëri Përfaqësia e grupit sensibilizues të intelektualëve dibranë nëpërmjet një letre i drejtohen deputetit të Dibrës zotit Paskal Milo për të ndërhyrë pranë organeve të larta qeveritare për ndërtimin e kësaj rruge.

Një rol të rëndësishëm për sensibilizimin e opinjonit qytetar e atij shtetëror për Rrugën e Arbërit ka luajtur edhe gazeta "Dibra" me botues Fatos Dacin e cila që në maj të vitit 1998, në numrin e dytë të saj, botoi letrën e Grupit sensibilizues të intelektualëve dibranë drejtuar deputetëve të Dibrës e Bulqizës për ndërtimin e rrugës Tiranë-Dibër. Edhe në numrat e saj të mëvonshëm kjo gazetë ka ngritur vazhdimisht probleme me shkrimet e saj për këtë rrugë.

Në vitin 2000 Shoqata "Nisma Dibrane" në bashkëpunim me Prefekturën e Dibrës ngritën një grup pune të përbërë nga: Muharem Kola, Iljaz Kaca, Hysen Uka, Flamur Bulku, Ramadan Bunci, Qemal Koçi, Nexhat Hysa, Pëllumb Dervishi e Robert Lami, të cilët pasi shkelën më këmbë rrugën nga Qafa e Buallit, Guri i Bardhë, Qaf Murrizë, Zall Dajt, Tiranë, përpiluan një Relacion teknik për Rrugën automobilistike Dibër – Tiranë në trasenë e Rrugës së Arbërit (Rruga e Dibrës). Në këtë relacion jepeshin edhe volume gërmimesh, propozohej për kalimin e Qaf Murizës me tunel, propozoheshin vepra arti, etj. dhe shoqërohej me një hartë topografike në shkallë 1: 100 000 ku ishte hedhur dhe aksi nga do të kalojë rruga Dibër–Tiranë. Po këtë vit Hysen Uka e Bujar Karoshi përgatitën Posterin "Rruga e Dibrës çelësi i të ardhmes sonë" dhe një fletë palosje për sensibilizim dhe njohje të opinjonit lidhur me leverdinë e hapjes së kësaj rruge. Në faqen e parë të kalendarit të vitit 2003 shkruhet "Viti 2003 vit i rrugës së Arbërit", ndërsa në kalendarët e viteve 2004 deri në 2008 me ide e botim të Hysen Ukës e Bujar Karoshit, pamjet kryesore i kushtohen Rrugës së Arbrit. (Bujar Karoshi, Hysen Uka 2003-2008)

Në tre mujorin e parë të vitit 2002 unë përgatita një Relacion "Mbi hapjen e Rrugës së re që lidh Tiranën me Matin e Dibrën" të shoqëruar me një hartë dhe një tabelë ku argumentohej se pse duhet filluar sa më parë puna për ndërtimin e kësaj rruge. (Bashkim Lleshi prill 2002). Këtë relacion ia dërgova Ministrit të Mbrojtjes Luan Rama edhe në cilësinë si deputet i qarkut të Dibrës (rrethi i Matit) më 20 prill 2002 dhe Ministrit të Transporteve Maqo Lakrori, Drejtorit të Përgjithshëm të rrugëve, Prefektit të Dibrës e kryetarëve të komunave nga kalon kjo rrugë, më 2 maj të vitit 2002. (Bashkim Lleshi 20 prill 2002, 2 maj 2002). Asnjë nga këto institucione nuk e mori mundimin as të pyesë për këtë relacion, përveç Hysen Ukës, i cili e kishte lexuar në zyrën e kryetarit të Bashkisë së Peshkopisë dhe menjëherë erdhi në Tiranë e mori takim me mua ku më njoftoi edhe për përpjekjet e tyre e të Shoqatës "Nisma Dibrane" disa vite më parë e në vazhdim për problemin e kësaj rruge.

Më 30 maj 2002 këtë relacion ia dërgova Studios "Ifratransprojekt Ltd" ndërsa me ndryshimet që u bënë në qeveri në shtator 2002 ua dërgova edhe ministrave Pandeli Majko (Ministër i Mbrojtjes) e Spartak Poçi (Ministër i Transporteve) më 12 shtator 2002. (Bashkim Lleshi 30 maj, 12 shtator 2002).



Punimet në Rrugën e Arbërit, maj 2008. (Foto arkiv: Hysen Uka)

Akullin e heshtjes qeveritare për gati 10 vite të përpjekjeve të intelektualëve e shoqatave dibrane e theu ministri Spartak Poçi i cili mbështetur në këtë relacion i kërkoi Studios "Infratransproject Ltd' të përgatisë një relacion më të detajuar të shoqëruar me një hartë topografike në shkallë 1:25 000 të cilën e përgatita unë së bashku me zotin Faruk Kaba dhe e dërguam në ministri më 24 tetor 2002. (Faruk Kaba, Bashkim Lleshi 24 tetor 2002)

Mbi bazën e këtij Relacioni me ndërhyrjen e ministrit Poçi u planifikua kryerja e Studimit të Fizibilitetit të Rrugës së Arbërit për vitin 2003 detyrë e cila i'u ngarkua Studios "Infratransproject Ltd". Brenda vitit 2003 u krye Studimi i Fizibilitetit i cili u miratua në Këshillin Teknik të Drejtorisë së Përgjithëshme të Rrugëve më 13 nëntor 2003 dhe në Këshillin Kombëtar të Rrugëve në korrik të vitit 2004. Unë isha në përbërjen e grupit të Studimit të Fizibilitetit ku përgatita "Studimin gjeologo inxhinjerik të rrugës Tiranë-Dibër , Rruga e Arbërit në fazën e skicidesë" (Bashkim Lleshi prill 2003) dhe "Raportin gjeologo-inxhinjerik mbi kushtet gjeologo-inxhinjerike dhe gjeoteknike të rrugës Tiranë-Dibër" (Bashkim Lleshi Gusht 2003). Kështu u hap drita jeshile për fillimin e projekteve të zbatimit dhe fillimin e punimeve të ndërtimin për Rrugën e re të Dibrës. Me gjithatë në vitet 2004 e 2005 përveç premtimeve asgjë nuk u planifikua për t'u kryer.

Edhe gjatë vitit 2003 Shoqatat "Nisma Dibrane" në Peshkopi, "Bashkësia Dibrane" në Tiranë e "Votra Dibrane " në Tiranë vazhduan sensibilizimin e opinjonit shtetëror e qytetar për fillimin sa më shpejt të ndërtimit të Rrugës së Arbërit, pas përfundimit të Studimit të Fizibilitetit. Më 5 korrik të vitit 2003 Shoqata "Bashkësia Dibrane" në Tiranë organizoi një takim me intelektualë, deputetë, studjues e qytetarë dibranë të Shqipërisë e Maqedonisë ku pjesëmarrësit u njohën me kumtesat e studjuesve Valter Shtylla e Faruk Kaba për "Rrugën e vjetër të Dibrës" dhe për ecurinë e Studimit të Fizibilitetit. Një takim i tillë u organizua edhe nga Shoqata "Votra Dibrane" më 09 nëntor 2003 në Dibër të Madhe ku nga grupi i punës i Studimit të Fizibilitetit muarën pjesë Faruk Kaba e Bashkim Lleshi të cilët referuan mbi punën për përfundimin e këtij studimi. Në këtë takim muarën pjesë edhe ministrat e Transporteve të Shqipërisë Spartak Poçi e Astrit Baxhaku dhe shumë drejtues të tjerë shoqatash e institucionesh vendore të Tiranës, Dibrës së Madhe e Peshkopisë. Me gjithë këto përpjekje me gjithëse në maj të vitit 2004 nga ish qeveritarët socialistë në pushtet u planifikua të bëhej tenderi për fillimin e projekteve të zbatimit të kësaj rruge, i cili nuk u krye, kështu që për vitin 2004 asgjë nuk u planifikua për Rrugën e Arbërit.

Për të thyer heshtjen e qeveritarëve në prill të vitit 2004 në gazetën "Dibra" u botua artikulli: "Nuk ka pengesa për financimin e Rrugës së Arbërit. Ka përfunduar Studimi i Fizibilitetit" (Bashkim Lleshi prill 2004)

Erdhi viti 2005, viti i zgjedhjeve paramentare. Fushata e zgjedhjeve të 3 korrikut ishte fushata e katërt parlamentare e vendore ku elektoratit dibran si premtim kryesor i është bërë ndërtimi i Rrugës së Arbrit. Përsëri liderët e dy partive kryesore filluan premtimet e tyre se me të fituar zgjedhjet do të fillojnë nga puna për ndërtimin e rrugës. Lideri i së djathtës, Sali Berisha në mitingjet e mbajtura në Peshkopi theksonte se: "Ju jap fjalën e nderit se po të fitojmë do t'a ndërtojmë Rrugën e Arbrit", ndërsa lideri i së majtës Fatos Nano theksonte se: "Këtë rrugë e kam në axhendën time". Në fund të muajit qershor 2005, 4 ditë para zgjedhjeve të korrikut ish kryeministri Nano vendosi një tabelë dhe preu një shirit të fillimit të punimeve të kësaj rruge, në dalje të Bulqizës, në afërsi të Gurëve të Skënderbeut, duke u tallur me komunitetin dibran brenda e jashtë vendit, sepse jo vetëm se punimet pas një muaji u ndërprenë, por edhe se aksi i rrugës sipas Studimit të Fizibilitetit të miratuar po nga Kryeministri në Këshillin Kombëtar të Rrugëve duhet të kalonte në anën tjetër të luginës në drejtim të lagjes Dragun.

Zgjedhjet e vitit 2005 i fitoi e djathta dhe për fatin e dibranëve ministër transporti u emërua një anëtar i komunitetit dibran, Lulzim Basha. Meqënëse nga korriku në tetor ra heshtja për këtë rrugë, premtimet se do të fillohet menjëherë pas zgjedhjeve puna për rrugën u harruan, më 26 tetor 2005 i dërguam një letër ministrit të transporteve Basha së bashku me një kopje të shkurtuar të Studimit të Fizibilitetit me shpresën që jo vetëm si ministër por edhe si anëtar i komunitetit dibran do të lëvizte për këtë rrugë, (Bashkim Lleshi 26 tetor 2005) por përsëri asnjë reagim, duke u mbyllur kështu në heshtje edhe viti 2005.

Një shtytje të mëtejshme për njohjen dhe leverdinë e hapjes së kësaj rruge ka dhënë krijimi i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe organi botues i saj me emrin "Rruga e Arbërit" në maj të vitit 2006. Që në numrin e parë të kësaj gazete u ribotua artikulli i prefektit të Dibrës Xhafer Seiti, "Rruga e Arbërit integron jo vetëm Dibrën", marrë nga gazeta "Shqip" ku shtrohet si domosdoshmëri ndërtimi i kësaj rruge që me të drejtë zoti Seiti thekson se: "Integron jo vetëm Dibrën". Megjithëse jo dibran ai gjatë gjithë kohës që ishte në Dibër dhe më vonë nuk heshti së ngrituri, problemin e ndërtimit të kësaj rruge në organet më të larta shtetërore.

Për të prishur heshtjen e qeveritarëve që kishin premtuar se me të fituar zgjedhjet do të fillonte rruga, në numrin e dytë të kësaj gazete u botua artikulli: "Pushtetarë dhe opozitarë, edhe sa kohë do të vazhdoni të mos e mbani premtimin e dhënë për ndërtimin e Rrugës së re të Dibrës, Rrugës së Arbërit" ?.(Bashkim Lleshi qershor 2006)

Në numrin 3 të kësaj gazete përsëri shkruan prefekti Seiti : "Rruga e Arbërit do ndërtohet por kam dëshirë t'a ndërtojë qeveria që përfaqësoj" . (Xhafer Seiti korrik 2006) Ndërsa në numrat 4 e 6 të saj shkruhen artikujt : "Rruga e Arbërit, rrugë kryesore e vendit krahas rrugës Egnatia që në lashtësi", (Bashkim Lleshi gusht 2006) dhe "Rruga e Arbrit i shërben edhe zhvillimit të turizmit malor dhe njohjes së mëtejshme të historisë". (Bashkim Lleshi tetor 2006)

Duke parë se edhe viti 2006 po mbyllej në heshtje, në nëntor 2006 Kryesia e Shoqatës "Lidhja e Intelekrtualëve dibranë" e drejtuar nga Profesori i shquar dibran Nuri Abdiu vendosi të organizojë një Kuvend Shkencor për Rrugën e Arbërit. Kështu filluan menjëherë përgatitjet, u ngrit komisioni organizues dhe ai tekniko-shkencor, e u tërhoqën mendimet për referatet e kumtesat brenda vitit 2006.

Në shkurt 2007në gazetën "Rruga e Arbërit" u botua artikulli i diplomatit Abdi Baleta "Sali Hapi dy arteret koronare të Shqipërisë" marrë nga gazeta "Rimëkëmbja" ku përshkruan rëndësinë shumë të madhe që kanë për Shqipërinë ndërtimi i këtyre dy akseve rrugore. (Abdi Baleta shkurt 2007) Në shkurt të vitit 2007 gjeologu i apasionuar dibran Prof.As.Dr. Vesel Hoxha boton artikullin "Rruga e Arbërit, rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore" ku përshkruan me hollësi për lexuesit e gazetës Rruga e Arbërit, pasuritë e njohura nëntokësore e mbitokësore të kësaj treve që do të vihen në lëvizje me ndërtimin e kësaj rruge. (Vesel Hoxha shkurt 2007), ndërsa gjeologu i vjetër e me eksperiencë matjan Msc. Ing. Agim Shenjatari në mars 2007 informon lexuesit për pasuritë minerale të rrethit të Matit dhe zhvillimin që do të marrin ato me ndërtimin e Rrugës së Arbërit. (Agim Shanjatari mars 2007)

Më 26 maj 2007 u organizua në Tiranë Kuvendi Tekniko për Rrugën e Arbërit. Në këtë kuvend u referuan me nivel të lartë shkencor këto materiale: Rruga e Arbërit, rruga kryesore e vendit, krahas Rrugës Egnatia që në lashtësi (Valter Shtylla), Studim për mundësinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit (Përmbledhje e studimit të fizibilitetit) nga studjoja "Infratransprojekt Ltd " (Faruk Kaba, etj.) Rruga e Arbërit në teritorin e Maqedonisë Dibër-Gostivar-Tetovë-Shkup (Shefki Aliti), Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim me ndërtimin e Rrugës së Arbërit (Vesel Hoxha, etj.) Pasuritë minerale të rrethit të Matit që do të vihen në lëvizje për ekonominë e tregut me ndërtimin e Rrugës së Arbërit (Agim Shenjatari) dhe Rruga e Arbërit-Premisë për zhvillimin e turizmit(Bashkim Lleshi, Avni Dibra)

Në këtë kuvend përshëndetën dhe dhanë mendimet e tyre edhe Kryetari i nderit i Shoqatës "Votra Dibrane" Shehat Markja, Prefekti i Dibrës Xhafer Seiti, Deputetët e Dibrës Sali Shehu e Rahim Koleci, zotërinjtë Shemsi Prençi, Ali Hoxha, Hysen Uka, etj, si dhe dërgoi përshëndetje nga Dibra dhe kryetari i shoqatës "Votra Dibrane" Shpëtim Cami. Me regji të Sami Selishtës e skenar të Bujar Karoshit u shfaq dokumentari "Rruga e Arbërit një realitet". Të gjitha materialet e referuara në këtë kuvend të përmbledhura e redaktuara nën kujdesin e Bashkim Lleshit e Bujar Karoshit u botuan në librin "Rruga e Arbërit" i cili j'u shpërnda të gjithë pjesëmarrësve në kuvend. Në fund u miratua një rezolutë e cila u kërkon institucioneve qëndrore si Kryeministrisë e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Tekekomunikacionit që të angazhohen seriozisht me problemin e Rrugës së Arbërit.

Organizimi i këtij kuvendi dhe botimi i librit u sponzorizuan nga biznesmenët dibranë : Rakip Suli, Sadri Abazi, Musa Riçku, Shaban Bitri, Preng Doçi, Muhamet Bitri, Bashkim Kamberi, Naim Buci, Demir Rusi, Uzri Hoxha, Faik Bruçi, Zaim Korsi, Shpëtim Cami, Bujar Karoshi, Shkëlqim Cibaku, Liman Hoxha, Afrim Çenga e Bujar Methasani.

Materialet e këtij kuvendi u botuan të plota në gazetën "Rruga e Arbërit". Shumë bashkëpunëtorë e lexues të gazetës Rruga e Arbërit brenda e jashtë vendit, si Isuf Miha, Sefedin Shabani, Sulejman Tomçini, Ilmi Dervishi, Abdurahim Ashiku nga Athina, Gazmend Korkuti, Agim Kaba, Ymer



Në foto: Tuneli i shkallës së Tujanit, maj 2013. Foto: © Bujar Karoshi

Dibra e Beqir Sina nga USA, etj. përshëndetën punimet e këtij kuvendi dhe shprehën shqetësimet e tyre që puna për ndërtimin e kësaj rruge të fillojë menjëherë.

Në shtator e nëntor të vitit 2007 në Tiranë e Dibër të Madhe u prezantua libri "Rruga e Arbërit" me autor dejtuesin e Studios "Infatransprojekt Ltd" dhe kryetarin e grupit të Studimit të Fizibilitetit të Rrugës së Arbërit, Dr.Faruk Kaba. (Faruk Kaba shtator,nëntor 2007)

Për shoqatën "Lidhja e Intelektualëve dibranë dhe gazetën e saj "Rruga e Arbërit" vitet 2006 e 2007 u kthyen në vite sensibilizimi për rrugën e Arbërit jo më për komunitetin dibran por më shumë për qeveritarët e pushtetarët e këtij vendi, për ato që premtonin se do të fillojmë menjëherë punën për ndërtimin e kësaj rruge, para zgjedhjeve, por që menjëherë pas zgjedhjeve harronin se çfarë kishin premtuar. Pas gjithë këtyre përpjekjeve u arrit që në vitin 2007 të fillojnë projektet e zbatimit të kësaj rruge dhe në tetor 2007 u zhvillua tenderi për ndërtimin e segmentit Bulqizë-Ura e Çerenecit.

Gazeta "Rruga e Arbërit" në numrin e saj të parë të vitit 2008 jep sihariqin për fillimin e punës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit nëpërmjet redaktorit të saj Bujar Karoshi. Por çudia e madhe është se punimet për rrugën filluan aty ku Fatos Nano preu shiritin në vitin 2005, në dalje të Bulqizës, në rrugën ekzistuese, në një kohë që aksi i rrugës sipas Studimit të Fizibilitetit duhet të kalonte në krahun tjetër të luginës. Është për të ardhur keq që projektin e zbatimit e ka hartuar po ajo studio që ka kryer Studimin e Fizibilitetit dhe në vend që ti përmbahet aksit të miratuar ose të bëjë përmirësime të mëtejshme në projektin e zbatimit, harton një projekt teknik që është rikonstruksion i rrugës ekzistuese, me shumë pak përmirësime, me gërmimë të mëdha, etj. që nuk i përgjigjet standarteve të kohës për rrugët. Meqënëse unë kam qenë anëtar i grupit të Studimit të Fizibilitetit ku kam kryer Raportin mbi kushtet gjeologo-inxhinjerike e gjeoteknike të Rrugës Tiranë – Dibër, i indinjuar nga ky fillim jo i mirë, mora kontakt me Kabën ku i parashtroj vërejtjet e mia, jo vetëm për fillim të keq të punës për ndërtimin e rrugës, por edhe për disa pjesë të tjera për të cilat vazhdonin projektet e zbatimit, sidomos për kalimin e rrugës në luginën e Vajkalit dhe për tunelin e Qafë Buallit. Për këto mendime të shprehura e ftova Kabën në një diskutim më të zgjeruar me specialist të fushës por meqënëse ky takim nuk u realizua në maj të vitit 2008 botova në gazetën "Rruga e Arbërit" artikullin : "Pse lejohet të bëhen ndryshime të aksit të rrugës së miratuar në studimin e fizibilitetit në dëm të cilësisë së saj". (Bashkim Lleshi maj 2008) Artikullin e mësipërm e botuan edhe dy organe të tjera shtypi, "Zëri i Popullit" dhe "Ekonomia". Por Kaba në vend që të reagonte drejt e të përmirësonte ato ç'farë kishte për të përmirësuar në projektet teknike të pjesës, Lugina e Vajkalit-Tuneli i Qaf Buallit-Plani i Bardhë-Ura e Vashës harxhon kohë për të m'u përgjigjur mua në gazetën "Ekonomia" më 18 korrik 2008 me artikullin: "Rruga e Arbërit, jo vetëm nuk ka ndryshim e përmirësim të parametrave, por përmirësim të saj" (Faruk Kaba korrik 2008) Këtë "përmirësim" po e shohim pothuajse çdo vit me nga një deri dy aksidente me vdekje në rrugën në zonën e pishave, ku ka ngrica edhe në kohën kur nuk ka borë, siç ishte aksidenti i ndodhur në fund të vitit 2015, ku në këtë pjesë të rrugës humbën jetën dy qytetare dibrane. Me qënëse Kaba nuk j'u përgjigj propozimit tim për të diskutuar teknikisht u detyrova t'i kthej përgjigje, po në gazetën "Ekonomia" me artikullin : "Kaba i rrugës humbet llogjikën dhe etikën qytetare", (Bashkim Lleshi 29 korrik 2008) ku kam paraqitur edhe propozimet e mia për të mos bërë ndryshime për pjesën e rrugës në luginën e Vajkalit, hyrjen e Tunelit të Qaf Buallit nga Bulqiza dhe Urën e Vashës, duke j'u përmbajtur asaj që kishim shkruar e miratuar në Studimin e Fizibilitetit.

Me qënëse këto propozime nuk po merreshin parasysh në nëntor të vitit 2008 unë botova librin "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit" ku paraqita në mënyrë të përmbledhur, historikisht, kontributin e gjithë intelektualëve e studjuesve dibranë e jo dibranë për Rrugën e Arbërit dhe Studimin e plotë të pjesës gjeologo-teknike të paraqitur në Studimin e Fizibilitetit të kësaj rruge. (Bashkim Lleshi nëntor 2008) Këtë libër ua dhurova edhe të gjithë personave përgjegjës në organet drejtuese shtetërore për të patur parasysh se ç'farë është miratuar sidomos për aksin ku kalon kjo rrugë, për tunelet dhe Urën e Vashës dhe për të mos lejuar ndryshime sidomos të aksit të rrugës dhe veprave inxhinjerike të rëndësishme (tunele e ura) në dëm të cilësisë së saj.

Në korrik të vitit 2009 filloi puna për ndërtimin e segmentit Bulqizë-Ura e Vashës. Në intervistën që ka marrë gazetari Bujar Karoshi në shkurt të vitit 2009 në studion "Infratransprojekt Ltd" thuhet : "… Me një tunel në Qafën e Buallit 847m. ajo del në luginën e Planit të Bardhë duke vazhduar deri tek Ura e Vashës…" (Bujar Karoshi shkurt 2009) Në vazhdim jo vetëm se nuk u zbatua asnjë afat për ndërtimin e këtij segmenti por për tunelin e Qaf Buallit filluan diskutimet në se duhet hapur apo jo dhe më në fund ai nga 850m në studimin e fizibilitetit e 847m në projektin teknik të zbatimit u reduktua në 460m. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2011 kur tuneli duhet të kishte përfunduar, ai nuk kishte filluar akoma.

Kaluan mbi 10 vjet nga përfundimi e miratimi i Studimit të Fizibilitetit dhe rruga e shumë premtuar nga politikanët në të gjitha zgjedhjet vendore e parlamentare nga viti 2005 e deri në fund të vitit 2014 nuk ariti të vihet në rrugën e drejtë të zgjidhjes përfundimtare. Vonesat në ndërtimin e kësaj rruge, këto tre vitet e fundit (2011-2013), shumë politikanë edhe të lartë në biseda e takime të ndryshme dhe në media janë munduar ti justifikojnë, jo me neglixhencat e papërgjegjeshmërinë e tyre për sigurimin e fondeve, por me ndonjë arësye gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike, të sugjeruara nga ndonjë specialist jo kopetent e servil i pushtetit.

Edhe në zgjedhjet e vitit 2013 kryefjala e premtimeve para elektoratit dibran, të dy krahëve të politikës, ishte premtimi se do të përfundojnë Rrugën e Arbërit. Krahu i majtë që fitoi zgjedhjet premtoi se në vjeshtë do të fillojnë punimet, por iku edhe vjeshta e fundi i vitit dhe qetësia vazhdon.

Në gusht të vitit 2013 një grup pune i shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe "Nisma Dibrane" i përbërë nga Bashkim Lleshi, Musa Riçku, Demir Osmani, Bujar Karoshi, Hysen Uka, Afrim Karoshi e Kujtim Buci, kryen vrojtime nga Ura e Vashës deri në Tiranë dhe konstatuan se: "Gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbërit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbërit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangje nga aksi i Rrugës së Arbërit." (Bujar Karoshi, Gazeta "Rruga e Arbërit" gusht 2013) Shmangja më e madhe është ajo ku po hapet Tuneli i Qaf Buallit e cila është trajtuar që në vitin 2008 e në vazhdim. (Bashkim Lleshi 2008, 2013)

Gjeologu i vjetër dibran, Prof. As. Dr.Vesel Hoxha, pasi lexon artikullin e gazetarit Bujar Karoshi të muajit gusht 2013 "Shpëtoni rrugën e Arbërit", në Gazetën"Rruga e Arbërit" nr. 9 (89) shtator 2013, shkruan : "…Lexoni ju lutem shqetësimet njerzore mbushamendëse të bazuara në shkencë.... ku argumentohet mbi bazën e studimeve, realiteti ku ndodhet Rruga e Arbërit, duke tërhequr vemendjen e të gjithëve, vemendjen e atyre që ju dhimset sadopak Dibra dhe Shqipëria, për të ndërhyrë secili në mënyrën dhe mundësinë e vet, sa nuk është vonë, për t'u bërë ato përmirësime që rekomandon Ai, rekomandime jetike për standartin që kërkohet për t'u realizuar në rrugën e dytë të Kombit. Rruga ndërtohet një herë e mirë kur thonë, ndaj me rrugët nuk duhet lënë askush të bëjë shaka me to. Profesor Lleshi thotë: "Standarti i Rrugës së Arbërit është në rrezik." Ky është sinjal alarmi…"(Vesel Hoxha shtator 2013)

Në intervistën që i ka dhënë inxhinjeri shqiptar Shefki Aliti, korespondentit të gazetës "Rruga e Arbërit" Bujar Karoshi, në shtator të vitit 2013, tërheq vemendjen se, Rruga e Arbërit po ndërtohet larg standarteve europiane. Ai thekson se: "Pjesa që është ndërtuar në Shqipëri është paraparë me lëvizje maksimale të shpejtësisë me 80 km/orë, ndërsa Federata Europiane e Autostradave me seli në Brukselnuk pranon standarte të ndërtimit të autostradave me shpejtësi nën 120 km/orë... Kjo nuk është një autostradë që lidh dy shtete e më tej por një rrugë lokale" (Shefki Aliti, shtator 2013)

Meqënëse hapja e tunelit të Qaf Buallit dhe fillimi i punimeve në objektet e tjera u ndërprenë për një kohë të gjatë, drejtuesit e dy shoqatave të "Lidhjes së Intelektualëve Dibranë" dhe "Nismës Dibrane", në mars të vitit 2014, i dërgojnë një relacion Ministrit të Transportit e Infrastrukturës, dhe 6 deputetëve të Dibrës, ku propozojnë : " ...që për objektet e rëndësishmë të kësaj rruge si, tunelet e Qaf Buallit e Qaf Murrizës dhe Urën e Vashës, të rishikohen e përmirësohen projektet e zbatimit, duke bërë edhe krahasimet me projektet e hartuara..." (Nuri Abdiu, Bujar Karoshi, 2014) Për këtë relacion, as nuk u dha ndonjë përgjigje dhe as nuk u thirr ndonjë specialist për ndonjë konsultim.

Për çudi, në fillim të tetorit të vitit 2014, menjëherë pas vizitës së Kryeministrit Rama në Kinë më 11 shtator, kur u dha sihariqi se Rruga e Arbërit do jepej me koncension dhe për objektet që nuk ishin filluar u sugjerua se duhet të kryhen përmirësime që në fazën e projektimit, filloi me shpejtësi hapja e tunelit të Qaf Buallit në vendin ku nuk duhet të vazhdonte hapja e tij duke shënuar edhe një njollë tjetër të zezë që ka prishur cilësinë e kësaj rruge.

Në intervistën dhënë Gazetës Rruga e Arbërit nr. 9(41) shtator 2009, Dr.Ing. Faruk Kaba për tunelin e Murrizës shkruan: "...Sidoqoftë ka qenë e nevojshme të kapërcehet Qafa e Murrizës me një tunel 3,5 km. të gjatë... Tuneli është projektuar të kalojë në kuotën 800-820m. Tuneli fillon në shtëpitë e sipërme të fshatit Murrizë, nga krahu i Tiranës dhe del në grykën e lumit të Mashnorit, pranë shtëpive të fshatit Xibër, poshtë shkollës së këtij fshati, në kuotë rreth 820m. mbi nivelin e detit... Vështirësia e tij shtohet po të kemi parasysh kushtet gjeologjike ku kalon ky tunel, të cilat janë nga më të dobtat. Për të përcaktuar poozicionin më të përshtatshëm të tij janë bërë tentativa të shumta dhe grupi i inxhinjerëve është i besimit se ka gjetur poozicionin më të përshtatshëm..... Për tunelin e Murrizës janë paraqitur edhe dy variante të tjerë me tunele me gjatësi 3,6 dhe 4,2 km...." (Bujar Karoshi 2009)

Pas dy vitesh, për të justifikuar vonesat në fillimin e punimeve të këtij tuneli filluan të dalin nëpër intervista pushtetarë të lartë e "specialistë" ku flisnin për problemet gjeologjike e hidrogjeologjike të cilat kushtëzuan ngritjen e nivelit të tunelit në lartësinë 950, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij nga 3000-3500ml, në rreth 2400ml. Pavarësisht nga problemet gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike që janë përdorur për të justifikuar këto vonesa, pretendimet e paraqitura deri tani për pengesat që mund të lindin nga ujrat e shumta që mund të dalin gjatë hapjes, apo për formacione të shkatërruara e të pakalueshme në hyrje e në dalje të tunelit nuk qëndrojnë.

Në dhjetor të vitit 2014 në gazetën "Rruga e Arbërit" u botua artikulli: "Urojmë që fatin e Tunelit të Qafë Buallit të mos e pësojë Tuneli i Qafë Murrizës"(Bashkim Lleshi dhjetor 2014)

Nuk ka arësye gjeoteknike e hidrogjeologjike për të ngritur lartësinë e tunelit të Murrizës nga 800-850m në 950m mbi nivelin e detit, rrjedhimisht shkurtimin e gjatësisë së tij nga 3000 deri 3500ml të parashikuar e projektuar në vitin 2009, në 2400ml. duke prishur cilësinë e rrugës. Deklaroj me përgjegjësi profesionale se kushtet gjeoteknike e hidrogjeologjike të këtij tuneli janë shumë më të mira se të tunelit të Qaf Thanës dhe më të mira se të tunelit të Kalimashit e mijëra metra tuneleve me përmasa të mëdha të hapura nga Klosi në Bulqizë e nga Bulqiza në Batër ku ka patur prurje të mëdha uji. Depozitimet flishore alevrito ranore që nuk përbëjnë as 20% të gjatësisë së tunelit kanë shumë pak ujë në brendësi të tyre dhe pak ujë në kontakt me gëlqerorët pllakorë, ndërsa gëlqerorët pllakorë kanë shumë pak ose aspak ujë sepse nuk kanë gaverna si gëlqerorët karstikë të Malit me Gropa, prandaj arësyet e shtyrjes së punimeve se kanë dalë disa problem gjeoteknike e hidrogjeologjike të paraqitura nga ndonjë specialist jo kopetent e të deklaruara në intervista edhe nga drejtues shtetërorë e politikë nuk qëndrojnë.

Me entusiazëm e pritëm edhe njoftimin për marrëveshjen e fundit në parim, Memorandumin e Bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe asaj Kineze, që u nënshkrua më 16 dhjetor 2014 në Tiranë, ku Banka Kineze "Eksim Bank" do të financojë disa projekte në vendin tonë, e në rradhë të parë projektin për përfundimin e Rrugës së Arbërit. Më së fundi filloi të ngjallet shpresa, që edhe Rruga e shumëpërfolur e Dibrës, Rruga e Arbërit, po vihet në rrugën e zgjidhjes përfundimtare, për t'ju përgjigjur standarteve të rrugëve europiane.

Por nuk vonoi shumë dhe kjo shpresë u venit në vitin 2015. Për të ringjallur shpresat e dibranëve, gjoja për t'i kushtuar një rëndësi të veçantë ndërtimit të kësaj rruge u hoq dorë nga rruga e njohur ligjore e tenderimit, duke miratuar një ligj të veçantë në Parlament më 16 prill 2015, për dhënjen e kësaj rruge me koncension. Në shtator 2015 në artikullin e Bujar Karoshit "Vihet në dyshim financimi kinez për Rrugën e Arbrit" thuhet: "Të deleguar të firmave kineze në Shqipëri deklarojnë tërheqjen e "Exim Bank" por "China State Construction" vazhdon negocimin. Deputetët Përparim Spahiu dhe Ulsi Manja: Gjithçka po ecën sipas parashikimeve. Punimet nisin në janar" (Bujar Karoshi shtator 2015)

Në dhjetor 2015 kryeministri Rama takon në Pekin Kryeministrin kinez Li Keqiang dhe përsëri deklarohet se do ta ndërtojmë Rrugën e Arbërit, ndërsa në janar 2016 Rama theksoi se: "Po e vonojmë firmën për Rrugën e Arbërit në interes të publikut", (Bujar Karoshi dhjetor 2015, janar2016) por mandati i qeverisjes po të mbaron zoti Rama, po rrugën kujt po ia len, publikut?!

Në gazetën Ruga e Arbërit të dhjetorit 2015, gazetari Bujar Karoshi citon dekleratat e kryeministrit Rama, kryeparlamentarit Meta, të mininistrave Haxhinasto, Cani e Ahmetaj dhe deputetëve Spahiu e Manaj nga janari e deri në dhjetor 2015 duke deklaruar nga muaji në muaj se jemi në negociata, se do të fillojmë në qershor, në shtator apo në fund të vitit e janar, erdhi dhe fundi i vitit dhe deputetët dibranë përgjigjen se nuk kemi informacion, kur të informohemi do t'ju njoftojmë, por edhe viti të dashur deputetë mbaroi, filloi dhe 2016-ta dhe fillimi i punimeve për rrugën nuk po duket.

Në gazetën Rruga e Arbërit janar 2016 shkruhet se Peticioni i nisur online që në mars të vitit 2013 po përhapet edhe në mediat e tjera sociale. Gëzim Alpion pedagog në Universitetin e Birmingamit, nismëtari i peticionit thekson për gazetën: "Përveç 2000 nënshkrimeve me formularë, nisma jonë tani ka edhe mbi 8000 përkrahës online". Grupi lobues i këtij peticioni në tryezën e rrumbullakët të organizuar në Tiranë në maj 2014 arriti të bashkojë një gjysëm dyzine parlamentarësh të cilët nuk janë bërë asnjëherë bashkë për të ngritur zërin në Kuvend për Rrugën e Arbërit. (Bujar Karoshi janar 2016)

Të ndodhur para kësaj situate lind pyetja: Edhe sa kohë do të vazhdojnë pushtetarët tanë të tallen me elektoratin dibran se me të fituar zgjedhjet do të ndërtojnë Rrugën e Arbërit? A kanë fytyrë deputetët e Dibrës të dalin para popullit e të kërkojnë përsëri vota me premtimin se do të ndërtojnë rrugën? Do të ishte në nderin e tyre që, po të kishin hequr dorë me kohë ato që kanë afro 20 vite që marrin vota me premtimin se në mandatin e tyre do t'a ndërtojnë këtë rrugë, dibranët, këtej e matanë kufirit dhe ato të diasporës me kursimet e tyre do t'a kishin mbaruar Rrugën e Arbërit pa kërkuar ndihmën e këtyre pushtetarëve që e sakatuan dhe e lanë në mes rrugën.

Kontributin më të madh për për informimin e qytetarëve se çpo bëhet me Rrugën e Arbërit e ka dhënë gazeta "Rruga e Arbërit". Në maj të këtij viti mbushen 10 vite të botimit të saj. Që në numrin e parë të saj në maj të vitit 2006 e deri më sot, kjo gazetë ka paraqitur me objektivitet punën e kryer për Rrugën e Arbërit. Edhe në të ardhmen bashkëpunëtorët dhe botuesit e saj do të vazhdojnë të ngrejnë problemet e ecurisë së kësaj rruge jetike jo vetëm për dibranët këtej e matanë kufirit por për mbarë shqiptarët kudo që jetojnë e punojnë.

Shkurt, 2016

Rruga e Arbërit nr. 118

portret

Çdo ditë në baxhon e tij hyjnë pesë deri gjashtë kuintalë qumësht, kurse verës shkon deri në dhjetë. Për momentin , prodhon vetëm 4 – 5 lloje djathi...
pasi disa nuk njihen akoma nga klientela.

Lulzim Piku, përpunuesi i “arit të bardhë“

Nga **OSMAN XHILI**



... Një ditë e la Italinë. Zgjodhi një vend të bukur në Dibër, anës rrugës nacionale, fare pak më poshtë rotondos së Maqëllarës. Me paratë e fituara bleu tokën, ndërtoi një banesë të bukur, një baxho, por dhe një dyqan ku të shiste produktet e qumështit të përpunuar.
Fillimi si gjithmonë i vështirë, - tregon Lulzimi. Duheshin kapitale, duheshin fonde, duheshin njohje e lidhje, si me fermerët, ashtu dhe me klientelën, që do të konsumonte djathin e tij.

Ari i bardhë - kështu e quanin shpesh djathin në Itali, - thotë Lulzim Piku, baxhieri i talentuar nga Maqëllara e Dibrës. Ai shkoi në vendin fqinj si gjithë emigrantët e tjerë, vetëm 19 vjeç, pa pasur ndonjë zanat apo strehë ku të qëndronte. Ishte mjaft energjik dhe besonte se do t’ia dilte mbanë. Rajoni i Puljas me pesë qytete dhe një popullsi gati sa e Shqipërisë, do të ishte stacioni i ri për djaloshin gjatë kohës që do të qëndronte.

Pronari i parë i Lulzimit, quhej Kazimo dhe kishte tetë lopë. Më pas gjërat i shkuan për mbarë dhe i bëri tetëdhjetë, duke përpunuar dhe qumështin e tyre. Djaloshi i ri u lidh shumë me blektorinë, me qumështin, me përpunimin e tij. Mësoi si tu shërbente kafshëve, por dhe magjia e transformimit të qumështit e tërhoqi mjaft , për ta prangosur përjetësisht. Dy vjet më pas, shkoi të punojë në një karburant, por nuk hoqi dorë nga pasioni i ri. Ditën e shtunë dhe të diel, shkonte në një baxho diku pranë dhe punonte pa pagesë me qëllimin e vetëm final , të përvetësonte sa më mirë mjeshtërinë e përpunimit të arit të bardhë. Për dy vjet ndoqi dhe shkollën artizane për linjën e përpunimit, duke e përmbyllur këtë cikël me rezultate shumë të mira dhe duke marrë dokumentet përkatëse, që i ka dhe sot e kësaj dite.

I pajisur me dije teorike dhe një praktikë jo të paktë, ai mendonte se është i aftë të punojë në një fabrikët të vërtetë qumështi me 35 punëtorë dhe që grumbullonte 500 deri 700 kunjtalë në ditë. Pronari i fabrikës, Xhuzepe Marjano, dhe pse me shumë kërkesa ndaj punës, e pranoi pa hezitim Lulzimin. Pa tek ai dinamizmin, dashurinë për punën e profesionin, disiplinën dhe korektesën, cilësi këto që jo vetëm nuk i ka humbur, por i ka çuar në nivele akoma më të larta. Mes shumë të tjerash, Lulzimit i bëri përshtypje disiplina në punë dhe pastërtia deri në ekstrem. Dy herë në javë e gjithë fabrika lahej me ujë të bollshëm dhe me detergjentë. Prodhimi shpërndahej sipas kontratash paraprake si në tregun vendës, po ashtu dhe jashtë, në Amerikë, Rusi, Kanada, apo shtete të tjera.

Baxhierit të ri i pëlqente roli i përgjegjësit të stazhionimit të djathit kaçkavall, paketimi, peshimi , duke mësuar të bëjë tetë lloje të ndryshme djathi, si Burato, Macarela, kaçkavall, Skamoc, Provalone, djath i freskët (xhungato), Afumikato dhe Rikoto. Ai jo vetëm dinte ti prodhonte, por dinte dhe cilësitë e secilit lloj djathi, fortësinë, qëndrueshmërinë, mënyrën e ruajtjes dhe të amballazhimit,si dhe qëllimin e përdorimit. Burato , thotë Lulëzimi, shërbehet me pana dhe çokollatë, djathi i freskët quhet xhungato, Macarela shërbehet me pica, Rikoto për ëmbëlsirat, kurse Afumikato është djath kaçkavall i tymosur, por që pak njihet e përdoret nga konsumatori shqiptar.

Lulzimi punoi tek fabrika për gati shtatë vjet. Këtu mësoi shumicën e sekreteve të djathit. Për të mësuar një lloj kaçkavalli me qumësht delje shkoi të punojë disa kohë tek një fermer që kishte 200 kokë dhen me emrin Xhovani. Krahas teknologjisë së kohës, disa procese pune në fabrikë realizoheshin me dorë. Duart e tij filluan t’u përshtaten temperaturava të larta nëpër të cilat kalonte djathi. Lëkura e tyre filloi të trashet. Receptorët e tyre nervorë u dogjën dhe u bënë të pandjeshëm. Ky ishte çmimi që duhej të paguante në fitim të një profesioni të mrekullueshëm. Nëse një dorë normale reziston deri në 50 gradë , të tijat mund të përballojnë gati dyfishin , pra 95 gradë.

Ndoshta mund të qëndronte gjithë jetën në Itali. Por as vetë ai, nuk di ta shpjegojë një zë të brendshëm që e ftonte në vendlindje. Të eksperimentonte me njohuritë e fituara, të ngrinte një fole të re, një banesë dhe një baxho, ku të punësonte veten dhe familjen. Të ndihmonte fermerët , duke u marrë qumështin dhe duke shtuar numrin e krerëve në zonë. Të ishte vetë pronar i baxhos dhe të mos ishte çirak në një vend të huaj. Këto mendime nuk e linin të qetë dhe e trazonin shpesh gjumin e tij. Një ditë e la Italinë. Zgjodhi një vend të bukur në Dibër, anës rrugës nacionale, fare pak më poshtë rotondos së Maqëllarës. Me paratë e fituara bleu tokën, ndërtoi një banesë të bukur, një baxho, por dhe një dyqan ku të shiste produktet e qumështit të përpunuar.

Fillimi si gjithmonë i vështirë, tregon Lulzimi. Duheshin kapitale, duheshin fonde, duheshin njohje e lidhje, si me fermerët, ashtu dhe me klientelën, që do të konsumonte djathin e tij. Në një vend ku shteti nuk do t’ja dijë fort për nisma e biznese të reja, gjërat janë akoma më të vështira. Por, pak nga pak, punët nisën të shkojnë për mbarë. Në krah të baxhierit të talentua, qëndron e shoqja, Hajria, një grua shumë punëtore dhe e vendosur. Kur durimi sosej tek i shoqi, ajo gjente akoma forcë dhe shkak për të vazhduar,kur humbej ylli i shpresës, ajo shihte një dritë që shkrepëtine diku larg, dhe që të dy vazhdonin akoma, për ti treguar vetes dhe botës se ata mund t’ja dilnin e nuk do të dorëzoheshin.

Çdo ditë në baxhon e tij hyjnë pesë deri gjashtë kuintalë qumësht, kurse verës shkon deri në dhjetë. Për momentin, prodhon vetëm 4 – 5 lloje djathi, pasi disa nuk njihen akoma nga klientela. Historia e tij shqiptare ka vetëm dy vjet që ka nisur, por Lulzimi është shumë optimist dhe shumë i kënaqur me treguesit. Shpesh, sheh makina të parkuara për pak kohë pranë baxhos së tij. Njerëz nga Maqëllara, nga Peshkopia, por dhe nga Tirana, Durrësi, apo nga Maqedonia kërkojnë të njohin llojet e djathit që ai di ti punojë. Vetë ministri i bujqësisë, profesor Panariti, e ka vizituar baxhon e tij, e ka pëlqyer mjaft prodhimin dhe i ka premtuar për ndihmë. Shkëmbehen numra telefoni, merren mostra djathi, u tregohen shokëve e miqve dhe shumë shpejt, klientela e tij fiton përmasa të reja. Djathi i tij i nënshtrohet gjithnjë pasterizimit në temperature 65 – 70 gradë, duke qenë shumë i sigurtë nga bruceloza apo dhe nga sëmundje të tjera.



Rrathët e njohjes hapen e hapen më shumë. Lulëzimi ka marrë pjesë në takime ndërkufitare në Gostivar, Prilep e Shkup. Këtë vit dëshiron të marrë pjesë në një panair të produkteve dibrane në Tiranë, apo të ekspozojë disa produkte të tij në Selanik të Greqisë.

Lulzimi dëshiron të rrisë sasinë e qumështit të përpunuar, të paktën deri në 50 kunjtalë, e po kështu llojet e djathit që do hedhë në treg.

Para pak kohësh një biznesmen nga Peshkopia kishte një dasëm në shtëpinë e tij. I kërkon Lulzimit të merrej ai me djathin që do shtrohej në tavolina. 50 kilogram djathë nga 11 lloje të ndryshme u konsumua totalisht e kjo ishte një shenjë absolute e pëlqimit nga pjesëmarrësit. Rrathët e njohjes hapen e hapen më shumë. Lulëzimi ka marrë pjesë në takime ndërkufitare në Gostivar , Prilep e Shkup. Këtë vit dëshiron të marrë pjesë në një panair të produkteve dibrane në Tiranë, apo të ekspozojë disa produkte të tij në Selanik të Greqisë.

Lulzimi dëshiron të rrisë sasinë e qumështit të përpunuar, të paktën deri në 50 kunjtalë, e po kështu llojet e djathit që do hedhë në treg. Ai ka nevojë për disa pajisje shtesë si kaldaja, filatriçe për përpunim djathi, një makinë skremimi e disa aksesorë të tjerë. E shoqja, dy djemtë dhe nusja e Blinit, që sapo e kanë zënë i qëndrojnë pranë në çdo moment, si një garanci se kjo punë e nisur do të ketë bereqet për familjen , por dhe për komunitetin ku ata punojnë dhe jetojnë.

aktualitet

Rruga e Arbërit mbetet akoma kërkesa e vetme masive e shoqërisë në Dibër, ndaj mosmbajtja e këtij premtimi në radhë të parë është përgjegjësi e deputetit Shkëlqim Canit.

Kush po e pengon investimin në Rrugën e Arbrit?

Çfarë do të bëhet me Rrugën e Arbërit? Deputeti Bedri Hoxha akuzon Koço Kokëdhimën si sabotues të negociatave. Çfarë po ndodh me marrëveshjen? Do të jepet rruga me koncension te shoqëria kineze apo qeveria shqiptare do të tërhiqet nga nënshkrimi i marrëveshjes? Kush po e rrit koston e rrugës dhe a kanë dorë nënkontraktorët shqiptarë? Pse u shkarkua Shkëlqim Cani nga posti i Ministrit të Financave? Çfarë roli do të luajë ai në karrigen për të cilën është votuar? LSI dhe PS në Dibër a janë në prag të një përçarje?





Nga **HYSEN LIKDISHA**
BUJAR KAROSHI

Kryeministri Edi Rama i shprehu sot Ministrit të Financave Shkëlqim Cani falënderimet e tij për angazhimin, profesionalizmin dhe integritetin e plotë në kryerjen e njërës prej detyrave më të vështira qeverisëse të këtij mandati. Kryeministri e informoi Ministrin Cani për vendimin e zëvendësimit të tij me një koleg tjetër dhe i kërkoi vazhdimin e angazhimit të tij me të njëjtin profesionalizëm e përkushtim, si deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe anëtar i Komisionit të Ekonomisë e Financave", - thuhej në njoftimin e beftë të Kryeministrisë të datës 16 shkurt, për largimin nga posti i Ministrit të FInancave, deputetit të Dibrës, Shkëlqim Cani. Menjëherë më pas, një valë shkrimesh të botuara në shtypin shqiptar e cilësuan si "shkarkim" largimin e Canit. Mediat e lidhën shkarkimin e tij me kundërshtimin që u ka bërë disa proceseve koncensionare që qeveria shqiptare kishte në proces, mes të cilave ai i dhënies së TVSH-së. Disa media të tjera e lidhën këtë edhe me pakënaqësitë brenda koalicionit, duke aluduar te thashethemet se LSI kishte kërkuar prej kohësh largimin e tij, ose një ndikim të prodhuesve të kromit në vend, në lidhje me pakënaqësitë e tyre për mosuljen e disa tarifave në këtë periudhë të vështirë për industrinë mineralnxjerrëse.

Shkëlqim Cani ishte i pari në listën e deputetëve të Partisë Socialiste për qarkun e Dibrës. Gjatë kohës së fushatës ka qenë vetë kryetari i PS-së, Edi Rama, i cili ka thënë se Shkëlqim Cani e kishte kushtëzuar qënien e tij në listë si një garanci se Partia Socialiste me të ardhur në pushtet, do të investonte në përfundimin e Rrugës së Arbrit, por kur po bëhen tre vjet nga ky premtim, asgjë nuk duket në horizont.

A ka lidhje largimi i Canit me këtë premtim të pambajtur? Pse ai nuk e dorëzoi mandatin e deputetit si kolegët e tjerë? Çfarë do të bëjë Cani tani, kur ai është kthyer në pozicionin për të cilin është mandatuar nga vota e popullit?

A ISHTE ZVARRITJA E NDËRTIMIT TË RRUGËS SË ARBËRIT ARSYEJA E LARGIMIT?

Qeveria shqiptare, në pamje të parë, dukej se kishte gjithçka në rrugën e duhur përsa i përket investimit për Rrugën e Arbrit. Një ligj i posaçëm në Parlament ishte miratuar në prill të vitit të kaluar dhe pritej që në fund të vitit të firmosej marrëveshja. Por duket se gjatë periudhës së negociatave kanë ardhur duke u vështirësuar punët dhe nga një kosto rreth 240 milionë euro, duket se investimi ka shkuar në një kosto rreth 360 milionë euro. Duke pasur parasysh edhe interesat gjatë viteve të ardhshme, parashikohet që qytetarët dhe buxheti i shtetit ta paguajnë rrugën në një kosto mbi 600 milionë Euro, gjë që e ka bërë të vështirë procesin për qeverinë shqiptare. Exim Bank, e cila ishte deklaruar se do të ishte financuese e projektit, është tërhequr nga investimi. Kompania kineze e përfshirë në këto negociata e ka rritur koston e projektit. Grupe lobuese të investitorëve kinezë e kanë akuzuar qeverinë se nuk po vepron me transparencë në këtë drejtim dhe në vend që të marrë nga Kina investime strategjike, katandiset te një investim pa interes për investitorët kinezë.

"Ndërkohë që qeveria shqiptare për vitin e tretë radhazi nuk ka bërë asnjë punë me Kinën, por ka mbetur ende te një projekt korruptiv i "Rrugës së Arbërit:, ku nënkontraktorët shqiptarë e kanë rritur koston për 26 km rrugë në 360 milionë euro, nuk ka asnjë projekt strategjik rrugor e hekurudhor të certifikuar që ka interes për Kinën", - shkruante në numrin e fundit të revistës "Monitor" Geri Selenica, përfaqësues i disa shoqërive kineze në Shqipëri. Ndërkohë, deputeti i opozitës në parlament, Bedri Hoxha, gjatë një interviste për gazetën "SOT" akuzon Koço Kokëdhimën për bllokimin e këtij projekti.

"Nga informacionet që unë kam, duke qenë se jam pjesë edhe e delegacionit të Grupit të Miqësisë Shqipëri-Kinë, me kryetar të këtij grupi është z. Koço Kokëdhima, deputet i PS, sabotimi i kësaj rruge vjen pikërisht nga këto segmente. Unë kam informacion që Rruga e Arbrit nga 220 milionë euro për këtë segment të papërfunduar, nga Zall-Bastari deri tek Ura e Vashës, vlera e këtij projekti është rishikuar dhe është mbi 280 milionë euro, ndoshta dhe 300 milionë euro, çka le shkas për të dyshuar që pas këtij projekti të parealizuar mbetet një tentative e parealizuar korrupsioni nga qeveria Rama dhe qeveria shqiptare", - thotë deputeti i Matit në Parlamentit shqiptar.

DEPUTETI I LSI PARALAJMËRON VONESAT

Zvarritjet në këtë drejtim i konfirmon edhe deputeti tjetër i Dibrës, Përparim Spahiu, nga LSI. Në një shkrim të botuar në mediat qendrore të titulluar "Rruga e Rrugës së Arbrit", Spahiu përpiqet të argumentojë se vonesat nuk janë aq të rëndësishme, duke marë parasysh këtë investim strategjik.

"Si një projekt që klasifikohet ndër investimet më prestigjioze në listëpritje, pavarësisht vonesave që i kanë mërzitur jo pak banorët, diçka duhet bashkëpranuar: Ky investim është strategjik, e si i tillë vlen dhe meriton të bëhet me të gjithë kujdesin e mundshëm", shkruan deputeti i LSI. Ai merr shembull Rrugën e Kombit, e cila pavarësisht qëllimeve të mira, mban nga pas mjaft problematika.

"Historia e Rrugës së Kombit, si rrugëtim i pafundmë i stërzgjatjes së investimit, me të gjithë pasojat e drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit dhe llogaritë e qytetarëve shqiptarë, duhet të shërbejë si mësim themelor", - shkruan Spahiu.

Përsa i përkët Rrugës së Arbrit, deputeti i Dibrës thekson se "nga të gjitha të dhënat e deritanishme, pavarësisht padurimit të natyrshëm, hapat po ndiqen në mënyrë korrekte. Koncesionimi i një projekti të tillë, për ta bërë sa më të mirëmenduar e për t'i mundësuar një shtrirje sa më të plotë efekteve të pritshme pozitive në ekonominë lokale dhe kombëtare, kërkon detyrimisht përfshirjen e grupit teknik, përfaqësuesve të Ministrisë së Transportit, Ekonomisë dhe asaj të Financave. Konglemerimi i një sërë kontributorëve vetëm sa e pasuron projektin në letër dhe në zbatim."

"Rruga e Arbrit është modeli i pastër si duhen organizuar e si duhet të funksionojnë koncesionet në të ardhmen: transparencë ndërinstitucionale dhe me publikun, si edhe ecje e mirëmenduar, pavarësisht presioneve të brendshme (politike) apo të jashtme (popullore)...", shkruan Spahiu. Në fund, ai thekson se "Rruga e Arbrit duhet të jetë fryt i një mendimi të detajuar që reflekton kërkesat e kahershme të zonës e jo një firmë e hedhur nxitimthi mbi letër të bardhë, frymëzuar nga kalendari i zhvillimeve elektorale."

RRUGA E ARBËRIT DHE ROLI I SHKËLQIM CANIT

Por nuk është as Përparim Spahiu dhe as Ulsi Manja, deputetët të cilët i kanë marrë votat në Dibër me premtimin e Rrugës së Arbërit. Ka mbi 20 vjet që deputetë - majtas e djathtas - kanë kërkuar vota me këtë premtim, por garancia e Partisë Socialiste në zgjedhjet e 2013-ës ka qenë numri 1 në listë, Shkëlqim Cani. Kështu që çdo vonesë e qeverisë në këtë drejtim, së pari është përgjegjësi e tij. Por përtej interesit publik, a është ish-Ministri Cani i pari që nuk ka hedhur firmën ne marrrëveshjen që është në zyrën e tij? A ekzistojnë në atë marrëveshje problematikat që shfaq deputeti Spahiu në shkrimin e tij? Mos vallë nënkontrajtorë të firmës kineze e kanë pasur të garantuar firmën e Canit dhe Ramës për shkak të premtimeve elektorale? Të gjitha këto, duke marrë parasysh nëse janë të vërteta edhe deklarimet e deputetit të opozitës, Bedri Hoxha, për implikimin në këtë proces të Koço Kokëdhimës, mund ta kenë bërë Canin të tërhiqet nga firma... firmë e cila i hoqi karrigen e Ministrit të Finanvave, por jo atë të përfaqësuesit të Dibrës.

ÇDO TË BËJË CANI NË KARRIGËN E DEPUTETIT?

Kur Shkëlqim Cani ishte Ministër i Financave, Dibra duket se ishte ndarë në sinore nga deputetët e majtë. Ulsi Manja njihej si deputet i Dibrës, Përparim Spahiu i Bulqizës, ndërsa Shkëlqim Cani shihej më shpesh me vizita në Mat dhe ndonjëherë deri në Bulqizë. Në të gjitha rastet, pa bujë dhe pa foto në Facebook.

Gjatë zgjedhjeve lokale e majta humbi bashkinë e Matit, ndërsa fitoi Bulqizën dhe Dibrën. Pas fitores të dy bashkive të majta, emri i Shkëlqim Canit si deputet në Bulqizë dhe Peshkopi filloi të humbiste. Disa mbështetës të tij brenda Partisë Socialiste u mënjanuan. Kur ndonjëri prej tyre kërkonte publikisht ndonjë vend në administratë, i thuhej se "për ty mendon Shkëlqim Cani". Gjithashtu, e njëjta situatë ishte edhe në Bulqizë. Disa pronarë galerish që më parë krenoheshin se kishin financuar fushatën e Canit, tani e mohonin atë, duke theksuar se Cani ishte një pengesë në bizneset e tyre në kushtet e rënies së çmimit të arit të zi. Ndërkohë, LSI është fuqizuar shumë dy vitet e fundit, duke kërkuar më shumë hapësirë në qeverisjen lokale. Për të hapur terren, ajo ka bërë edhe aleanca të momentit me të djathtën, duke i marrë PS drejtimin e Qarkut. Ndërkohë, ditët e fundit deputeti i LSI u hodh në një sulm të hapur ndaj kryetarit të Bashkisë Peshkopi. Ai e auzon Xhelilin se nuk po merret me punët e qytetarëve, po angazhohet në biznesin e tij privat, ndërkohë që është kryetar bashkie dhe para se të zgjidhë problemet me ata që e kanë zgjedhur, po gjen punë për të afërmit e tij.

Në këtë atmosferë "lufte" të heshtur nuk dihet qëndrimi që do të mbajë Shkëlqim Cani në karrigen e deputetit. Ai nuk ka grupet e tij në terren dhe nuk ka shprehur asnjë ambicie për ta bërë këtë. Njerëzit janë të zhgënjyer prej tij, më shumë sesa për mosmbajtjen e premtimit për rrugën e Arbëit, për mungesat e tij në takimet me votuesit. Zgjedhjet janë pak më shumë se një vit larg dhe premtimet e dhëna nga PS tre vite më parë janë shumë larg realizimit.

***

Rruga e Arbërit mbetet akoma kërkesa e vetme masive e shoqërisë në Dibër, ndaj mosmbajtja e këtij premtimi në radhë të parë është përgjegjësi e Shkëlqim Canit. Njerëzit e duan rrugën sado të kushtojë dhe pavarësisht se kush firmos. Arsyet se kostot po rriten vazhdimisht nuk është përgjegjësi e qytetarëve. Qeveria ka premtuar ndërtimin e saj brenda mandatit dhe duhet të tregojë vullnetin se ky mbetet një angazhim. Ndërsa për faktin se grupe të caktuara me pushtet politik dhe financiar duan të përfitojë prej këtij procesi nuk është çështje e qytetarëve: me to duhet të merren organet ligjzbatuese...

Letër deputetëve të Dibrës: Dëshmoni se pavarësisht përkatësisë politike, Ju para së gjithash jeni përfaqësues të denjë të Dibrës

Të nderuar Deputetë të Dibrës:
Shkëlqim Cani, Bedri Hoxha, Roland Keta, Ulsi Manja, Sherefedin Shehu, Përparim Spahiu

Siç e dini, në Tryezën e Rrumbullakët për Rrugën e Arbrit që organizuam në Tiranë në vitin 2014, Ju të gjithë, pa përjashtim, ratë dakord me propozimin e z. Ulsi Manja se, po qe se edhe pasi të sigurohen fondet për këtë projekt do të ketë zvarritje në fillimin e punimeve, Ju së bashku do ta thërrisni z. Edi Rama në interpelancë:https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=K_Xzt7Ch1-ë

Kanë kaluar dy vjet që nga ajo kohë dhe fondet nuk janë siguruar. Për pasojë, kjo vepër nuk do të ndërtohet brenda këtij mandati, siç u premtua me bujë nga Qeveria.

Në këto rrethana, ne mendojmë, që kjo e bën edhe më të justifikueshme që Ju të përmbushni premtimin për të thirrur në interpelancë Kryeministrin, duke dëshmuar se pavarësisht përkatësisë politike, Ju para së gjithash jeni përfaqësues të denjë të Dibrës.

Sot mësuam se kolegu juaj, z. Shkëlqim Cani, është shkarkuar nga detyra e Ministrit të Financave. Megjithëse si nënshkrues i peticionit, z. Cani refuzoi kërkesën tonë për të ndërmjetësuar një takim me z. Rama për të filluar dialogun tonë konstruktiv me Qeverinë për Rrugën e Arbrit, ne mendojmë se largimi i tij nga posti i ministrit përbën lajm jo të mirë për Dibrën.

Megjithatë, tani që z. Cani po kthehet në detyrën për të cilën e kanë votuar dibranët, ai ka përsëri mundësi të dëshmoj devotshmërinë ndaj elektoratit të tij.

Me respekt,
Gëzim Alpion
(në emër të Grupit të Lobimit)
16 shkurt 2016.

opinion



"Kjo fotografi, së bashku me dy të tjera, u publikua në faqen e Kryeministrit Edi Rama në FB në fillim të shkurtit nën titullin "Rilindja urbane në Bulqizë": Në diçiturën që e shoqëronte shkruhej: "Drejt përfundimit bulevardi i qytezës së minatorëve, ku përmes programit kombëtar të Rilindjes Urbane, pas njëzet e kusur vitesh rrënim e braktisje në baltë dhe në pluhur, komuniteti bulqizak po prek ndryshime të rëndësishme cilësore në hapësirën e bashkëjetesës sociale.".

Fotoja është shoqëruar me komente të shumta, negative dhe pozitive. Ka prej tyre që e lavdërojnë punën e qeverisë për vëmendjen në investime në zona të harruara, por ka edhe komente të tjera që e quajnë punën pa standarde. Njëri prej komentuesve i kërkon Kryeministrit që para se ta publikojë foton, ta shkelë njehërë me këmbë, pasi shëtitorja është jashtë standardeve". Ndërsa komentues të tjerë i kërkojnë Kryeministrit Rrugën e Arbërit. "Zoti Rama i keni vendosur dy pllaka guri mbi beton, po dua të të them që aq kontribut sa është derdh në atë pedonale, që vetëm pedonale nuk mund ta quash, mjafton të punojë një ndër minierat vetëm 1 javë dhe i dalin lekët atij investimi që është bërë. Pastaj rruga e arbrit si s'është duke filluar? Vallë mos e keni lënë për mandatin tjetër?".

Minatorët e Bulqizës, heronjtë e kohëve moderne

Nga **EDISON BALLA**

Pronarët e galerive nuk janë përgjegjësit e vetëm që minatorët sot po përzihen nga puna si dhe paralajmërohen për ulje rrogash. Në anën tjetër qëndron një armik po aq i babëzitur, në mos më shumë, që quhet "shtet", i cili duhet të jetë në mbrojtje të interesave të minatorëve, por praktikisht ai shkel me këmbë pa pikë mëshire punëtorët e lodhur ...

Ata janë baballarë, janë bij nënash, kanë shpirt si gjithë ne të tjerët, janë prej mishi e gjaku, ata janë heronjtë e heshtur të ditëve tona, ata janë minatorët e galerive të Bulqizës. Ndryshe nga heronjtë e filmave e të librave që ne jemi mësuar të shohim e të lexojmë, heronjtë tonë, heronjtë e galerive të Bulqizës nuk luftojnë për famë, as për miliona euro, as për karrige pushteti, as për kauza me prapaskena të fëlliqura politike.

Ata luftojnë për mbijetesë, luftojnë për një kafshatë bukë edhe pse kjo kafshatë mund tu kushtojë të ardhmen dhe jetën e tyre në skutat e errëta të galerive jetë-marrëse.

Këta heronj kanë pranuar shumë padrejtësira në kurriz të tyre, ata kanë pranuar të shtypen e të mos reagojnë, të shfrytëzohen e të mos bëjnë zë, tu mohohen të drejtat e protesta e tyre të mos ketë zë. Ata kanë pranuar gjithçka vetëm për hir të familjes e fëmijëve të tyre, sepse për këta heronj familja është e shenjtë. Nuk do të mjaftonin miliona euro dhe miliona ton krom për ti bërë ata të harrojnë familjet e të shkelin dinjitetin e tyre.

Për ca të paudhë, të pashkolluar, që vetëquhen "bobat e kromit", nuk kanë kursyer as jetët e minatorëve për të marrë ca miliona më tepër e për të mbyllur ca gojë që mund të rrezikojnë statusin e tyre prej "Bobi". Por këta nuk janë armiqtë e vetëm të minatorëve të Bulqizës, pasi ekziston edhe një krye-mafioz tjetër një I ashtëquajtur "shtet", i cili është më anti-social se bandat kriminale të karteleve meksikane, që të vret natën e të qan ditën, dhe më pas të bën sehir me fjalime prekëse e lotë krokodili.

Kur sheh sot galeritë e Bulqizës të ngjajnë me një "ngrehinë të degraduar" nga vitet që mban mbi shpinë, e shkatërruar nga shfrytëzimi barbar për qëllime ngushtësisht personale dhe klienteliste i një rrethi të ngushtë personash të lidhur me hallkat ligjzbatuese që veprojnë në kuadër të sektorit minerar.

Miniera e Bulqizës ka filluar aktivitetin e saj zyrtar më 18 shkurt 1948, vit që shënon edhe datëlindjen e kësaj miniere. Gjigandi i industrisë nxjerrëse në mëse 60 vite jetë numëron mbi 14 milion ton krom të nxjerrë në sipërfaqe. Pas viteve '90 u pa se miniera po shkonte drejt degradimit tërësor të saj. Sipërfaqja e minierës sot është 3 km2 , thotë një ekspert mjedisor nga Bulëiza. Keqmenaxhimi i minierës solli shkurtimin e numrit të punëtorëve, që ra fillimisht në 7 mijë punëtorë në 12 mijë që ishte dhe pastaj në 2500 dhe 1200 në prag të privatizimit në 2001 nga firma koncensionare Italiane Darfo.

Minatorët e Bulqizës, këta "heronj të heshtur" pavarësisht peripecive të pallogaritshme që hasin çdo ditë në punë e tyre, e kanë pasur shumë të zbehtë zërin për të kërkuar të drejtat e tyre legjitime. Duke u izoluar nën këtë heshtje të hekurt, minatorët i kanë përshtatur vetes së tyre statusin e "skllavërisë moderne". Pronarët e këtyre galerive jo vetëm që nuk u ka bërë përshtypje humbja e jetëve të minatorëve të pafajshëm në skutat e galerive, pos tani siç është bërë me dije, ditët e fundit në median e shkruar dhe atë vizive, ata kanë vendosur të ushtrojnë edhe një represion tjetër ndaj minatorëve. Top Channel raportoi se rënia e çmimit në tregjet ndërkombëtare ka sjellë për pasojë mbylljen e disa kompanive mineral-nxjerrëse në Bulqizë. Numri i personave që janë regjistruar si të papunë në "zyrën e punës" rezulton të jetë mbi 50, ndërsa një numër akoma më i madh dyshohet të jetë i atyre që janë përzënë nga puna.

Kjo është sa diskredituese, aq edhe skandaloze, pasi janë ata punëtorë në kurriz të të cilëve ata janë pasuruar, ndërsa sot i hedhin në rrugë në ditën e parë që ulet çmimi i kromit. Dje, kur minerali i kromit kishte shkuar në bursë me çmime të larta, nuk ua rrisnin rrogën minatorëve, ndërsa sot që çmimi ka rënë, I hedhin në rrugë...

Pronarët e galerive nuk janë përgjegjësit e vetëm që minatorët sot po përzihen nga puna si dhe paralajmërohen për ulje rrogash. Në anën tjetër qëndron një armik po aq i babëzitur, në mos më shumë, që quhet "shtet", i cili duhet të jetë në mbrojtje të interesave të minatorëve, por praktikisht ai shkel me këmbë pa pikë mëshire punëtorët e lodhur nga puna e tepërt në miniera, që tanimë po u marrin të vetmen gjë që pothuajse u ka ngelur, po u marrin shpresën për të jetuar.

Një shtet demokratik, siç ne "vetëquhemi", duhet të jetë social me shtresën e varfër dhe gardian i të drejtave ligjore dhe kontratave të parashikuara në Kodin e Punës, pasi nuk mund të përzësh nga puna punëtorët në ditën e parë që ti si punëdhënës pëson ulje fitimi. Kjo praktikë është në shkelje të hapur me çdo dispozitë dhe akt të së drejtës që mbron interesat e punëmarrësit, i cili shihet si pala më e dobët. Pronarët e galerive dhe shteti duhet të sensibilizohen me këta punëtorë e jo ti hedhin në rrugë, sepse mundet që "heronjtë e heshtur" ta humbasin durimin.... Dhe atëherë do të jetë shumë vonë ...

Qyteti me barkun bosh!

Nga **DIONIS XHAFA**

Ekziston një qytet me barkun bosh. Ky qytet nuk është as në hënë, as në qiell, as në re, as mbi ylber e as në diell. Qyteti ndodhet në tokë. Madje në tokën tonë të ujitur me djersë e gjak të sakrificës për një jetë më të mirë.

Qyteti me barkun bosh është i tillë fizikisht dhe realisht, sikundër edhe në mënyrë metaforike. Vërtetë që barku i qytetit është bosh, pasi është ngrënë nga vetë banorët e këtij qyteti kaq të çuditshëm. Banorët këtu e kanë ngrënë barkun e qytetit për të mbushur paksa barkun e tyre.

Sa më shumë që banorët e ngrohin disi barkun e tyre, sa më tepër që pronarët e qytetit e mbushin përplot barkun, aq më tepër barku i qytetit boshatiset. Të parët, punëtorë të kromit në qytetin e tyre rraspapiten tërë kohës me qëllim që të mbushin barkun. Kjo shkakton edhe ekuacionin e mirënjohur zinxhir. Ndërsa punëtorët punojnë fort dhe e ngrohin disi barkun, ndërsa pronarët qëndrojnë me barkun e ngrohtë , nga ana tjetër qytetit i bëhet barku gjithnjë e më i madh.

Si ekuacioni ku një tregues i prek të tjerët, njëjtë funksionojnë gjërat edhe në qytetin me barkun bosh. Kur djersa dhe gjaku i punëtorëve shkon curg, shefat më tepër gëzohen dhe e kanë barkun plot. Kjo ndodh më së tepërmi. Situatë e këtillë bën që qyteti të "hahet" për çdo ditë dhe realiteti është kështu: Nën tokë luhet me jetën për të mbijetuar më pas mbi tokë! Kështu jetohet në tragjizëm të përditshëm.

Ky nuk është qytet përrallash, por se aty jetojnë edhe demonët, edhe djajtë me brirë, edhe përbindëshat, sikundër edhe preja e tyre. Në këtë xhungël e humbur del vetë xhungla pasi prishet e shkatërrohet parreshtur prej vetë banorëve të saj.

Qytetin me barkun bosh e njohin të gjithë. Ky qytet njihet nga të gjithë. E tregojnë si qytetin ku mishërohet vuajtja dhe skamja e shekullit të ri, shekull i i-phoneve dhe i tastierës.

E pamundur të kesh jetuar në këtë tokë dhe të mos kesh dëgjuar për qytetin me barkun bosh. Qytetin e njohin të gjithë. Është fyerje po të mos ia kesh dëgjuar emrin. Qyteti vijon të gëlojë, në të jetohet dhe barkun bosh të saj e kanë dëgjuar si metaforë të mjerimit!

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: <rrugaearberit@gmail.com>

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

Anekdota e muajit

Familjes së Ademit i vjen fjala në darkë se i kishte vdekur një mik i largët i familjes. I thotë gruas së tij: *Nesër do të nismi herët se na ka vdek nji majk i lergjt shpaje.*

U ngritën në mëngjes dhe u nisën për të shkuar tek shtëpia e mikut. Ishte një copë rrugë deri në fshatin e mikut.

I thotë Ademi gruas: - *Ç'at majk t'ma qajsh majër.*

Or burrë e thotë grueja: *"Çaj asht zanati em. Po mi thuj nja di fjalë për çat majk se masanaj ja n'reçi vet. Taj e din majr se na jeni ba shpajë me çat t'vajtuemen teme".*

Shkuen në fshatin e mikut që kishte vdekur. Ademi u fut më parë në konakun e burrave, kurse gruaja shkoi te shtëpia ku qahej i vdekuri. Ademi bëri zakonin në konak dhe u ul. Në këtë kohë u dëgjua vajtimi i gruas së Ademit.

Në konak të burrave e ulën zërin "Ja dha valën ç'kjo vajtimore" – tha njëri në konak. Ademi uli kokën. Të gjithë e kuptuan se ishte gruaja e tij dhe filluan t'i hedhin kutinë e duhanit.

Pasi mbaruan të gjitha shërbimet u nisën për në shtëpinë e tyre. Rrugës i thotë Ademi të shoqes të pushojnë pak ndër një hije. U ulën. Gruaja kishte një bofçe në dorë

- *"Mnerove oj grue"*, - i thotë Ademi.

-*"Po tkam than or burrë se asht zanati em...* – i thotë gruaja. *A e shef bofçën si ma kan mush qët me peshqeshe...!"*

Ademi mendohet pak dhe i thotë:

- *"Oj grue unë nuk grehem prej ç'tu pa e di si do m'qajsh kur t'vdes unë".*

- *"O tu thaftë gjëja or burrë! Mos na najll t'keçen!*

- *"Unë nuk grehem pa mi numru llafet"* dhe shtrihet, vë duart në zemër, mbyll sytë dhe i thotë gruas*: "- Najsja!"*

Dhe gruaja ja nis vajtimit të burrit në hije të dushkut.

- E or Adem, or burri jem, oof, oof! / - Taj ke qan me men, or shpajrti em! ooff, ooff / Taj shkoshe ven e m'ven për t'de kuven / Or burri em! Ooff, ooff / Taj kishe tufat me dhen, or burri em! Ooff, ooff.

Burri hapi sytë dhe i thotë gruas së vet:

- Unje pak se e ke shumë nalt oj grue!

- Or burrë, kshtu qahen ato si vdesin.

- Jo, jo pak ma poshtë se unë nuk kam peshqeshe për t'dhanë taj.

- A ashtu asht or burrë?! Majër pra se po filloj prapë.

"Or Adem or burri em / Taj nuk kishe men or Adem, ooff, ooff / Taj ma qase shpajrtin tem or Adem! / Taj dershe ato dhen or Adem / Për t'ardh mas aletit tem or Adem! ooff, ooff..."

Burri hapi sytë, u ngrit dhe tha: - *Ene kshtu nuk ban oj grue.*

U ngritën dhe shkuan në shtëpi ku i prisnin hallet e tyre...

Ritreguar nga Rruzhdi Bitri

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Shkurti është i shkurtër, por lajmet i kishte të gjatë për Dibrën.

Në fillim duket se rruga po largohet. Kostoja po rritet çdo javë nga 1 milionë dhe qeveria nuk po merr guximin me e hedhë një firmë... janë zënë ministrat te radha e firmës: hidhe ti i pari, ta firmos i dyti, jo po pse i dyti, unë dua i treti, jo po pse i treti, unë s'dua të hedh firmë... Dhe këtu ka ngec puna...

Ndërkohë që presim të hedhim short tek a çift, gurët e mbulojnë herë pas here rrugën që qeveria ka ndërtuar me standarde dhe cilësi. Do Zoti nuk kalon ndonjë makinë ministri a deputeti kur gurët të pushtojnë rrugën, se pastaj do ia hidhnim fajin opozitës për grup armiqësor...

Një ministër të hajrit që kishim në qeveri, na e shkarkuan. E larguan Shkëlqimin. Me sa duket nuk shkonin bashkë edhe Ylli, edhe Shkëlqimi... Qeveria ka nevojë për yje që ndriçojnë më shumë sesa sa të shkelqejnë, që ta shohë gjithë bota mbarë se si po ndriçon ky shkëmb graniti buzë Adriatikut.

Një deputet i yni ka bërë zbulimin e madh: Edvini dhe Koço kanë sabotuar rrugën dhe për këtë e ka meritue "nji voe të llukme"...

Pavarësisht se premtimet po harrohen, ama një gjë e bëri qeveria: një shëtitore për banorët e Bulqizës... Me sheshet kjo qeveri i ka punët mirë, ndaj një mik më propozoi që këtu e më pas të mos kërkojmë ndërtimin e Rrugës së Arbërit, por "sheshin e rrugës së Arbërit", vetëm pak të gjatë...

Në Peshkopi "rilindja" filloi me bliret... Shumë ishin rritë dhe shumë hije bënin. Kishte ftohtë robi edhe në mes të verës. Kështu që kur të vijnë zgjedhjet, një gjë e këmi bërë: nxorëm bulevardin në dritë...

Filluan protestat në Dibër për Skavicën. Protestojmë në Katund të Ri, protestojmë në Maqellarë të vjetër. Pis milet, si nuk i kuptojnë dashurinë e madhe të qeverisë, për të ndërtuar një Dibër të re! Buzë liqenit, pranë varkës me grep gati! Kap peshk e piq, bëj plazh e digju, shëtit me varkë e shijo bukuritë. Në mos si në Parajsë, të paktën si në Zvicër...

Një tel i elektrikut ra nga shtylla andej nga Ostreni dhe mbetën në të ca dele... Jo nga ata që votojnë, por prej vërteti... Fotot pushtuan rrjetet sociale dhe delet dolën në media qendrore. Të ishin dele që votojnë s'do ta kishte marrë vesh kush...

Koalicioni duket se si ka mirë punët në Dibër...Kryetari nuk i hap telefonin deputetit... Dhe kjo s'ka ndodhur kurrë më parë...

Se desh harrova, kishim Shën Valentin këtë muaj... Çdo Sheni në Dibër, do thuash?! Do, mor do, pasi Dibra ka pasur dikur edhe Kisha. Në themelet e njërës po ndërtojmë një xhami. Dhe ngrihet katundi dhe proteston: gjysma do xhaminë mbi themelet e kishës, gjysma tjetër do kishën jashtë themeleve të xhamisë.

Meqë jemi të Shën-i, në Dibër kalohet më mirë se askund... Burri, në vend të luleve - së paku, se puthjet janë të ndalueme, i fut ca shpulla gruas, dhuratë për valentin. Problemi është se tani që kemi bërë shtet edhe celularë, gruaja cërr-cërr zile policisë dhe vjen e i vë prangat burrit. Kështu që del në gazetë dhe në lajmet e orës tetë si lajm i rëndësishëm...

Opinion



Piketat e vendosura për HEC Katundi i Ri. Foto: © Edmond Hasani

Skavica është fjalë e dibranëve jo e politikanëve

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Sikur aksiomat gjeometrike të preknin interesat e njerëzve ata do ti përgënjeshtronin".

Nuk e di pse më erdhi kjo shprehje fiksuar që në rininë time nga një mendim filozofik, tek shikoja një sekuencë filmike televizive të Spahiut të një partie politike në pozicionin e gjelit në majë të grumbullit të plehut.

Spahiu në krye të një tabori me një uniformë të çuditshme, diku si turke (nga xhaketat e mbërthyera deri në fyt) e diku si balliste (nga shqiponja mbi qeleshe) flet për Skavicën.

Në Skavicë jam i sigurt se nuk ka qenë kurrë, madje as nuk e din se ku gjendet në hartë.

Jam i sigurt se asnjëherë nuk është ulur në "Odën Dibrane" për të dëgjuar ndonjë "leksion" nga "lektorë" të Universitetit të Dibrës

Dyshoj në se ka qenë ndonjëherë edhe në Dibër, në të Madhen andej kufirit shqiptaro-shqiptar apo në të Voglën (që Konferenca e Londrës e la pa kokë, pa kryeqendër të saj, Dibrën e Madhe apo Shehrin e Dibrës siç përdoret në të folmen vendase).

Skavica është vënë në gojën e politikanëve si dhëmb i tridhjetë e shtatë. Lakohet në të gjitha rasat, gjinitë, në njëjës dhe shumës, deri në marramendje.

Të gjithë, në përfytyrimin tim, më ngjajnë se për tribunë kanë gjetur "majën e thanës" dhe flasin e flasin sa Zeqies së famshëm, "pronari thanës", i është marrë "maja" bashkë me "zërin".

> Sikur dibranët të thonë me zë të përbashkët: "JO SKAVICËS" interesat e spahinjve të politikës shqiptare për mbytjen e Dibrës do të dështonin...
>
> Skavica është vënë në gojën e politikanëve si dhëmb i tridhjetë e shtatë. Lakohet në të gjitha rasat, gjinitë, në njëjës dhe shumës, deri në marramendje.

Spahiu, me taborin e tij, me dhe pa uniformë, nuk është i vetmi që flet, madje fjalët e tij nuk ndryshojnë as në formë dhe as në përmbajtje nga fjalët e politikanëve të tjerë, liderë partish të mëdha e të vogla, nga zëdhënëse perri të bukura e lajkatare në zë e në pamje. Të gjithë flasin për korrupsion, për allishverishe me kinezë, turq, italianë, gjermanë...pardje, dje, sot, nesër.

Të gjithë si ta kenë marrë leksionin nga e njëjta kokë, flasin për "para xhepi", për qindra mijëra e për miliona euro të marra nga firma që nuk paskan ndërtuar kurrë ndonjë digë lere uji në kullotat verore të bagëtive në male (!)

Asnjë (deri sot ASNJË) nuk flet për Dibrën dhe Dibranët trojet e të cilëve, varret, historia, lavdia e hershme dhe e re, do të përfundojnë në lymin e turbullt të liqenit të Skavicës. ASKUSH !!!

Dibra, nga Mireshi në Draj Reç ka luginën më të bukur dhe më pjellore të Drinit të Zi dhe të lumenjve të tjerë të Shqipërisë. Lugina e Drinit të Zi me fushat e bukura e pjellore të Gjoricës, Brezhdan-Katundit të Ri, Muhurrit, Kastriotit, Fushë-Çidhnës, Dardhës... në shekuj ka mbajt me bukë Malet e Dibrës, ka dhënë "tëlyen e dhjamë" për shpatat dhe pushkët në një seri betejash ku 18 nga 24 beteja fitimtare, Gjergji i Gjon Dibranit-Skënderbeu, i ka fituar në Dibër e bashkë me Dibranët. Për të mos folur më vonë për betejën kundër Hajredin Pashës në Fushë të Gjoricës, për "zënien haps" të Hysni Pashës në "Gjurë të Shpu" e për fitoret dhe rezistencën VETËM kundër pushtuesit serb në vitet 1913-1922 duke mos e lënë Drinin, luginën dhe malet e Dibrës pjesë të Serbisë e duke ua prerë rrugën serbo sllavëve drejt daljes në det, Durrësit, synimi i tyre strategjik.

Për Dibrën, për 65 kilometrat katrore të saj që Skavica përmbyt, për dyzetmijë dibranë që nga mbytja e gjithçkaje të tyre do të jenë të detyruar të shpërngulen, askush nuk flet.

Askush (deri SOT) nuk ka thënë një fjalë të vetme se ku do të vendosen këto mijëra familje që shpërngulen.

Mua, nga kjo heshtje, më ngjan se politikanët tanë në pushtet apo në opozitë, mendojnë se dibranët do ta gjejnë veten siç e gjetën në vitin 1913 kur u shpërngulen nga shpatat, thikat dhe pushkët e serbit...

Spahinjtë e taborëve të politikës shqiptare; të majtë, të djathtë, të qendrës, të tokës, të qiellin... janë vënë në garë kush ta vringëllijë më shumë shpatën kundër të drejtës të popullit të një treve të lashtë në qendrën gjeografike të shqiptarëve, për të jetuar në tokën e të parëve, duke menduar vetëm për xhepin e fryrë të korrupsionit, kampionë botërorë në vrapimin njëqind metërsh me "xhep plot".

Dibra mendohet, bluan fjalën...

Sikur aksiomat gjeometrike të preknin interesat e njerëzve ata do ti përgënjeshtronin...

Sikur dibranët të thonë me zë të përbashkët: "JO SKAVICËS" interesat e spahinjve të politikës shqiptare për mbytjen e Dibrës do të dështonin...

Rruga e Arbërit nr. 118

Me rastin e 20 vjetorit
të ikjes...

përkujtim

Ditët e dhimbjes dibrane, 9 mars '96

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**,
gazetar, dëshmitar i ditës



Ju thoni i nderuar Ministër se "Nga kontrolli i dokumenteve përkatës rezultoi se në vitin 1996 Policia Italiane ka njoftuar Policinë e Vlorës për gjetjen e dy kufomave me emrat Sulejman Qoku dhe Pertrit Qoku nga fshati Kllobçisht i Maqellarës dhe më pas edhe katër kufoma të tjera të cilat nuk mund të identifikoheshin për shkak të dekompozimit"...

Një përgjigje të tillë mund ta presësh nga kushdo por jo nga një ministër rendi. Çelësi për identifikimin e kufomave tashmë është kaq i njohur sa është bërë dhe po bëhet edhe në dhjetëra mijëra apo më shumë njerëz, viktima të Cunamit. Është AND-ja...

A është bërë, qoftë edhe një veprim i vogël në testimin e atyre kufomave nëpërmjet testeve bashkëkohore?...

Me njoftimin që dhatë ju mendoj se keni sjellë një tronditje të re, të thellë, midis familjarëve të viktimave. Ata, me siguri, duan të dinë emrat e atyre djemve, të marrin eshtrat dhe t'i varrosin në fshatin e tyre, pranë dhembjeve të tyre...."

...Ishte 13 marsi, Nata e Verës, dita që ndan dimrin nga vera, ditë tradicionale që në Dibër fillon me mbledhje lulesh, me vendosjen e tyre mbi portat e shtëpive, me zjarre që flakërojnë tërë krahinën, me rite pagane që rrënjëzojnë në mijëravjeçarë...

Dibrës diku i qante e diku i qeshte zemra...

Lajmin e mori me shkrim dore Hamdi Jupe, redaktori i gazetës, një njeri që kishte jetuar për shumë vite në Dibër. E porosita që ta verifikonte edhe në burime të tjera qëndrore dhe ta botonte pa shtuar dhe hequr asgjë. Në jetën time si gazetar gjithnjë i kam pas frikë redaktorët, daktilografistët, linotipistët, korektorët. Jo një herë më kishte ndodhë që të ulja kokën përballë trelave të tyre...

Lajmi u botua në faqen e parë më 14 mars 1996...

Pas meje, me burim nga Vlora, gazeta "Koha Jonë" dhe "Gazeta Shqiptare"përcollën në publik ndonjë lajm të shkurtër, të thatë...

Gazetat pro qeveritare, radiotelevizioni shqiptar... heshtnin sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Partia në pushtet, mandati i së cilës mbaronte më 22 mars, kishte mobilizuar të gjitha forcat dhe mjetet për ta mbyllur "Otranton Dibrane" me kyç të ndryshkur. Ajo ishte futur në hulli të dhunës së pashembullt elektorale të 26 majit 1996, dhunë e cila për mua nisi më egërsisht se kurrë më 14 mars 1996...

Dhunë që më detyroi të largohem natën nga vendi im e tash 20 vjet të jem në troje të huaja...

Si dëshmi të atyre ditëve të vështira ku loti,në sytë e nënave, motrave, nuseve të reja "5 muaj të martuara", nuse - nëna që mbanin në mitër trashëgiminë e jetës, kishte madhësinë e arrës e tek binte çante gurin e digjte drurin, po përcjell fletë nga ditari im, shënime të shkurtra - tituj për tragjedinë që jetonte familja dibrane ato ditë...

FLETË NGA DITARI

E shtunë, 9 mars 1996...

Ditë e bukur, e ftohtë, me diell. Në mbrëmje nisi dëborë...

Sipas nënës time të dashur sot, 5 ditë para Ditës së Verës, 55 vjet më parë, kam lindur. I lindur më 9 mars 1941, jam regjistruar më 11 maj 1941...

E diele, 10 mars 1996

Ka rënë borë, pak centimetra, flokon lehtë. Ditë e ftohtë marsi...

E martë, 12 mars

Ditë me dëborë (në mëngjes 30 centimetra), dëborë që s'pushon së rëni. Rrugë të bllokuara. Telefona pa zë. Për Tiranë nuk udhëton asnjë mjet. Gazetat nuk erdhën.

E mërkurë, 13 mars 1996: Kohë e butë, ditë me diell. Dëbora e cila që nga 9 marsi nuk rreshti, vazhdon të shkrijë...

Shefqet Rusi më informon se Maqellara ka shpërthyer në lot. Në brigjet e Otrantos është gjetur trupi i pa jetë i djalit të Zaudin Qokut nga Kllobçishti. Ai ka qenë në një gomone me 30 vetë të tjerë që synonin të shkonin në Itali... Shkëlqim Farruku nga Greva troket tek dera e shtëpisë dhe pa hyrë brenda pyet për djemtë e tij në Greqi. Pyeti dhe iku. Nuk mora vesh pse gjithë ky nxitim. Mos vallë Pëllumbi (kushëriri im) është nisë për në Itali !?

Nisa të shkruaj...

"Lajmi i zi arrin në Maqellarë. Komisariati i Vlorës njofton komisariatin e Peshkopisë se një djalë i ri nga Maqellara e Dibrës është gjetur i vdekur në breg të detit, nxjerrë nga valët e ftohta të tij.

Njerëzit e familjes, me dhimbjen e madhe për njeriun e tyre të dashur nisen për të marrë djalin e vdekur. Në Vlorë mësojnë se kufoma nuk është gjetur në brigjet e detit shqiptar por në anën tjetër të detit, në brigjet e Otrantos.

Në Maqellarë të Dibrës është hapur mort. Familja Qoku pret e përcjell njerëz, pret të vijë djali i tyre i shtrenjtë.

Por në Maqellarë tmerri i vdekjes është më i gjerë, më i madh, i pranishëm në dhjetëra familje. Kjo lidhet me faktin se njëkohësisht me djaloshin Qoku janë nisur në drejtim të Vlorës, e më tej me gomone në drejtim të Italisë, tre mikrobusë me djem të rinj, rreth 30 vetë. Deri tani për ta nuk ka asnjë lajm, asgjë që të qetësojë zemrat e ngrira nga tmerri të nënave, baballarëve, motrave, grave, fëmijëve, të afërmve të këtyre familjeve.

Një djalë i ri është gjetur i vdekur në brigjet e detit italian. Dhjetëra djem të tjerë nuk dihet ku janë, nuk dihet në se kanë arritur në brigjet e ëndrrës së tyre për një jetë më të mirë apo i kanë përpirë dallgët e zeza të detit. Familjet pranë zyrave të postë telekomunikacionit pyesin në adresa të ndryshme në shtetet fqinj dhe nuk marrin përgjigje.

Duke uruar që djemtë të kenë arritur shëndosh e mirë në Itali e familjet e kësaj zone të mos shohin gjëmë e kob, Maqellara kërkon të hidhet zyrtarisht dritë mbi këtë ngjarje të rëndë, të qetësohen zemrat e ngrira të prindërve.

Peshkopi, 13 mars 1996

E enjte 14 mars . DITË VERE '96. Kthjellët lart, mjegull e dendur luginës së Drinit, nga Maqellara në Dardhë e Reç...

Vazhdon alarmi tmerrues. Kabinat telefonike në Maqellarë e Peshkopi janë të zëna. Nuk reshtet së kërkuari njerëz të afërm në Itali. Flitet për pesë djem nga Greva të humbur. Erdhi Pëllumbi (djali i tezes) dhe më tha se nuk kishte shkuar në Itali...

"Zëri i Popullit" ka botuar lajmin tim në faqen e parë, poshtë, në krah të djathtë...

E premte 15 mars. Ditë me shi. Bora shkriu. "Gazeta shqiptare" boton lajmin mbi humbjen e një skafi ku kanë qenë, "34 vetë nga Dibra" dhe gjetjen në brigjet e Otrantos të kufomës së Sulejman Qokut nga Maqellara.

E shtunë 16 mars. Ditë e vranët. Asnjë lajm për djemtë e humbur në skafin e Vlorës. Shteti hesht. Hesht dhe si për karshillëk nxjerr në televizion një skaf bosh...në Shëngjin ! Z. Dani, oficer civil, i ri në moshë, buçko, me një nishan në faqe, më konfirmon ardhjen e një lajmi për vdekjen e Sulejman Qokut në Itali. Ai shton se hollësirat i din mirë z. Mulosmani në Vlorë...

E diele 17 mars. Kohë me shi. Qielli qan... Vazhdojnë kërkimet telefonike për të humburit e 9 marsit. Gjendja është tepër e rëndë.Asnjë lajm. Heshtje mortore në media, heshtje që vret...Një djalë i ri nga Greva, oficer i veshur civil, djali i kryetarit të PD-së së fshatit, i cili ka humbur djalin e xhaxhait dhe të hallës, me dorën mbi kobure më kërcënon pse kam shkruar në gazetë. Me sa duket PD-ja "dhimbjen po e kthen në forcë"... kundër fjalës së lirë... kundër gazetarëve !

E hënë 18 mars. Ditë e vranët. Shi i imët... Pajtim Aga ka njoftuar se grupi i eksodit ka përfunduar në ishullin grek të Korfuzit. Njerëzit mbahen në burg...

Dëgjova njërën anë të bisedës telefonike, të gruas së një shokut tim me Maqellarën. Pash për herë të parë pas kaq ditësh lot gëzimi në sytë e një gruaje e cila sapo mbaroi bisedën vrapoi drejt Melanit për ti dhënë të motrës sihariqin se djemtë janë gjallë. Sonte ka gëzim në familjet dibrane. Gëzimin e tyre ia përcolla Kiços në "Zërin e



Populli" me porosinë që lajmi të konfirmohet me Ramazan Ilnicën, prokuror në Vlorë, dibran, i cili citohej si burim i këtij sihariqi..

E martë 19 mars. Natën ka rënë një puhizë dëbore...

Në PTT, njeri nga aktivistët më të egër të rrugës të PD-s, ish kandidat për deputet në Shupenzë në zgjedhjet e 30 marsit 1991më kërcënon me jetë...

Shëtitorja e Blirëve është bllokuar nga makina targa verdha. Partia Demokratike zhvillon aktivin e saj. Ka ardhur edhe Tritan Shehu, kryetar i PD-së...

E mërkurë 20 mars. Shi, shi dhe prapë shi. Qielli derdh lot. Lajmi i gëzuar i dy ditëve më parë është zbehur. Lotët kanë ngrirë. Përsëri rrahin telefonat. Drejt Vlorës ku kanë shkuar shumë familjarë të të humburve, drejt Italisë por edhe drejt Greqisë. Në Athinë, sekretar ambasade është Ahmet Lala, dibran. Zilja e telefonit të tij nuk pushon së thirruri...

Shteti vazhdon të heshtë për djemtë e Dibrës. Heshtje e madhe ! Pse ?

E enjte 21 mars. Shi i ftohtë marsi...Njerëz që kërkojnë djemtë e skafit. Kërkojnë me telefon. Kanë shkuar e kërkojnë në Vlorë. Kërkojnë dhe nuk marrin përgjigje. Në publik thuhet se Tritan Shehu në aktivin e PD-së një pyetjeje nga salla për djemtë e 9 marsit i është përgjigjur me ngritje karakteristike supesh, me një murmurimë "Nuk di gjë". A e beson kush se me të vërtetë numri Një i Partisë Demokratike "nuk di gjë"?

Edhe në Bulqizë paska nisur sulmi ndaj meje për lajmin e 14 marsit. Shoferi i kryetarit të PD-së, i paska thënë një njeriut tim "Abdurahimi ka shkruar për mbytjen e skafit. Do ta linçojmë ?"

Pyes: Pse i djeg kaq shumë Partisë Demokratike kjo ngjarje? Pse kërkon ta fshehë kaq brutalisht 9 Marsin 1996 ?

E shtunë 23 mars. Ditë e vranët...

Një pensionist më thotë se I... një polic elektrik, kobure e PD-së, më paska dënuar me "Tre muaj burg për përhapje lajmi të rremë" !...Një kushëri imi më thotë se drejtori PD-ist i fabrikave të makaronave paska ofruar (nga arka e ndërmarrjes) një milionë lekë për atë që rreh Abdurahimin. Nuk e di se sa e kanë paguar "policin" në gjakosjen në zyrë që mu bë tre vjet më parë ...

E diele 24 mars. Ditë me diell, e ngrohtë sa xhupi nuk mbahet më. Ruzhdi Merdani. më kap në rrugë dhe më thotë që të ruhem se disa grevas janë përgatitur për të të rrahur për lajmin e refugjatëve...

E mërkurë 27 mars. Qielli qan. Dibra mërdhih. Televizioni shqiptar, pas 18 ditë heshtjeje më në fund bëhet i gjallë. Spikerja njofton thatë se në brigjet e Italisë është gjetur një kufomë dhe se 29 dibranë të nisur me një skaf më 9 mars kanë humbur...

Telefonat me Tiranën nuk punojnë. Luan C. më pyet për ikanakët e skafit. Ka nipin dhe e kërkon. Tha se do të shkojë në Vlorë. Është i pari kuadër i PD-së që më flet njerëzisht.

E enjte 28 mars. Erdhi në shtëpi Shkëlqimi dhe më foli për sulmet ndaj meje në Grevë. Më bëri thirrje që të mos shkruaj. Nuk e kuptova: kishte ardhur vetë apo e kishin dërguar ?! Nuk e kuptoj pse po tregohet kaq i egër Ajet Fida, një shok banke i viteve 1952-1954 në shkollën shtatëvjeçare të Peshkopisë, një familje që ka nxjerrë duzina komunistësh, sot drejtor shkolle? Ai është bërë kryetar i PD-së së fshatit. Është organizator i gjithçkaje. Bukur thotë Haveli "Më të zi se korbi janë komunistët e bërë demokratë"

Fola me Kiçon në redaksi. Folëm për shkrimin që dërgova pas lajmit të djeshëm të televizionit. Më tha se Gëzim Tushe nga Vlora kishte bërë një shkrim për të humburit e Dibrës por nuk ia kishin botuar!?

Pse Thoma Gëllçi dhe stafi qendror i ZP-së i qëndron larg kësaj ndodhie të dhimbshme.

Po Partia Socialiste pse hesht?

Këto pyetje më mundojnë dhimbshëm...

E premte 29 mars 1996. "Zëri i popullit" boton shkrimin "Ku janë djemtë e Dibrës" me nëntitujt...

-Një i mbytur në brigjet e Otrantos, varrosur para pesë ditësh në Kllobçisht të Maqellarës.

-Një tjetër i mbytur në brigjet e Otrantos, i pa identifikuar.

-29 djem të Dibrës, hipur në skafin e 9 marsit nuk dihet ku janë.

-Vaje e lot në Maqellarë, Grevë, Melan, Brezhdan etj. për djemtë e humbur.

E mërkurë 3 prill. Udhëtim për në Tiranë. Në redaksi mësova disa hollësi për lajmin që kisha dërguar më 13 mars. Mësova se Bashkim Gazidede dhe Avni Shehu kërkesës për konfirmim të lajmit i ishin përgjigjur në një zë: "E dimë por nuk na intereson ta japim". Komenti është i tepërt...

E martë 14 maj 1996. "Zëri i popullit" në faqen 10 në "Human Right Watch raporton: " Abdurahim Ashiku, Zëri i Popullit: "Një korrespondent i "Zërit të Popullit" në zonën e Dibrës, zoti Ashiku, u rrah keq në zyrën e tij më 22 prill 1993 nga tre vetë. Ashiku kishte shkruar një artikull për një anëtar të ekipit të kontrollit të shtetit që sipas raportimeve shtiu pushkë në një urban, duke plagosur një njeri. Që nga ajo kohë ai thotë se është kërcënuar nga Medat Kaca, shef i ekipit të kontrollit në Dibër:"

E diele, 19 maj 1996. Ditë me diell, e nxehtë. Sot, në minutat e para të ditës së re, në mesnatë, ka arritur në Peshkopi Sali Berisha në krye të 69 makinave (një pensionist i pa gjumë i kishte numëruar tek kalonin përpara dritares së tij nëpër Shëtitoren e Blirëve). Dyndje e madhe "salijugenësh" nëpër qytet, thirrje histerike, bori makinash që nuk pushojnë, zhurmë e madhe...

Peshkopia nën një trusni të pa parë kurrë...

Sali Berisha erdhi natën në Dibër. Populli thotë se nata është e hajdutëve...Në Kastriot paska përuruar fillimin e punimeve (!) të ujësjellësit të Sopanikës. Unë e kam shkelë tërë trasenë e atij ujësjellësi, mbi 60 përqind e punimeve të tij (përfshirë edhe shtrimin, saldimin dhe mbulimin e tubacione) pat përfunduar që në vitin 1988-1990.

Pika loti të mbledhura njëzet vjet
në një grusht që rrjedh...


AKTUALITETE

Peshkopi

Ku janë djemtë e Dibrës?

-Një i mbytur në brigjet e Otrantos, vazhdon para javë dëbimi në Kllobçisht të Maqellarës.

-Një ditët i mbytur në brigjet e Otrantos, i paidentifikuar

-29 djem të Dibrës, bypur në shtatore 9 martirizuar, dëbet ku janë

-Vajze e bijt të Maqellarë, Grevë, Melan, Brezhdan etj, për djemtë e humbur.


Një i mbytur në det dhe 30 të gjerë të humbur. Të gjithë nga Maqellara e Dibrës

Viktima të eksodit

Një ngjarje e rëndë ka tronditur këto ditë jetën e zonën e Maqellarës të rrethit të Dibrës.Tronditja vjen nga lajmi se, një djalë i Ziaudin Qokut nga Maqellara, i nisur rreth një javë më parë ilegalisht për në Itali,është gjetur i mbytur në ujërat e Otrantos në bregun jetër të Adriatikut.

rreth trullosjetë persona të tjerë nga kjo zonë.Familjet e tyre janë lidhur me të afërm në Itali,por asnjeri prej tyre nuk ka konfirmuar mbërritjen e njerëzve të kërkuar,të nisur nga Shqipëria.Hipotezat se ata kanë qenë në të njëjtin skaf me Qokun e mbytur dhe për pasojë kanë patur të njëjtin fat, i ka terrorizuar njerëzit.



Ende asnjë lajm për 40 dibranët e zhdukur

Ku bie Santa Maqellara?...

14 marsi, dita kur fëmijët bëjnë ritet e Ditës së Verës, kur nuset dhe vajzat e reja sjellin në shtëpi ujin e kristaltë të krojeve, ky 14 mars, këtë vit, fushën e Maqellarës e gjeti nën dëborë. Poshtë saj nxinte toka e mbi të rëndonte i plumbtë qiellin... **Ndodh që nuk kthehen as të vdekur ...**

qipëria, lexuar nën lotët çurk para varreve, sa vijnë e shtohen. Djemtë kthehen në arkivole druri e metali.

Trupi i pajetë i Sulejmanit u preh në gjirin e

Në Maqellarë, në mitingun e organizuar, Sali Berishës i është bërë një pyetje për djemtë e humbur më 9 mars 1996. "Nuk di gjë" është përgjigjur Saliu. Dhe pa e mbaruar frazën e nën zëshme ka dhënë direktivën "Ata që kanë tokë ta mbjellin grurë e misër. Ata që nuk kanë tokë ta mbjellin...çfarë të duan" dhe "kur isha mjek më vinin Maqellarasit me sëmundjen e misrit!" (!)

Maqellarë 15 maj 1996. "Zëri i Popullit" boton..."Ku bie Santa Maqellara" ? me autor Q. Hamzaj...

Po e zbardh...

14 marsi, dita kur fëmijët bëjnë ritet e Ditës së Verës, kur nuset dhe vajzat e reja sjellin në shtëpi ujin e kristaltë të krojeve, ky 14 mars, këtë vit, fushën e Maqellarës e gjeti nën dëborë. Poshtë saj nxinte toka e mbi të rëndonte i plumbtë qiellin...Por më i zi e i rëndë se plumbi erdhi në familjen e Ziaudin Qokut në Kllobçisht lajmi i kobshëm se djali i tij 20 vjeçar, Sulejmani, i sapomartuar, humbi jetën në det, duke kaluar me skaf për në Itali...

Djemtë e Maqellarës, mjeshtër në bujqësi e punëtorë të fronteve më të vështira në minierë e gjeologji, mbetur pa punë, u janë drejtuar rrugëve të kurbetit, rrugëve të Maqedonisë, Greqisë, Italisë. Vetëm në një vend në rrethinat e Napolit punojnë më shumë se njëmijë Maqellaras. Vendi ku punojnë më shumë thirret Santa Maqellara, se sa me emrin e vet, Santa Maria.

Dhe ndodhin ngjarje të kobshme...

E prapë emigrimi vazhdon. Rendin të rinjtë Maqellaras drejt shpresës së madhe si fluturat drejt dritës, ndonëse si fluturat edhe digjen. Mjaft prej tyre kthehen me ndihmat e bashkëkombësve, me ndihmat e qytetarëve të mirë italianë. Listat, me emrat e njerëzve nga e gjithë Shqipëria, lexuar nën lotët çurkë para varreve, sa vijnë e shtohen. Djemtë kthehen në arkivole druri e metali. Ndodh që nuk kthehen as të vdekur...

Trupi i pa jetë i Sulejmanit u preh në gjirin e vendlindjes.

Për djelmoshat e tjerë, 29 a më pak, kryesisht Maqellaras, që ishin në të njëjtin skaf, asnjë lajm, asnjë shenjë. Dikush tha se i ka marrë një anije e huaj. Dikush thotë se janë burgosur në një vend të huaj. TVSH, tepër thatë, dy javë më pas njoftoi vdekjen e Sulejman Qokut dhe të një viktime të pa identifikuar. Tha se ekspertët shqiptarë më 18 mars kanë shkuar në Itali për të ndriçuar ngjarjen.

Që atëherë heshtet...

Ankth dhimbjeje dhe pritjeje, vegim shprese në familjet e 2 vëllezërve në Burim, të 2 vëllezërve Elezi në Vojnikë, të njerëzve të një gjaku e të një moshe në Kllobçisht, Majtarë, Burim, Vojnikë, Maqellarë, Grevë, Melan, Trepçë, Rashnapojë, Brezhdan...

Dhembje pritjeje e pranishme në çdo familje dibrane...

Emigrantët në Itali pyetjen e parë për ikanakët e kanë "Mos jeni ato të skafit të 9 marsit?..."

E mërkurë, 22 maj 1996. Ditë e nxehtë, pak e vranët...

Në Grevë tek A. Fida udhëheqja e lartë e rrethit me kandidatin për deputet, zëvendës ministër i mbrojtjes, ngre dolli për fitoren. Eshref Fidës, shofer i parkut automobilistik shpallur komunist në vitet '90-të, i cili është kthyer nga Italia për të pritë njerëzit për djalin e humbur në dallgët e Otrantos, i kanë çuar për aheng prapavijën e taborit elektoral, shoferë e të tjerë. Thonë se pasi u dha raki sa u frynë i bëri të ngrihen në këmbë dhe me grushtin lart të këndojnë "Enver Hoxha, tungjatjeta!"!!!

E premte, 24 maj 1996. Një grup njerëzish, me Azem Hajdarin në krye, kanë goditur për ta vdekur kryetarin e Partisë Socialiste të Bulqizës Muharrem Kolën dhe e kanë hedhur në një përrua në Ostren. E kanë gjetur fshatarët dhe e kanë çuar në shtëpi nga ora 12.30 e natës. Në orën 2 ka ardhur policia të hyjë në shtëpi. Në orën 7 e kanë marrë me forcë dhe e kanë hedhë gjysmë të vdekur në burg...

26 maj 1996- 21 korrik 1996. Koha më e vështirë e jetës sime. Më 27 maj,. nën krisma revolesh e automatikësh PD feston "fitoren" në sheshin "Nazmi Rushiti". Drejtuesit e Partisë Socialiste të Dibrës kanë kaluar në ilegalitet. Nuk mund të dal bulevardit. N. D. Nga Pollozhani më del në mes tëbulevardit dhe më kërcënon se po pashë nga klubi "26 maji" (emër i vënë një ditë më parë) do të të thyejmë kokën. Në një tavolinë një grup "hitlerjugenësh" qeshnin e duartrokisnin. Në mes të bulevardit digjen publikisht të gjitha gazetat Zëri i popullit" dhe "Koha jonë".

Gazeta "Dita informacion" boton një shkrim me titullin "Kërcënohet gazetari i "Zërit të popullit"...

Vjen momenti më i vështirë. Më jepet ultimatumi: "O mbylle gojën ose do të rrëmbejmë fëmijët"! Tentuan të më rrëmbejnë vajzën. Fati e solli që në atë moment ishte me të ëmën, mësuese e respektuar në Peshkopi. Në krye të degës së PD në Peshkopi është djali i dajës i bashkëshortes time. "O tempora o morës", ku jemi katandisur!

Nuk më mbetej rrugë tjetër. "Situata mjaft e turbullt. Ikja trimëri e ditës..." shënoja në ditarin tim më 8 korrik 1996.

Më 21 korrik, ditën e ikjes, do të shënoja... "Me Indritin, nisja në orën 6 të mëngjesit. Pritje katër orë në Kakavi...Kthim nga autostrada e Patrës për arsye bllokimi...Arritje në Athinë në orën 2.30 pas mesnate. Në Perama taksixhiu na kërkoi 15 mijë dhrahmi kur rruga bënte vetëm dy mijë. Në xhep kisha gjithsej vetëm pesëmbëdhjetë mijë. Ishte udhëtimi më i varfër i jetës sime. I dhashë pesë mijë, dy herë e gjysmë më shumë..."

Ika, lash atdheun, lash Dibrën që më rriti e më bëri njeri. Me vete mora "penën". Pa të jeta në mërgim nuk kishte bardhësi.

Pas një viti përpjekjesh u bashkua e gjithë familja...

Nuk e përjetova "97-tën. Mbase sot nuk do të isha duke shkruar...

TETË VJET MË VONË..

E enjte, 15 janar 2004. Igli Toska, Ministër i Rendit në një paraqitje në Kuvend për të parën herë deklaron publikisht se"do të isha i padrejtë të mos përmendja edhe tragjedinë e 30 dibranëve në 09 mars 1996 që u mbytën. Askush nuk tentoi t'i shpëtonte dhe mizorisht fakti iu fsheh publikut dhe familjeve të tyre"!

4 mars 2004, gazeta "Ballkan": Kreu i komisionit parlamentar të Rendit e SHISH-it, Neritan Ceka, u shpreh dje për gazetën "Ballkan", se po dje i kishte kërkuar takim motra e dy vëllezërve të humbur gjatë tragjedisë së 9 marsit 1996 në Otranto. "E prita dhe dëgjova shqetësimin e saj, madje i kërkova edhe një shkresë ku të paraqiste ankesën përkatëse. Ajo më vuri në dijeni për ato që dinte dhe për dyshimin se vëllezërit e saj janë gjallë dhe mbahen të mbyllur në një kamp, por që nuk mund të jetë e besueshme", tha kreu i komisionit, Ceka. Por ende nuk ka ndonjë material konkret për këtë ngjarje, pasi janë edhe shumë viktima. Ceka pohoi se e afërmja e dy vëllezërve të zhdukur në këtë tragjedi ishte ankuar edhe pas ngjarjes tek ish presidenti Berisha dhe ky i fundit i kishte dhënë përgjigjen se "Deti ka ngrënë dhe do të hajë shumë viktima". Do të interesohem vetë për këtë ngjarje për t'i mësuar të vërtetat', përfundoi kryekomisioneri Ceka.

9 mars 2004. Gazeta "Emigranti", gazetë për komunitetin shqiptar në Greqi, boton shkrimin "Të vërteta dhe mite për "Djemtë e Dibrës".

17 e 18 mars 2004. Në dy numra nga dy faqe, gazeta "Koha jonë" boton shkrimin tim "Ku janë Djemtë e Dibrës"

"KLAN", Dibranet vdiqën...I ka rënë ministrit të Rendit Publik Igli Toska, detyra e rëndë për t'u komunikuar familjarëve të një grupi të rinjsh dibranë që ishin zhdukur prej shumë kohësh nga shtëpitë e tyre, se hetimet për fatin e tyre kanë nxjerrë në dritë se ata janë mbytur gjatë përpjekjeve për të mbërritur ilegalisht me skaf në Itali dhe se shpresat për t'i pritur ata të mbërrijnë të gjallë ose për të marrë ndonjë lajm, duhet të ndërpriten.

Lajmi i hidhur vetëm sa ka konfirmuar frikën që familjarët mbanin brenda vetes për shumë vite, ndërkohë që kishte qenë vetë kryeministri Nano, gjatë një vizite në Maqellarë, ai që u kishte premtuar atyre se do të bënte të pamundurën për të zbardhur fatin e të zhdukurve.

Kanë mjaftuar vetëm disa muaj dhe përgjigja ka ardhur. Edhe pse negative.

29 mars 2005.Ministri i Rendit Publik, Igli Toska, ka shkuar sot paradite në Maqellarë të rrethit të Dibrës, për të informuar familjarët e 29 personave të humbur në 10 mars të vitit 1996 në detin Adriatik, mbi përfundimin e hetimeve të bëra nga strukturat e Policisë së Shtetit mbi fatin e këtyre personave.

Hetimet rreth kësaj ngjarjeje të rëndë u rihapën pas interesimit të Kryeministrit Fatos Nano dhe urdhrit të ministrit të Rendit Publik, disa muaj më parë, për t'u dhënë një përgjigje kërkesave të familjarëve, që prej 9 vjetësh nuk kishin asnjë informacion për fatin e njerëzve të tyre.

Hetimet janë kryer në bashkëpunim të ngushtë me policitë e Italisë dhe Greqisë, duke kontrolluar të gjithë dokumentacionin e kohës kur ka ndodhur ngjarja, madje duke kontrolluar edhe të gjithë shtetasit e burgosur në burgjet e këtyre shteteve që nga viti 1996. Oficerët e ndërlidhës tëMinistrisë së Rendit në Itali dhe Greqi kanë marrë në intervistë të gjithë shtetasit shqiptarë që janë arrestuar në periudhën e lartpërmendur.

Në përfundim të hetimeve rezultoi se të 29 shtetasit nga Maqellara e Dibrës dhe tre personat që drejtonin skafin nga Vlora janë mbytur. Nga kontrolli i dokumentacionit përkatës rezultoi se në vitin 1996 Policia Italiane ka njoftuar Policinë e Vlorës për gjetjen e dy kufomave me emrat Sulejman Qoku dhe Petrit Qoku nga fshati Kllobçisht i Maqellarës dhe më pas edhe katërkufoma të tjera të cilat nuk mund të identifikoheshin për shkak të dekompozimit.

Prokuroria e rrethit Vlorë ka nisur procedimin penal për këtë çështje të cilën e ka pezulluar në 10 tetor 1996. Personat që kanë luajtur rolin e sekserëve në grumbullimin e njerëzve, janë amnistuar në vitin 1997 nga presidenti i asaj kohe.

Rreth një vit më parë Policia e Vlorës ka arrestuar shtetasin Sokol Veizi, i cili ka qenë pronari i skafit të mbytur.

29 mars 2005. Sot ministri i Rendit Publik në familjen e Abdulla Hakores, i cili ka humbur djalin në këtë ngjarje tragjike.Ndërsa u ka dhënë familjarëve lajmin e hidhur ka qenë i pari që i ka ngushëlluar sipas zakoneve të vendit. Ministri Toska ka premtuar në emër të qeverisë se do të shihen të gjitha mundësitë për të ndihmuar financiarisht fëmijët e viktimave.

Athinë, 2 prill 2005. Në një letër të hapur në adresë të ministrit të Rendin Igli Toska, ndër të tjera shkruaja...

...Ju thoni i nderuar Ministër se "Nga kontrolli i dokumenteve përkatës rezultoi se në vitin 1996 Policia Italiane ka njoftuar Policinë e Vlorës për gjetjen e dy kufomave me emrat Sulejman Qoku dhe Pertrit Qoku nga fshati Kllobçisht i Maqellarës dhe më pas edhe katër kufoma të tjera të cilat nuk mund të identifikoheshin për shkak të dekompozimit".

Unë, në atë kohë, kam pas mësuar për gjetjen e kufomës vetëm të njërit, të S. Qokut, që deputeti i PD-së, njeriu i afërt i tij, Agron Qoku shkoi dhe e njohu vetë dhe e solli në Kllobçisht ku ka edhe sot e kësaj dite varrin e vet. Ju jepni edhe një emër, që të paktën unë nuk e kam ditë si të vdekur, të Petritit, por nuk jepni emrat e katër personave të tjerë që "nuk mund të identifikoheshin për shkak të dekompozimit".

Një përgjigje të tillë mund ta presësh nga kushdo por jo nga një ministër rendi. Çelësi për identifikimin e kufomave tashmë është kaq i njohur sa është bërë dhe po bëhet edhe në dhjetëra mijëra apo më shumë njerëz, viktima të Curnamit. Është AND-ja. A është bërë, qoftë edhe një veprim i vogël në testimin e atyre kufomave nëpërmjet testeve bashkëkohore? Me njoftimin që dhatë ju mendoj se keni sjellë një tronditje të re, të thellë, midis familjarëve të viktimave. Ata, me siguri, duan të dinë emrat e atyre djemve, të marrin eshtrat dhe t'i varrosin në fshatin e tyre, pranë dhembjeve të tyre. Këtë, i nderuar Ministër duhet ta bëni. Dhe ta bëni sa më shpejt të jetë e mundshme" .

E enjte 11 mars 2011 "Plus Gazeta e Athinës"."Tragjedi dibrane '96" Shteti harron dhe hesht. Një lajm që doja ta kisha shkruar...

E hënë, 25 janar 2016.

I nderuar profesor Duro! Takova mikun tim, profesor Qamil Sulën dhe më hodhi idenë e një libri për skafin e mbytur të Maqellarës, për te cilin kishit diskutuar. A mund të më thuash mendimin tënd për këtë çështje?

Me respekt

Osman Xhili

E hënë 25 janar 2016.

Unë kam një zarf kompjuterik me materiale për këtë ngjarje të rëndë dhe kam qenë i gatshëm ta botoj. Arsyeja pse nuk e kam botuar është se dibranët që iu mbytën fëmijët besojnë se ata janë në një burg të sigurisë së lartë në Korfuz.

U jam drejtuar një pjese të madhe të tyre por ata nuk flasin asnjë fjalë.

Kam takuar ish deputetin e Maqellarës Agron Qoku, i cili shkoi në Itali dhe mori trupin e pa jetë të kushëririt të tij. Më premtoi që tu përgjigjet pyetjeve të mija në një intervistë me të për ngjarjet e 9 marsit 1996.

I jam drejtuar edhe katundarit tënd Ramazan Ilnica që ishte asokohe prokuror në Vlorë që të më vejë në dispozicion dosjet e hetimeve të atyre ditëve dhe përjetimet e tij por nuk më është përgjigjur.

I jam drejtuar edhe katundarit tim Abdulla-Hakorja, i cili humbi djalin dhe në shtëpinë e tij ministri i rendit Igli Toska piu kafen e humbjes së djalit dhe deklaroi se ata janë mbytur dhe nuk më është përgjigjur.

Pa këto prononcime një libër për ta është i zbehtë. Unë çdo 9 mars, tash 19 vjet botoj shkrime si homazh për këtë ngjarje që Berisha me Gazideden etj. e mbyllën sepse donin qetësi në zgjedhjet e tmerrshme të 26 majit 1996.

Ishin këto zgjedhje, ishin shkrimet e mija (dhe shkrimi i Qamil Sulës me pseudonim) që më detyruan mua të iki natën nga Dibra dhe Shqipëria sepse më kërcënuan: "O mbyll gojën ose do të rrëmbejmë fëmijët"!. Dhe provuan ta bëjnë me vajzën time.

Një libër për ta dhe një monument përkujtimor tek ura e Topojanit ku nënat, motrat, gratë... të mblidheshin çdo 9 mars për të hedhë lulet e Ditë Verës për t'ia përcjellë detit dhe shpirtit të "lofkës së zemrës", do të ishte nder dhe vlerë për Dibrën.

Dibra, fatkeqësisht e ka gojën të mbyllur për këtë ngjarje. Vlora, Shkodra etj. hedhin lulet e kujtesës çdo vit në ditët e tragjedisë së marsit '97 për mbytjen e "Katerit të radhës" dhe tragjedinë e Karaburunit...

Po qe se ti si Maqellaras më bëhesh krah atëherë bëjmë librin me dy emra, timin dhe tëndin.

Unë edhe këtë vit të 20 vjetorit të ikjes, si çdo vit tjetër do të shkruaj dhe do të zbres në bregdetin e Pireut dhe do të hedh një tufë me lule në kujtim të Djemve të Dibrës, këtyre "Zogjve të malit"...

Me respekt

Abdurahim Ashiku
Athinë, 25 janar 2016

E diele 21 shkurt 2016...

Radhët e këtyre shënimeve, me një pikë loti që rrjedh brazdave të 75 vjetëve të moshës sime, po i mbyll me"Një këngë beratase kushtuar të rënëve të Dibrës..."me titull:"Otranto, Port i Dhimbjes dhe Shpresës" përcjellë në adresën time nga poeti i njohur Namik Selmani...

...O zot, mos më keq!
Mos të pafsha më,
O Ditë e marsit në Otranto!

Athinë, 21 shkurt 2016


Foto © Edmond Hasani

Krasitja do t'u rikthejë blirëve **bukurinë**

Opinion nga Dr. Selman Mëziu, specialist i njohur në fushën e mjedisit

Një ditë shkurti qyteti i Peshkopisë u gdhi, në atë që fillimisht u quajt si një "masakër" mjedisore ndaj blireve. Në rrjetet sociale u përhapën me shpejtësi reagimet - shumica negative, çka e detyroi Bashkinë të dilte me një qëndrim zyrtar në faqen e saj në Facebook.

"Rreth viteve 1970 janë mbjellë 135 dru dekorativë të llojit bli, të cilat sot janë të moshës 45 vjeçare, thuhet në reagimin e Bashkisë, ndaj, duke marrë në konsideratë moshën e tyre u pa e arsyeshme nga specialistët e fushës, në konsultë dhe me specialistë jashtë institucionit, për të bërë një krasitje të rëndë ripërtëritëse, zgjatje jete. Planifikimi i realizimit të këtij procesi është përcaktuar me buxhetin e vitit 2014 dhe 2015 të Bashkisë Peshkopi dhe mendojmë që është e vonuar si ndërhyrje".

Më pas, Bashkia, për të justifikuar këtë ndërhyrje, solli një sërë argumentesh, siç ishte zgjerimi i kurorës jashtë normales, mbi 15 m, e cila kishte filluar të deformohej, lulëzimi i blireve vetëm në lartësinë mbi 10 m, zhveshja e tyre, krijimi i dëmuesve, rënia e fuqisë ripërtëritëse etj.

Për një opinion më të saktë dhe të pavarur nga qëndrimet politike, ne iu drejtuam bashkëpunëtorit tonë me banim në Itali, Dr. Selman Mëziu, i cili është një specialist i njohur në këtë fushë si dhe një aktivist në mbrojtje të mjediseve të gjelbërta, të cilin po e botojmë këtë numër.

Shpresojmë që blireve t'u jetë zgjatur jeta dhe me këtë rast, ndoshta është koha që Këshilli Bashkiak i Dibrës ta rishohë propozimin e bashkëpunëtorit tjetër të gazetës, Abdurahim Ashiku, i cili ka propozuar dy vite më parë që bliret të shpallen Monument Natyre http://www.rrugaearberit.com/arkiva/2014/shkurt2014.pdf.

Redaksia

Nga Dr. **SELMAN MEZIU**

Ndërhyrja është veprim i njeriut në një moment të caktuar, qëllimi i të cilit është të sjellë medoemos rezultatin e shumëpritur. Kjo varet nga faktorë të jashtëm, qoftë shoqërorë, organizativë, biologjikë, klimatikë e rrethana të tjera. Prandaj kërkohet që të shkolluarit, profesionistët, të hedhin në diskutim idenë mbi këtë ndërhyrje, më pas vjen projekti me të gjitha detajet dhe realizimi praktik dhe në këtë mënyrë i hapet udha e sigurt suksesit të ndërhyrjes.

NA ISHTE NJËHERË!

Tanimë në majethepat e shekullit të njëzetë e njëtë, edhe dibranëve dhe vetë qytetit të Peshkopisë nuk iu mungon historia, kujtimet, fotografitë, pikturat të cilat na japin momentet e gjallërisë, ndryshimet ekonomiko-shoqërore, arkitekturale e natyrore të tij. Prandaj ato kërkohet që në momente të caktuara t'i vëmë në shërbim të njerëzve, të vetë banorëve të qytetit, për ta njohur në çdo qelizë të tij dhe në çdo kohë. Prandaj: *"Ky bulevard ka qenë ferra, porene, meje, grun, bar, jonxhë dhe livadhe me kullosë. Me sa mbajë mend në fillim të bulevardit, në anën e epër ka qenë Bashkia, Prefektura, Burgu dhe shtëpitë e Kumbarçes. Në krahun poshtë ku sot është Këshilli i rrethit, Bashkia dhe Prefektura, ka qenë Hani i Trepçes",-* shkruan në librin e tij "Magjia e Dibrës" zoti Skënder Cala. Dhe më pas, duke kujtuar bisedën e babait të tij, ai vazhdon:*"Fillimisht u hap si një rrugë këmbësorësh, ku kalonin njerëz hallexhinj, korrierë për të çuar një lajm për lindje a vdekje diku, azrlinj me një bisht lope për dore... Kur bulevardi u asfaltua, dikush e plotësoi atë me pemë (drurë S.M) bliri, të cilat u bënë për atë tempuj të gjallë si kurora e artë për princërit, mbretërit e perandorët".*

Por kush ishin këta krijues të kësaj bukurie të rrallë me aromë tërheqëse të luleve mjaltëmbajtëse dhe kurorë jeshilueme e me gjethet shumëngjyrëshe në vjeshtë, dhe ja lexojmë:

"Vepra e parë (e Rexhep Dodës - S.M.) ishte Bulevardi "Gjokë Doçi", lulishtja me të njëjtin emër dhe bustin e tij në mes. Kudo qyteti ishte sistemuar me blina e asfalt bashkë me agronomin e talentuar Xhavit Hysa e Agush Selishtën si lulishtar. Blinat i ka marrë nga Korça e M.Grabockës" (S.Ajazi: "*Rexhep Doda shembulli i punës dhe dashurisë*" Rruga e Arb. f. 23, dhjetor 2013) Vendosja e tyre vërtitet në një hark kohor 1952-1960. Dhe ato deri më 19 shkurtin e vitit 2016 mbetën tempuj të gjelbërt, hijelëshues në pranverë e verë. Ndërsa në vjeshtë gjethet ngjyrë verdhërueme binin njëra pas tjetrës duke i dhuruar emrin natyral bulevardi i blirëve, ku me bukurinë e tyre ndillnin kënaqësinë, sillnin çlodhje kur qytetarët shëtisni në orët e ndryshme të ditës apo deri natën vonë.

DOMOSDOSHMËRI BIOLOGJIKE

Rrënjët e tre lloje blirësh, pra, fletegjeri (Tilia platyphyllos, Scop.), fletengushti (T. cordata, Mill.), flete mprehti (T. tomentosa, Moench.), i futën thellë në tokën e kuqëluar të pasura me kripëra minerale e lëndë ushqyese. Këto, si fabrika të gjelbërta të pavarura, pothuajse për rreth gjashtëdhjetë vjet fabrikuan gjethe, bisqe, dru, degë, lule, fara dhe u rritën në tre përmasa, lartësi, trashësi, volum. Kurse kurora u zmadhua në këto përmasa, në formën gjeometrike trung koni. Degëza të thara në brendësi të kurorës filluan të thaheshin, rritja tredimensionale dhe e gjymtyrëve filluan të ngadalësoheshin. Degët e stërsgjatura filluan të vareshin e të bezdisnin kalimtarët. Këtyre qenieve të gjalla, biologjike iu duhesh dhënë një shtytje përpara për rigjenerim gjymtyrësh. Prandaj u veprua "*Krasitja e drurëve zbukurues shërben në substancë për të formuar një strukturë të re formale, për të nxitur rritjen e drurit si dhe për të eliminuar pjesët që shkaktojnë aksidente dhe pjesët e trupit ose të kurorës të sëmura, degët e thara ose gjysmë të thara dhe së fundi për të garantuar sigurinë e shëtitësve dhe shëndetin e këtyre qenieve biologjike për një periudhë kohe sa më të gjatë që të jetë e mundur.",* (M. Parisini e E. Antonini, Articolo nela rivista, ''Giardini,, Febbraio 2001)

Në këtë këndvështrim është parë ndërhyrja me krasitje e blirëve të bulevardit kryesor të qytetit të Peshkopisë. Kuptohet, që janë marrë parasysh mjaft rrethana dhe faktorë që nga investimet e deri tek dobiprurja e këtij veprimi biologjik mbi çdo blir, në veçanti dhe si një strukturë e gjelbërt e të dy anëve të bulevardit.

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Zbatuesi i punimeve duhet të jetë njohur me projektin e kryerjes së punimeve. Në bazë të tij ai duhet të sigurojë mjetet e transportit, makinën grirëse te materialit vegjetativ që do të dalë nga krasitja, makinën vinç për realizimin e prerjeve, ose shkallë të gjata, 3 - 4 metra. Motosharrë jo më të rëndë se 3,5 kg me karburantin dhe mjetet ndihmëse, gërshërë të madhësive të ndryshme, sharrë lulishtari. Të gjitha këtyre t'u rishikohet gjendja e tyre, të mprihen. Të sigurohet rripi i sigurimit, helmeta prej kauçuku, kufjet.

Kutia sanitare duhet të shoqërojë grupin e zbatimit të prerjeve. Duhet të sigurohen tabelat e ndalim qarkullimit, si dhe të jetë siguruar leja e kryerjes se punimeve me orët e fillimit, pushimit, mbarimit dhe kohëzgjatja totale nga policia rrugore e qytetit, apo zonës ku do të kryhen punimet.

Njëkohësisht me prerjen, materiali grihet ne makinerinë e posaçme, ku tallashi hidhet direkt në makinë ose ngarkohet siç priten nga drurët zbukurues materiali i nxjerrë.

Kryhet një vëzhgim paraprak, për të krijuar një ide paraprake që të krasitin të gjithë drurët njëlloj, duke ruajtur pamjen e bukur, simetrinë e kurorave dhe arkitekturën peisazhiste në përputhje me secilin dru dhe objekteve të ndryshme përreth tij, duke kryer gjithashtu edhe funksionin që kanë këto për rrugën, bulevardin apo pozicionin në lulishte.

TEKNIKA E ZBATIMIT

Si rregull i përgjithshëm, është që kjo ndërhyrje të kryhet në periudhën e pushimit të vegjetacionit, pra, kur limfa ka pushuar së qarkulluari. Kjo është e vlefshme si për drurët gjetherënës, ashtu për ato përherë të gjelbërt. Zakonisht gjatë muajve nëntor - shkurt. Para fillimit të punimeve duhet të mos bjerë borë, shi i rrëmbyeshëm ose të vijnë ngrica mbi -5 °C, në raste të tilla punimet shtyhen për një afat të pacaktuar. Kjo edhe sepse: ''*Uji në fakt, mund te depërtoi në brendësi të drurit e lëvores në vendprerje, dhe me uljen e temperaturave, ngrin dhe çan degën apo pjesën qendrore të trungut.*,,(F.M.Fziu "'Calend. Giard.,, f.44, Milano 2001). Kryerja e tyre dëmton drurët biologjikisht dhe bëhet shkak aksidentesh gjatë kryerjes së punimeve të krasitjes etj.

Prerjet me motosharë ose sharrë dore kryhen në fillim poshtë degëve e pastaj nga sipër në të njëjtin drejtim vazhdohet duke kryer prerjen e plotë. Kjo për arsye që të mos krijohet çarja e degëve nga prerja, sepse i shkakton një plagë tjetër degëve e gjithë drurit. Me të gjitha mjetet krasitëse prerja kryhet e plotë, pa shkallëzime ose dhëmbëzime. Gjithashtu, kryhet gjithmonë e pjerrët apo perpendikulare në degët anësore, që të mos "flenë" ujërat e shirave, borës etj.

Krasitësi duhet të ketë një përvojë pune në krasitje, por edhe përgatitje teknikoshkencore. Dhe ja si veprohet nga ai në këtë ndërhyrje kirurgjikale biologjike:

"Është rregull.... që degët kryqëzohen natyralisht njëra me tjetrën, rriten me gjatësi të ndryshme, prandaj lind nevoja e prerjeve të tyre, por vetëm në periudhën e pushimit vegjetativ (nuk zhvillohen proceset fiziologjike - S.M.) kështu, rikrijojmë një strukturë të ekuilibruar për drurin zbukurues.,,(Giardinagio senzaprob. F.47 Torino 1993).

Përzgjedhja e degëve që priten kryhet nga lulishtari, duke hequr degët e trasha, më pas me gërshërë të lulishtarit degët e tjera, duke zbatuar parimin 2/3 e gjatësisë së degëve. Hiqen më pas të thatat, të sëmurat, gjysëm të thyerat. Shkurtohen, priten aty ku del një degë, pothuajse puthitur me atë. Duhet të krijojmë një dendësi degëzimesh të barabarta, për të mos ulur vlerat estetike, dhe ruajtur ekuilibrin bio-fziologjik.

Ja parimet që duhet të ndjekë krasitësi i drurëve zbukurues:

1-Vëzhgim i kujdesshëm para fillimit të krasitjes së çdo druri vendin ku do të priten degët kryesore etj., si dhe për të siguruar operatorët nga çdo aksident.

2-Rregullimi i formës së kurorës duke ruajtur formën natyrale dhe pamjen kënaqësi ndjellëse.

3- Krasitësi duhet të ketë një përvojë pune në krasitje, por edhe përgatitje teknikoshkencore. Dhe ja si veprohet nga ai në këtë ndërhyrje kirurgjikale biologjike:

4. Prerja e degëve që pengojnë zhvillimin e degëve kryesore.

5- "'*Krasitja e një druri zbukurues ka për detyrë rregullimin e mbajtjen e një forme të rregullt natyrale*". (Encicl. Prat.del giard. F.205 Novara 1995)

Udhëzime të cilat duhet të zbatohen në operacionet e krasitjes së drurëve zbukurues, përgjatë rrugëve, bulevardeve, parqeve të gjelbërta dhe lulishteve të pozicionuara në arkitekturën ndërtimore të një qyteti, fshati, shkollash, fshatrash etj.

GABIMET E BËRA

Pa hyrë në linja të hollësishme, mund të shprehemi se nga pamja e krasitjes se drurëve të bulevardit kryesor të qytetit të Peshkopisë janë kryer këto gabime:

(Vijon në faqen 17)

cyan magenta yellow black

Intervistë me z. Gazmend Kërkuti, rreth projektit për sponsorizimin e KF Korabi-U17 nga Dibra e Madhe



25 mijë dollarë për ekipin e fëmijëve

"Jemi pesë dibranë që nuk na lidh as fisi, as shoqëria, as partia, por dashuria për vendlindjen".

Si fillim dua të sqaroj lexuesit se ky projekt është i përbashkët, pra, çdonjëri nga ne të pestë ka kontribuar financiarisht. Ndërsa unë jam i autorizuar që të flas në emër të këtij grupi që ne e quajmë DEA (Dibranet E Amerikës).

Një Dibër tjetër është në SHBA dhe shumica e tyre janë të vendosur në New York. Shpesh është bërë e ditur se ky komunitet ka kontribuar vazhdimisht për vendlindjen, jo vetëm me donacione për objekte të ndryshme kulturore dhe sociale, por edhe për mbështetjen që u kanë dhënë vëllezërve të tyre në Dibër për të mbijetuar. Mbi 5000 dibranë kthehen çdo vit në Dibër për pushime dhe gjatë verës qyteti gjallërohet, për të fjetur më pas në pritje të verës tjetër.

Megjithatë, ka prej tyre që jetojnë çdo ditë me Dibrën. Dhe këtë radhë, pesë prej tyre: Agron Krifca, Burim Fudulli, Gazmend Kërkuti, Mumin Kosovrasti, Zeqo Papraniku, të cilët, pavarësisht se nuk i lidh asnjë lidhje gjaku me njëri-tjetrin, as fisi, as shoqëria, as partia, i ka bashkuar dëshira për të ndihmuar fëmijët në Dibër, në mënyrë që ata t'i largohen rrugës dhe klubeve dhe të merren me sport.

Të pestë kanë vendosur të dhurojnë 25 mijë dollarë për ekipin e të rinjve të Dibrës. Dhe nuk kanë i kanë hequr këto mënjanë në një ditë, por kanë vendosur që këtë ta bëjnë gjatë pesë viteve rresht, duke garantuar një stërvitje të vazhdueshme të fëmijëve.

Ajo që të bën përshtypje në këtë bashkëpunim është transparenca. Është një fjalë që dëgjohet shpesh në vitet e fundit, por askush nuk e realizon.

Ndërsa pesë djemtë nga Dibra e kanë bërë këtë në një faqe ne web, duke publikuar çdo donacion, çdo blerje për ekipin e fëmijëve, nga topat e deri të bluzat e çanta e ndihmës së shpejtë. Çdo faturë dhe çdo shpenzim, duke garantuar me këtë se investimi do të jetë afatgjatë dhe sigurisht, edhe rezultatet do të vijnë.

Ideja lindi nga zemrat e plasura të disa dibranëve që duan të bëjnë ndryshimin. Ishte Habib Klobocishta ai që mori këtë guxim dhe na e parashtroi planin që të financojmë këtë projekt... Kështu bashkë me të vendosëm që të merrnim kohën e duhur për të gjetur njerëzit që bashkërisht mund të mbulonim koston financiare.

Në lidhje me këtë projekt, ne biseduam me z. Gazmend Kërkuti, njërin nga të pestë sponsorët e ekipit të U17 në Dibër.

Çfarë është projekti në ndihmë të sportit?

Si fillim dua të sqaroj lexuesit se ky projekt është i përbashkët, pra, çdonjëri nga ne të pestë ka kontribuar financiarisht. Ndërsa unë jam i autorizuar që të flas në emër të këtij grupi që ne e quajmë DEA (Dibranet E Amerikës).

Si lindi kjo ide?

Ideja lindi nga zemrat e plasura të disa dibranëve që duan të bëjnë ndryshimin. Ishte Habib Klobocishta ai që mori këtë guxim dhe na e parashtroi planin që të financojmë këtë projekt. Mua më pëlqeu si ide, por ishte një shifër e madhe për ta mbuluar i vetëm. Kështu që vendosëm me Habibin që të merrnim kohën e duhur për të gjetur njerëzit që bashkërisht mund të mbulonim koston financiare.

Kur u ktheva ne New York, të parin kontaktova dibranin Mumin Kosovrasti, i cili më dha fjalën që do të jetë pjesë e këtij projekti. Pastaj kontaktova Burim Fudullin, i cili më tha që është një ëndërr personale që edhe ai t'ia kthejë Korabit respektin, pasi Burimi është rritur në atë fushë dhe ndjehet i emocionuar sa herë që e kujton Korabin. Vazhdova me Zeqo Papranikun, i cili menjëherë më tha shkurt: "PO". Ndërsa Agron Krifca jeton 4 orë larg New Yorkut dhe duhej të shkonim patjetër personalisht ta takojmë. Shkuam bashkë me Mumin dhe Burimin deri në *Connecticut* dhe kaluam një mbrëmje të bukur tek restoranti i Agronit... Mësova shumë histori nga ai, na frymëzoi dhe po ashtu edhe ai ra dakord të jetë pjesë e grupit për financimin e fëmijëve. Filluam realizimin e projektit hap pas hapi, të cilin edhe ju mund ta shikoni ne webfaqen www.korabi-u17.com.

Edhe në të kaluarën janë bërë përpjekje për donacione për vendlindjen, por shumë prej tyre kanë dështuar. Si mendoni ju se kjo iniciativë do të ketë sukses...

Po, fatkeqësisht kjo është e vërtetë. Por, duhet të theksoj se nëse në Pallatin e Kulturës nuk ka aktivitete kulturore artistike... ne kemi dështuar! Nëse në oborret e shkollave nuk ka fëmijë... ne kemi dështuar!

Nëse tek klubi i kajakëve, basketbollit dhe karatesë nuk ka fëmijë... ne kemi dështuar!

Nëse klubi futbollistik nuk ka fëmijë... ne kemi dështuar!

Pas gjithë këtij konstatimi, vjen pyetja se kush e ka fajin? Përgjigja sot nuk është jetime, por është "UNË". Unë e kam fajin, bashkë me shokët e mi që rrimë nëpër kafe dhe ia lëmë fajin komunës, partisë, shtetit, sllavit, turkut e kështu me radhë.

Sot, bashkë me Agronin, Burimin, Mumin dhe Zeqon morëm fajin përsipër dhe vendosem të sakrifikojmë pak para, që t'ju mundësojmë fëmijëve fushën, topin dhe një trajner mbikëqyrës, sa për t'i larguar fëmijët nga kafenetë dhe bastet e qytetit.

A janë të informuar për këtë projekt komuna dhe KF Korabi?

Natyrisht! Ne nuk jemi këtu të përçajmë apo t'u tregojmë të tjerëve se jemi më të mençur se ata. Korabi ka ekzistuar 95 vjet dhe në të është sakrifikuar shumë edhe nga njerëz të tjerë. Ne vetëm duam ta bëjmë atë pjesën tonë të kohës që Korabi të vazhdojë të mbetet i madh. (Agron Krivca dhe Zeqo Papraniku kanë kontribuar shumë nëpër vite...)

Kështu që njeriun e parë që pyeta ishte kryetari i Komunës z Ruzhdi Lata, i cili tha se me kënaqësinë më të madhe do të nënshkruajë dokumentin për autorizimin e të gjithë fushave apo sallave sportive që komuna posedon në qytetin e Dibrës së Madhe që këta fëmijë të kenë mundësinë të stërviten në çdo sezon. Dhe ashtu ndodhi, personalisht ai na ka autorizuar me dokument lejen e çdo ambienti sportiv në Dibër.

Ndërkohë, z. Urim Lleshi, sa kishte dëgjuar se kush janë sponsorët e grupit DEA, as që e kish lexuar kontratën e grupit tonë, automatikisht e kishte nënshkruar dhe deri tani afër 8 muaj vetëm se na ka ndihmuar, duke na ndenjur pranë për çdo ndihmë që na duhet.

Kur thua 8 muaj? Kjo ide paska kohë?

Po, ka afër 1 vit që punojmë për të formuluar kontratat, blerjen e pajisjeve, format dhe rendet për punë. Ne punojmë me dokumnete. Çdo gjë është me dokument, çdo transfertë, çdo gjë është e vërtetuar. "Besnik të jesh vet, por besë mos i ve askujt" - thotë populli.

Kështu që ne për të mos krijuar ngatërresa, kemi një transparencë dhe deri tani ky ka qenë një ndër projektet më të mbarshme që unë personalisht jam angazhuar. Jemi tepër krenarë, vetëm ta shikosh fotografinë ku fëmijët stërviten, të kënaqet shpirti, sepse vetë kemi qenë fëmijë dhe një top i vogël si dhuratë na bënte fëminë më të lumtur në botë!

Cilat janë objektivat e këtij projekti?

Nuk kemi objektiva. Nuk kërkohet vendi i pare apo i trete në ligë. Nuk ka rëndësi për ne... Me rëndësi është që fëmijët të largohen nga kafenetë, bastoret dhe t'ju mundësohet fusha e gjelbërt, ku do të kenë pajisjet për stërvitje dhe një trajner që t'i shoqërojë. Kaq kërkoj nga lexuesit të mbajnë mend!

Duke e mbyllur, dua të theksoj edhe njëherë rolin e rëndësishëm në këtë projekt të Habib Klobocishtës, i cili ka treguar transparencën e çdo shpenzimi. E bukura e këtij projekti është që këta fëmijë as nuk na njohin dhe as i njohim. Thjesht një obligim moral, human, që ia kemi borxh Dibrës.

Me këtë rast ju përcjell edhe falenderimet e Agronit, Burimit, Mumin dhe Zeqos për mundësinë që na jepni ta bëni të njohur këtë rast për lexuesit tuaj. Nëse Dibra ecën përpara, bashke me të ecim edhe Ne. Bashkë bëjmë fuqinë!

Bisedoi: BUJAR KAROSHI

Ne nuk jemi këtu të përçajmë apo t'u tregojmë të tjerëve se jemi më të mençur se ata. "Korabi" ka ekzistuar 95 vjet dhe në të është sakrifikuar shumë edhe nga njerëz të tjerë. Ne vetëm duam ta bëjmë atë pjesën tonë të kohës që "Korabi" të vazhdojë të mbetet i madh.

Shukri Xheleka ishte model i mësuesit. Brezi i ri i mësuesve të edukimit fizik mund të mësojnë shumë nga ekserienca e tij, për të ruajtur e çuar më tej rezultatet në edukimin sportive të rinisë shkollore e asaj komunitare.

Qendra e Komunitetit Dibran në Nju Xhersi, hapi shkollën e saj shqipe

Nga **BEQIR SINA**- *New York*

Qendra e Komunitetit Dibran në lokalitetin Freehold, të New Jersey, e inaguruar një vitë më parë- e ka nisur punën e saj me ne aspektin fetar dhe kombëtar me një lajm ogurmirë.

Në statusin e saj në rrjetin social Facebook, ajo lajmëronë se dje ka hapur për herë të parë në historinë e këtij lokaliteti në Nju Xhersi, një shkollë me mësim plotësues, për mësimin e gjuhës shqip, si disa të tjera në komunitet

Siç duket edhe nga fotot e postuara prej tyre - gëzimi dhe entusiasmi i prindërve dhe fëmijëve ka qenë i madh - Shkolla ka nisur mjaft mbarë sesionin e ri- me rreth 30 nxënës më mësues të kualifikuar, dhe pa pagës.

Rrjeti i picerive Pronto Pizza, u ka ofruar fëmijëve, pas orëve të mësimit pica dhe





Shkolla plotësuese për gjuhën Shqipe, në lokalitetin FreeHold në Nju Xhersi, ku jetojnë qindra familje shqiptare, është një iniciativë shumë e duhur dhe në kohën e duhur! Me shpresë që brezat e ardhshëm në SHBA të kultivojnë dhe ruajnë, gjuhën e bukur Shqipe, fenë, kulturën dhe zakonet e traditat e tyre!

pije freskuese falas, duke ndjekur praktikat e sistemit të shkollave amerikane. Ndërsa klasat janë të kësaj qendre Dibra Community Center, janë të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme mësimore, të dhurura ato nga komuniteti Dibran në këtë zonë, e cila është nga më të bukurat dhe më të shtrejntat në këtë lokalitet.

Kryetari i shoqatës Dibra, Dashnor Miftari, duke njoftuar në profilin e tij në facebook, për hapjen e kësaj shkolle, shkruan se dje, më 28-shkurt-2016 në Dibra Community Center, u hap shkolla për edukimin e fëmijve tonë, në këtë rrethinë, mësimin e gjuhës shqipe. Ai sqaron se kjo shkoll, gjithashtu, do të ketë brenda programit të saj edhe njohuri edhe për fen e tyre. Shkolla filloi me 30 nxënës, shkruan Miftari.

Kurse duke shprehur edhe gëzimin e prindërve dhe fëmijëve të këtij komuniteti ai tregonë se ishte kënaqsi për ne si prindër të jemi aty bashk me fëmijt tanë, në këtë ditë historike për komunitetin tonë, në Freehold - New Jesey.

Në urimet e tyre, dibranët anekënd, shkruajnë në Facebook, se dibranët çdo herë përkrah kombit e fesë së tyre.

Dibranët, kanë mësuar dhe gjuhën e ëmbël dhe të bukur Shqipe, siç ishin Said Najdeni(Hoxhe Voka),Isen Kuçi (baba Sheh) etj.

Disa prej tyre e kan quajtur hapjen e shkollës plotësuese për gjuhën Shqipe, një iniciativë shumë e duhur dhe në kohën e duhur! Me shpresë që brezat e ardhshëm në SHBA të kultivojnë dhe ruajnë, gjuhën e bukur Shqipe, fenë, kulturën dhe zakonet e traditat e tyre!

Mësuesi i pasionuar pas sportit, Shukri Xheleka

Nga **ZABIT LLESHI**

Dita e Mësuesit, 7 Marsi na sjell në kujtesë mësuesit që nga klasa e parë e deri në mbarim të shkollës. Shumë prej tyre i kemi për zemër e në këto ditë rifreskojmë kujtimet, mbresat, veprimtaritë kulturore e sportive. Mësuesi është një figurë e dashur dhe e respektuar.

Të shumtë janë mësuesit anekënd Atdheut, që i realizojnë më së miri detyrat. Midis tyre, në rrethin e Bulqizës(sot Bashki), është shquar edhe Shukri Xheleka nga Okshtatina, i cili ka lënë një trashëgimi për t'u admiruar. E nisi në shkollën pedagogjike Peshkopi edukimin e tij, për mjeshtërinë e mësimdhënies. Që këtu u angazhua me sportin, duke përfaqësuar klasën e shkollën në disa veprimtari lokale e kombëtare, si në atletikë, futboll, volejboll etj.Pasionin për sportin e fitoi falë kujdesit të mësuesit fizik të shkollës 8-vheçare Shupenzë, Lutfi Manjani, një ndër sportistët më të mirë të të Sportklub Korabit në futboll, volejboll, por edhe si trainer i moshave të rinisë në qytetin e Peshkopisë. Suksesin e parë të lartë e arriti në vitin e katërt , ku në kampionatin kombëtar të Mundjes, me trajner Hamit Elezin, zuri vendin e parë në peshën e tij.

Punën e mësuesit e filloi në Topojan (1962). Si veprimtar sporti ai ishte pjesëtar aktiv i skuadrave të fshatrave në lokalitetin e Shupenzës, duke ndihmuar e mbledhur element sportivë nga Zogjet Kovashica, Gjorica, Viçishti etj. Vullnetarisht mblidheshin djem të rinj nga të gjitha fshatrat, pa marrë parasysh vështirësitë e rrugës e largësitë



Shukri Xheleka

mes fshatrave të kësaj zone. Në qendër të organizimit të lojërave sportive ishte mësuesi Shukri Xheleka. Së bashku me kolegë të shkollave tjera, organizoi 'kampionate' mes fshatrave në atletikë, volejboll, futboll etj.

Më 1972 Shukriu u transferua mësues i edukimit fizik në shkollën e Bashkuar Shupenzë. Përkushtrimi i tij në punë shpejt do të jepte rezultatet e dëshiruara. Jeta sportive e shkollës dhe e rinisë shumë shpejt u gjallërua, duke u bërë një mësues i dashur për opinionin publik, veçanërisht për atë sportdashës. Ne këmbënguljen e tij u ndërtuan terrene sportive, u pasuraua baza materiale etj dhe sportin arriti ta bëjë problem të shkollës, të pushtetit lokal e të ekonomisë bujqësore të atyre viteve. Më 1973 ekipi i lojërave popullore të Shupenzës, i përbërë kryesisht me të rinj të shkollës Mesme Shupenzë, zuri vendin e parë dhe siguroi të drejtën për të përfaqësuar rrethin e Dibrës në Lezhë, në konkurimin e rretheve të Veriut. Përfaqësimi në Lezhë vinte si rezultat i një pune serioze nga Shukriu. Në Lezhë shpërblehet me Flamurin e Festivalit të Lojërave Popullore të rretheve të Veriut. Nga ky festival, rrethi i Dibrës shkoi në Festivalin Kombëtar në Krujë. Edhe këtu Dibra mori Kupën e Festivalit, ndërsa Shukri Xheleka u vlerësua si lojëtari më i mirë i Festivalit.

Në vitin 1975 u transferua në Zogje, që për mësuesin kjo ishte një sakrificë , larg shtëpisë, në një shkollë të vogël, por me emër. Kishte një kolektiv të mirë e fshati ishte arsimdashës. Thonë se "kandilin kudo ta vesh, bën dritë". Ashtu edhe Shukriu aty i dha gjallëri jetës sportive. Një shkollë me pak nxënës do të sfidonte shkollat e mëdha, si Shpenzën, Maqellarën e Bulqizën në disa lloje sporti. Më 1979 shkolla Zogje fitoi vendin e parë në festivalin e lojërave popullore në Peshkopi., midis shkollave 8-vjeçare të rrethit të Dibrës. Vështëristë gjatë punës me ekipet e shkollës nuk e shkëputën mësuesin e apasionuar për sportin. Ai vazhdoi dhe përfundoi shkollën e Mjeshtërisë në Durrës, me rezultate të shkëlqyera. Dikujt nga administrate e atëhershme e arsimit në rreth nuk i shkonin për shtat rezultatet e Shukri Xhelekës. Në vitin 1983 e transferojnë në Topojan, ku edhe aty do shkëlqente me punën e tij. Shkolla malore e Topojanit në ato vite do përmendej për rezultate në fushën e edukimit fizik në raportet e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Dibër.

Më 1986 Shukriun e transferojnë përsëri në Shupenzë, duke mbyllur qarkun e lëvizjeve nëpër fshatrat e Komunës së sotme të Bulqizës e bashkë me të, edhe punën e mësuesisë. Gjatë punës në këtë shkollë, Shukriun nuk e pengoi mosha, përkundrazi shkolla e Shupenzës u kthye në një shkollë model të edukimit fizik dhe zgjerimit të të veprimtarive sportive. Kjo shkollë në këto vite furnizoi për një kohë të gjatë ekipe të rrethit në spartakida e veprimtari të tjera sportive. Në basketboll, në vitin 1991 ekipi zuri vendin e dytë pas atij të Lezhës, gjë që përbëntë një hap cilësor në zhvillimin e lojërave me dorë në Grykën e Vogël.

Shukri Xheleka nuk ishte i vetëm në punën me sportet. Atë e përkrahën shumë mësues të përkushtuar si Medi Dema, Hamdi Dumani në Zogje, Bajram Hoxha, Zabit Kaci, Maliq Dumani në Shupenzë, Fadil Cami e Fehmi Lika në Gjoricë eViçisht, bashkë me shumë sportdashës të aposionuar, si Xhevdet Daci(gazetar), Hamit Sinani, Tafë Murra, Hamit Daci etj. Mbi të gjithë, e mbështeti mbarë rinia sportdashëse e këtyre anëve.

Shukri Xheleka ishte model i mësuesit. Brezi i ri i mësuesve të edukimit fizik mund të mësojnë shumë nga ekserienca e tij, për të ruajtur e çuar më tej rezultatet në edukimin sportive të rinisë shkollore e asaj komunitare. Nga viti 2000, Shukriu është pensionist. I urojmë gëzuar 7 Marsin! Jetë të gjatë e shëndet të plotë!

portret

Letra e një nxënësi për mësuesen:
Mësueses time të parë, Hamide Lena, në 60 vjetorin e lindjes

Mbetem gjithmonë mirënjohës për ato që keni bërë për mua!

Nga **RENATO TOTRAKU**

Tek meditoj, mendja më çon larg, më çon në ditën e parë të shkollës fillore, e një nga një kalimin e ditëve, javëve, muajve dhe të viteve, deri sa mbarova klasën e katërt.

Po ndalem vetëm në vitet e ciklit të ulët sepse ato më duken më mbresëlënës. Sot jam kuadër dhe gradualisht po eci në dijet e botës reale, me plot shpresë për të ardhmen, madje me besimin e madh në vetvehte. Në shkollën "Drita" Burrel, sot "Mustafa Gjestila"" ekziston ende një regjistër shkollor brenda të cilit ndodhet edhe emri im. Ai emër u shkrua në ditën e parë të shkollës, në vitin arsimor 1994-95. Mësuese Hamidja me zërin e saj të ëmbël, me dorën ledhatuese mbi kokën time, dhe jo vetëm, më emocionoi shumë. Ishte ditë e shënuar. Si një purtekë dridhesha i tëri. Por mësuesja ime e parë më çliroi e më nxorri nga situata. Pasi me futi kokën nën sqetull, si dallëndyshja të voglin e saj, e për çdo ditë më buzëqeshte e më ledhatonte, unë po rritesha jo vetëm në shtat, por dhe me dije. Gjithmonë na rrinte te koka, e dalë ngadalë i mësuam të gjithë shkronjat nga A-ja tek ZH-ja me shkrim dhe këndim. Kur gaboja ndonjëherë sytë e mësueses, - nënës time të dytë, - zëri i saj i ëmbël e i butë, n'a bënte për vete dhe n'a ftonte për durim e këmbëngulje, sepse dikur do bëheshim dikushi, njeri i vlefshëm për vete, për familjen dhe shoqërinë.

Kanë kaluar shumë vite nga ajo kohë, por malli për mësuesen time veç më shtohet. Është mësuesja ime e parë, dhe e para nuk harrohet kurrë, kujtohet dhe respektohet më shumë se sa ajo e fundit. Kujtimi i saj mbetet si një trëndafil i bukur me erë, plot aromë nga kopshti i madh i dijes, që me punën e saj në vite ka zënë vend thellë tek unë, si një dhuratë e çmuar dhe e pa zëvëndësueshme.

7-8 marsi vjen çdo vit, por këtë vit për mësuesen time është ndryshe, sepse më 1 mars mbush 60 vjet. Edhe pse larg në Itali nga thellësia e zemrës time i uroj këto festa dhe shëndet e mbarësi në familjen e saj. Përshëndes me këtë rast dhe të gjithë shokët e shoqet e klasës time të fillores që të kenë suksese, shëndet dhe mbarësi në jetën e tyre.



Hamide Lena



Rreshti i parë nga e majta në të djathtë: Rolansd Sela, Renato Totraku, Aurel Keçi , Besmir Gurabardhi, Ervin Lleshi, Taulant Liçi, Marsida Hysa. Rreshti i dytë: nga e majta: Denis Çupi, Albana Doçi, Klodian Shehu, Flori Dervishi, Taulant Lena, Flobian Farruku, Drilon Pasha, Dorian Sula, Julian Lleshi, Anisa v.Keçi. Në rrështin e tretë, afër mësueses: Olta Leka, Elona Zhgjuni, Dorina Lami, Jonida Kolaveri, Anisa I. Keçi, Majla Lazimi. Rreshti i katërt: Aurora Koçi, Algisa Mulellari, Dorina Cenalla, Anisa Lila dhe Resjana Varfi. Në këtë foto mungojnë edhe disa shokë e shoqe të tjerë si Anjeza Hysa, Ervisa Çollaku, Rigels Dika.

Fola vetëm për disa aspekte të figurës të Hamide Lenës, por dikush do të dijë se kush ishte kjo zonjë e madhe?

Të dhënat e arkivit të saj sqarojnë: Është lindur me 1 mars 1956 në lagjen Qafa e Qarrit në fshatin Gjon të krahinës së Martaneshit. U lind në familjen e Likë Kuinxhiut, familje atdhetare e luftarake me ndjenja të forta mikpritëse e bujare. E lidhur fort me Lëvizjen dhe me LANÇ. Të dy xhaxhallarët e saj, Arifi dhe Kalemi kanë qenë partizanë efektiv i brigadës së XVIII Sulmuese partizane.

Hamidja, fëmija i tretë pas vëllezërve, Bashkimi e Petriti dhe pas saj motra Nadire, ndoshta qe më e privilegjuar, sepse u arsimua pikërisht në profesionin që ajo e deshi shumë. Qyteti i Fierit do te ishte vendi ku do të diplomohej si mësuese në vitin 1976. Si mësuese do shkelte në disa shkolla, në Krastë e Burrel, dhe jo vetëm si mësuese. Sepse ka kryer disa detyra shoqërore, kryetare e organizatës së gruas, anëtare e këshillit popullor si dhe misionare në shkallë vendi në Ksamil. Gjithnji në krye të punëve, gjithnji e dalluar në punë. Për këto arritje mban medaljen "Naim Frashëri", "Për kontribut të çmuar në fushën e arsimit dhe të edukimit të brezit të ri".

Një e veçantë: Ka punuar së bashku me disa kolegë e kolege si Mynyre Skënderi, Adile Baleta, Drita Stafsani, Shahe Vaçi, Lirie Zhgjoti, Feride Huta, Lule Ahmeti, Merjeme Leka, Lume Hoxha, Haxhi Keçi, Erzen Muça, Natasha Ballabani, Drita Mira, Nadire Pasha, Flora Këputa, Sofie Hysa, Arben Kola e te tjerë. Të gjithë yje, por unë mbi to kam mësuese Hamiden.

E nderuara dhe e pa harruara mësuese Hamide!

Familja juaj me bashkëshortin Qemal Lena, inxhinier me titull Doktor i Shkencave në Gjeologji, me fëmijët tuaj: Albani, Valmira dhe Agimi, përbëjnë një thesar të pa zëvendësueshëm për Ju. Në këtë moment ju uroj jetë të gjatë dhe shëndet të plotë, mbarësi të gjithëanshme.

Ju kujtoj të gjithë pjestarëve të familjes së mësuese Hamides fjalët kur u larguat në Itali: "Unë po largohem por nuk do t'ju harroj kurrë sa të jem gjall, do mbeteni në mendjen dhe zemrën time". Me dashurinë e saj si edukatore e shpesh herë dhe si nënë e vërëtetë n'a mbështillte me ngrohtësinë e saj. Si një kujtim i bukur më mbetet dërgimi i një kartoline që në klasën e VIII-të n'a uronte, "Suksese në provimet e lirimit dhe në gjimnaz".

Iu jam dhe iu mbetem gjithmonë mirënjohës për ato që keni bërë për mua dhe bashkëmoshatarët e mij.

Bashkë me juve përshëndesim dhe ato mësuese që ndonjeherë të zëvëndësonin ty, si Adile Baletën, Drita Stafasanin, Lume Hoxhën e tjerë.

Zurije Koka, *mësuesja e parë radomirase*

Nga **METUSH SKEJA**

Zurije Koka është një personalitet i arsimit në Radomirë. Ajo, gjithë jetën ia ka kushtuar arsimit. Ka punuar afro 40 vjet në këtë fushë, duke edukuar shumë breza. Them me bindje se fëmijët e Radomirës kanë qenë me fat që kanë pasur një mësuese të tillë.

Zurije Koka u lind në Radomirë nga dy prindër fisnik dhe me autoritet, të dashur dhe të kujdesshëm ndaj fëmijëve të tyre.

Zurije Koka ka personalitet të fortë e të ekuilibruar, gjykim të ftohtë e aspak emocional. Filozofija e jetës saj ka qenë optimiste, por edhe e pajisur me vullnet për ta përballuar detyra që i kishte caktuar vetës. Ajo ka mbaruar arsimin tetëvjeçar në Radomirë në vitin 1970, duke qenë më e dalluara e klasës saj dhe një ndër më të dalluarat e shkollës. Në këtë vit ka shkuar për të studiuar në shkollën e mesme pedagogjike "Shejnaze Uka " në Shkodër. Profili i shkollimit përkon me aftësitë e veçanta të saj, bashkëveprim kompleks, trashëgimi edukim. Shkolla e qytetit ku mësoi ka pasur traditë, janë emra të dëgjuar të arsimit shqiptar, duke ndikuar në rritjen e përsonalitetit saj. Aty mësoi shkencat që lidhen me edukimin, letërsinë klasike europiane e më gjërë, shkrimtarët e poetët e mëdhenj të Shkodrës.

Zurije Koka është e para mesuese përfesioniste nga Radomira. Në moshën 19-vjeçare ka filluar punën në vendlindje. Vetëm mosha e pensionit e largoi nga nxënësit që aq shumë i deshi, edukoi e mësoi. Ka punuar gjithë jetën me përkushtim e profesionalizëm. Çdo ditë ka qene një ditë e re, çdo ditë ka pasur për tu dhënë fëmijëve diçka plus. Energjtë e forca nuk i shteruan që nga dita e parë kur filloi punën deri në ditën e fundit. Përvoja shumëfishohej. Ka punuar përherë në klasën e parë deri në të katërt, që përkon me fazën e operacioneve konkrete të zhvillimit psikologjik të fëmijës. Këtë grup moshe e ka njohur me hollësi. Ka njohur programet e lëndëve, metodikat e mësimdhënies, teoritë psikologjike për këtë grup-moshë. Nxënësit e saj në klasat e larta dukeshin nga të tjerët si nga njohurit, organizimin e të menduarit, fjalorin e pasur, qëndrimet e sjelljen sociale. Ka qenë e qartë se një dorë e kujdesshme i kishte kultivuar. Diku kam lexuar një postulat se e ardhmja e fëmijës përcaktohet se kush është mësuesi i tij. Kjo do ti shkonte shumë mirë personazhit në fjalë.

Në vitin 1946 dy mësuese shembullore nga Shkodra punuan për tre vjet në Radomirë. Dhe pas afro tridhjetë vjetësh del mësuese Zurija. Kurikula e shkollës ka ndryshuar në rrjedhë të viteve. Zurija ka qenë e para mësuese ndër shoqe që eksperimentonte e zbatonte programet e reja. Kërkonte të përparuarën. Metodat e mësimdhënies i përshtaste me kurikulat e kohës. Lokalet e kushtet e shkollës nuk kanë qenë komode, por gjente mundësi që mësimi të bëhej sa më mirë, pa u ankuar. Nëse do të veçoj diçka në përfesionin e saj do të thoja se vinte në punë e shfrytëzonte potencialet e mëdha intelektuale që natyra u ka dhënë fëmijëve. Ka pasur besim te vetja e te fëmija për rezervat mendore. Kurse edukimin e konceptonte si një mbretëreshë të gjithëpushtetshme për ti bërë realitet potencialet intelektuale të fëmijës. Dhe kështu ka vepruar me inteligjence. Sa shumë dije ka derdhur mbi nxënësit e saj për 40 vjet!

Unë kam parë shumë orë mësimi te mësuese Zurija. Te çdo njëra kam mësuar diçka të re. Nuk kam parë asnjë orë të pa realizuar. E folmja e saj ka qenë sipas gjuhës letrare shqipe të njesuar. E ka njohur të folurit krahinor e dialektor, por nuk e pa përdorur gjatë mësimit. Në biseda me kolegët përdorte edhe fjalë të zonës për ti dhënë më shumë ngjyrë stilistikës së ligjerimit. Nuk ka punuar në detyra shoqërore jashtë profesionit. I janë ofruar, por nuk i ka pëlqyer. Ka punuar mësuese vetëm në Radomirë. Duket se që në fillim ka bërë një pakt me vetvetën, të mos largohej nga tempulli klasë. Kjo nuk e ka penguar të ketë jetën sociale, lidhjet me njerzit e saj.

Zurije (Ahmati) Koka u martua me mësuesin e historisë Shezivar Koka nga Radomira. Të dy, ia kushtuan jetën arsimit. Shezivari përfaqësues i pedagogjisë humane e demokratike, ndërsa Zurija anonte pak nga pedagogjia autoritare. Të dy kanë qenë model i sjelljes në komunitet. Fjalëmirë e besëmirë.

Shtëpia e Shezivar e Zurije Koka ka qenë një sofër bujare. Njerëz zemërbadhë! Pa shumë fjalë! Sa shumë mikpritje kanë gjetur shokët e kolegët te shtëpia e tyre! Mësuesit e ardhur nga rrethet e zonat e tjera janë ftuar shpesh nga Shezivari dhe pritja u ka ngelur në kujtesë për çiltërsinë e pritjes.

Fati çiftit Koka u dhuroi fatbardhësi. Shezivar e Zurije Koka lindën dhe edukuan tre fëmijë. Të shkolluar në shkallën më të lartë të arsimit. Familja Koka pensionin po e bëjnë në Tiranë, me ndëgjegje të qetë. Punuan të dy mësues perfesionalistë. Kjo ka qenë dëshira e tyre dhe e prindërve tyre. Jeta ua realizoi. Profesionin e kanë përcjellë edhe tek një fëmijë. Traditë e bukur!

Rruga e Arbërit nr. 118

Me rastin e 7 Marsit,
Ditës së Mësuesit

portret

Mësuesi ynë Adem Shehu

Nga Prof. **HAJRI SHEHU**

Mësues Ademi lindi në katundin Vleshë të qarkut të Dibrës më 1 maj të vitit 1914 në një familje me dije e tradita të vyera fetare e shoqërore. I ati, një burrë i zgjuar e i ditur, shërbeu tërë jetën si iman në katundin Fushë-Alie.

Në Vleshë ka pasur gjithnjë dije e mjedis dijeje, sidomos fetare. Madje herët – që nga viti 1800. Disa dijetarë, sidomos nga fisi Shehu u përgatitën në Stamboll. Më i pari, sheh Ibrahimi. Më pas, sheh Osmani e të tjerë. Sheh Osmani qe njohur edhe në oborrin e Ali pashë Tepelenës. Thonë se për një Ramazan ka shërbyer si imam te Pashai i Janinës. Kur është nisur për në vendlindje, Pashai i ka dhuruar një orë muri. Deri nga vitet '70 të shekullit të kaluar ora është ruajtur nga Xhemal Shehu, një i afërm i mësues Ademit. Më pas, me ndërmjetësimin tonë, ora i është dhuruar muzeut historik të Tepelenës. Pas sheh Osmanit do të kishte të tjerë dijetarë të fesë – çdo brez, të vetët, për të mbërritur deri te brezi i mësues Ademit e i të tjerëve më këtej. Imamë nga Vlesha kanë shërbyer në Arras, Fushë - Alie, Lazrei, Mustafe etj. Ky mjedis dijeje duhet t'i ketë nxitur djemtë e Vleshës, si Fehmi Xhepën, Halim Shehun, Hivzi Shehun etj., të vijonin Medresenë e Tiranës, të cilët pas Çlirimit do të bëheshin mësues. Ky mjedis duhet të ketë qenë nxitje për djemtë e Vleshës për të vijuar edhe arsimin laik. Në vitet '30 të shekullit të kaluar, tre janë ata që u bënë mësues me shkollë laike: Adem Shehu, Alush Abazi dhe Jonuz Shehu. Pas Çlirimit, një plejadë.

Por djemtë e Vleshës kanë pasur një privilegj. Në Trojak, më pas në Sllovë, pak më tej se fshati i tyre, ka pasur shkollë fillore që në vitin 1914. Kjo qe një shtysë e fuqishme. Madje, bash kjo shkollë i bëri shkollarë mjaft brezatarë të Ujëmujës (Sllovë, Sllatinë, Vleshë etj.). Dhe Ademi e kreu shkëlqyeshëm shkollën fillore në Sllovë.

Me ndihmën dhe mbështetjen e mësuesit të tij të shkollës fillore, Abdulla Çanga, një shkodran i formuar e i përkushtuar, Ademi siguroi bursë në internatin e Kastriotit. Pas dy vjet përpjekjeje, me ndihmën e ish-drejtorit të internatit, Ferit Jegeni (tashmë, zyrtar në Ministri të Arsimit) mundi të siguronte një bursë tjetër, për të vijuar Normalen e Elbasanit, një shkollë me emër aq të madh për kohën e për më pas. Në pushimet verore Ademi punonte te pemëshitësi Ali Guti, në Tiranë për të siguruar veshje, libra etj.

Ademi i përfundoi studimet për mësuesi në Normalen e Elbasanit në vitin 1934. U emërua mësues në katundin Grevë. Më pas punoi si mësues në katundet Zerqan, Sllovë, Kovashicë dhe Homesh.

Pas Çlirimit, nga viti 1945 e deri më 1966, kur doli në pension, punoi gjithnjë në arsim në qytetin Peshkopisë, si përgjegjës i seksionit të arsimit të rrethit në Peshkopi (1946-1947) (përgjegjës i seksionit të arsimit në qark ishte Selim Alliu), si inspektor i seksionit të arsimit të qarkut, si drejtor i shkollës 7-vjeçare, si mësues dhe si nëndrejtor i shkollës pedagogjike. Mësues Ademi ndërroi jetë më 1 maj 1975. Për punën e tij shembullore në arsim ai është dekoruar me Urdhrin e Punës të klasës së parë (më 1968) dhe me urdhrin "Naim Frashëri" të klasës së parë (më 1993).

Për Adem Shehun flet vetë puna e tij 32-vjeçare në arsim. Vetë ai ishte shumë i thjeshtë. Ai nuk e reklamonte kurrë veten dhe punën e vet. Kur e pyeste ndonjë bashkëfshatar i tij për punën në seksionin e arsimit të rrethit të Dibrës, ai do të thoshte vetëm kaq: Me shkollat merrem. Ai nuk thoshte se ishte numri dy në seksion e në gjithë sistemin e arsimit të një rrethi të tërë. Selim Alliu dhe Adem Shehu qenë bashkatarë në punën dhe në veprën e tyre. Ata hodhën bazat e arsimit në rreth pas Çlirimit. Dhe këtë peshë e mbajtën me dinjitet e me nder deri në fund të jetës.

Për numrin Një të arsimit në rreth – Mësuesin e Popullit, Selim Alliu, ka një libër. Është shkruar nga Sami Shehu. Libri numër dy do të duhej të ishte për Adem Shehun – me një veprimtari mësimore-edukative e drejtuese edhe jashtë seksionit. Mozaiku i tij është shumëngjyrësh. Ai do të rrezatonte fort, po të citoheshin ish-shefi i arsimit, Seim Alliu, kolegë të tjerë të seksionit, bashkëmësues e mësues të rrethit, ish-nxënës të tij etj.

Dy janë nëpunësit kryesorë të shtetit, - ka thënë shkrimtari i madh francez, Viktor Hygo: nëna dhe mësuesi. Por jo gjithkush mund të jetë mësues. Ademi qe. Edhe si inspektor, ai shquhej si mësues. Ai qe mësues përmbi mësues. Është vlerësimi i të gjithë atyre që e kanë pasur mësues ose koleg pune. Ne do të përmendim vetëm disa momente nga puna e tij, për të treguar sado pak karakterin e tij e punën e tij prej mësuesi.

Mësues Ademi ishte shumë kërkues. Por jo i ashpër. Tregojnë ish-nxënës të tij, tani burra: Ai kurrë nuk e nxirrte nxënësin nga klasa, edhe sikur të kishte shumë arsye. Nxënësi është nxënës, - do të thoshte ai. Fëmija është fëmijë, - do të shtonte më tej. Me autoritetin e tij prej edukatori, edhe thjesht me një shikim të ngulët do ta bënte nxënësin të ishte i përqendruar e i sjellshëm. Nxjerrja jashtë nga klasa ishte ndëshkim. E ndëshkimi do të tingëllonte si pedagogji herbartiane. E padenjë për edukimin. E padenjë për mësues Ademin. Këshilla e tij si zëvendësshef i seksionit të arsimit, si inspektor e drejtor shkolle e edhe



Adem Shehu

si mësues i pedagogjisë praktike ishte: Nxënësin duhet ta bëni për vete që t'ju dëgjojë me kënaqësi.

Mësues Ademi ishte shumë kërkues në punë. Por, edhe shumë nismëtar. Dhe mësuesi duhet të jetë, sigurisht i tillë. Në vitin shkollor 1961-1962 ishte nëndrejtor i konviktit të shkollës pedagogjike. Bëri dimër shumë i ashpër. Fjetoret ishin të mëdha – me nga 40 veta. Mjedisi s'ngrohej as me soba. Me nismën e vet, - do të tregonte më vonë i ndjeri profesor Zenel Sula, - atëherë drejtor i shkollës pedagogjike, - Ademi kishte vendosur të çonte konviktorë në fshatrat përreth qytetit. I kishte thirrur nxënësit e jashtëm të shkollës dhe u kishte thënë: Sa shokë mund të merrni secili nga ju të flenë në shtëpitë tuaja? Ndërkohë që ata flenë me ju, ju do të vini të hani në mensë me ta. Dhe kështu u bë. Në fshatrat përreth qytetit shkuan e bujtën konviktorë. Pritësit nuk erdhën për të ngrënë në mensë se s'kishin arsye. Por bënë rregullin e mikpritjes dibrane me bujtësit. Dhe u lidhën ura miqësie. Ata që mbetën në fjetore, i vuri dy e nga dy në krevate, që të flinin ngrohtë. E mora vesh, - thoshte drejtor Zeneli, - dhe i thashë Ademit se nuk lejohej të flinin dy veta në një krevat. Ma ktheu krejt qetë Ademi: Ti shih mësimin! Të tjerat m'i lër mua!

Mësues Ademi kishte formim të admirueshëm intelektual e shkencor. Kjo e bënte të sigurt në gjithçka që thoshte, jo vetëm në mësim, por edhe në biseda të lira. Njihte shumë mirë gjuhën frënge. E një gjuhë e huaj është, siç dihet, baras me një fakultet. Ishte metodist i përkryer. Prandaj edhe ka dhënë mësim si metodist. Prandaj edhe qe mësues i pedagogjisë praktike në shkollën pedagogjike.

Te mësues Ademi mund të përveçohen shumë e shumë veti karakteristike për një edukator. Do të përmendim vetëm dy. Ishte sahumë sistematik - në gjithçka: në ditaret e tij, në rregullin në klasë e në shkollë, në tryezën e tij të punës e deri te lapsat e mprehur në xhepin e jashtëm të sipërm të xhaketës (atëherë nuk kishte stilolapsa). Vetia e dytë, shumë e spikatshme te mësues Ademi, ishte puna e tij e ngulmët në klasë me fjalën, me thënien, me tekstin. Jo vetëm në lëndën e këndimit (leximit), por edhe në aritmetikë etj. Sipas moshës e dijeve të nxënësit (një parim pedagogjik universal në punë të të nxënit), mësuesi përçonte konceptetet e nocionet njerëzore te nxënësit (p.sh., ç'është nëna; ç'është babai; ç'është familja; ç'janë kandrrat; ç'është sasia; etj.). Dhe nxënësit e mësues Ademit nuk e kishin të vështirë të jepnin përkufizimet e perifrazimet e tyre të sakta për këtë a për atë send, dukuri etj. Jo vetëm kaq. Por edhe ta lidhnin fjalën me fjalën - një detyrë jo fort e lehtë edhe sot, në kohën e internetit. Këto ushtrime do t'i kërkonte edhe si inspektor. Me këto lloj ushtrimesh mësues Ademi na jep këtë mësim: Para se nxënësi të mësojë gjuhën për gjuhën (emër i përveçëm, emër i përgjithshëm, kryefjalë, kallëzues etj.) duhet të mësojë vetë gjuhën. Nuk është habi që të ketë edhe të rritur që të mos dinë të perifrazojnë përmbajtjen kuptimore edhe të një fjale shumë të njohur. Ushtrime gjuhësore si ato të mësues Ademit (le t'i quajmë ushtrime fjalori) sjellin te nxënësi jo vetëm lidhjen mendim - gjuhë - ligjërim, por edhe pasurimin e fjalorit të tij e aftësinë për të folur mirë e drejt.

Mësues Ademi i trajtonte njëlloj nxënësit. Trajtimi preferencial mund të çojë në rivalitet. Mësuesi nuk ishte për këtë. Mësuesi ishte për emulacion e garë ndërmjet nxënësve, për të përparuar të gjithë. Tregojnë që njëherë mësues Ademi kishte pasur në klasë dy nxënës – njëri trazovaç e tjetri i veçuar. Nuk ka nevojë për shumë imagjinatë. I bëri të dy të mirë.

Kështilla e mësues Ademit ishte e bukur. Në vitin 1958, - tregon Rasim Hoxha, ish-zyrtar në Kontrollin e Lartë të Shtetit, - isha nxënës në shkollën "Demir Gashi". Mësues Ademi ishte drejtor i shkollës. Ne na jepte gjuhën dhe leximin. Mbaj mend se sa bukur e lidhte tekstin me kështillën që do të jepte. Ishte teksti "Dashuria e nënës". Subjekti: një zog mbron të vegjlit e vet nga gjarpri. Mësuesi e shpjegoi copën e leximit aq bukur. Shpendët bëjnë gjithë këtë sakrificë për të mbrojtur e rritur të vegjlit e tyre. Po nënat tuaja, a e dini sa shumë ju duan e sa shumë përpiqen, mundohen e lodhen për ju? Atëherë, edhe ju duhet t'i doni shumë nënat tuaja, - qe kështilla e tij.

Mësues Ademi e vlerësonte shumë punën e nxënësit dhe nxiste dëshirën për punë. Në një bisedë të tij tregonte: Ngrita në mësim një nxënës të mirë dhe e vlerësova me notën 4 (sipas sistemit të vlerësimit me 5). Ngrita një nxënës tjetër, jo aq i mirë. Edhe atë e vlerësova me 4. Në pushim, nxënësi i parë sikur ankohet pse i kisha vënë 4, njëlloj si të dytit. E pyeta, - thoshte mësues Ademi: Sa herë e kishe lexuar mësimin? Tri herë, - tha. Pyeta nxënësin e dytë: Sa herë e ke lexuar mësimin? 16 herë, - më tha. Ja pse e vlerësova njëlloj si ti, - i thashë, - ai ka punuar më shumë se ti.

Shkolla "Demir Gashi" kishte bazën prodhuese. U kultivuan në kopshtin e shkollës perime, të cilat deri atëherë nuk kultivoheshin në Peshkopi: bamja, karrota, panxhari i kuq, patëllxhani etj. Kur i shkulëm karrotat, - tregon përsëri Rasimi, - erdhi edhe drejtor Ademi. A u ke thënë nxënësve, - iu drejtua mësuesit të punës bujqësore, - se karrotat mund të hahen të gjalla, pa u gatuar? Dhe e mori një, e lau dhe e hëngri përpara nesh. Ne u habitëm, - thotë Rasimi. Dhe mësuam nga drejtor Ademi sesi hahej karrota. Intuita e drejtorit ishte mjaft e gjetur. Kur vilej prodhimi, punonin edhe mësuesit. Bashkë me ta, edhe drejtor Ademi. Ademi ka qenë edhe mësues i punës praktike bujqësore. Në këto mësime e punë praktike, mësuesi edukonte te nxënësi vullnetin për punë fizike. Vinte në punë nxënësit. Punonte edhe vetë.

Mësues Ademi ishte shumë i këndshëm në mësim. Në jetë ishte fjalëkursyer. Në mësim ligjëronte. Kishte talent të veçantë për të të rrëmbyer me fjalën e tij. Fjala e tij ishte e ëmbël, e shtruar e shumë mbushamendëse. Mbaj mend dy raste. Rasti i parë: Kishte ardhur në shkollën tonë (fillore) në Vleshë për inspektim. Mësues kishim Fehmi Xhepën. Një arsimtar shumë i zoti. Në një moment të caktuar, inspektor Ademi u bë mësuesi ynë. Me sa kam vrarë mendjen kur jam bërë vetë mësues, inspektori ka dashur të provonte inteligjencën e fëmijëve. Sepse pyetja qe e tillë. Na kishin qenë tri vajza, - filloi fjalën inspektori. I kishte pyetur babai: - Sa më doni – sa sheqeri a sa kripa? Përgjigjen e vajzave do t'jua them pastaj, - vijoi inspektori. Unë dua të di cila është përgjigjja juaj. Për ne atëherë përgjigjja do të kishte qenë "sheqeri", sepse atë e kishim të paktë. Ç'do ta donim kripën, edhe po ta kishim me mbushulli? Dhe inspektori mbeti i kënaqur kur shumë nga ne parapëlqyen kripën. Por qe zotësia e inspektorit që na pruri në këtë përgjigje. Kripa ishte jetike për organizmin e njeriut, - do të plotësonte më tej inspektori me fjalë të thjeshta e të shtruara, si për fëmijë. Rasti i dytë: Në shkollën 7 - vjeçare të Sllovës. Përsëri për inspektim. Ishte tregimi i M. Gorkit për Pahomin. Fjalëve të mësuesit inspektori u shtoi këshillën: "Njeriu nuk duhet të tregohet i pangopur e lakmitar."

Fjala e mësues Ademit ishte edhe shumë prekatare. Në vitin shkollor 1962-1963 e kalojnë mësues të pedagogjisë praktike në shkollën pedagogjike. Ja edhe një episod për mësues Ademin: Një mësuese e ushtrimores duhej domosdo të merrte leje e kërkonte një nxënës të klasës së katërt të shkollës pedagogjike ta zëvendësonte për disa ditë. Kërkoi aksh nxënës. Mësues Ademi e pyeti: A s'pati të tjerë që zgjodhe këtë? Megjithatë, mirë, mirë, - tha mësues Ademi. Është e drejta jote, - shtoi. Deri këtu s'ka, sigurisht asgjë për t'u përveçuar. Mësues Ademi i shkon në një orë mësimi praktikantit. Do ta shihte si e jepte mësimin. I pëlqeu. Atë ditë kur praktikanti do t'ia dorëzonte klasën mësueses, shkon përsëri mësues Ademi. Tani, vetëm për të thënë fjalën e tij prekatare e entuziaste për praktikantin: "Bëre mirë që e zgjodhe (dhe tha emrin e praktikantit). E dija që ishte i mirë, por jo kaq". Ishte njeri që donte t'i bënte të tjerët, vërtet optimistë e entuziastë.

Mësues Ademi ishte, vërtet njeri me intuitë të hollë, çka do të thotë që ai do të gjente bash momentin për ta thënë diçka. Një herë, në Vleshë, i pëlqeu të ngjitej në Krye të Zabelit. Ishte kënaqur me bahçet e Vleshës e Bademin. (Në parantezë: Bademi është një rrethojë paksa e ngritur, me shtufa të gdhendur. Ai mund të shpallet monument kulture. Poshtë shpaloset fusha e bukur e Vleshës). Deshte krenajën e Zabelit. Ishte vetë i tretë - bashkë me dy bashkëmoshatarë e bashkëmësues të Vleshës – Jonuzin e Halimin. Qe, vërtet një piknik i bukur. Në Krye të Zabelit janë tre drurë të mëdhenj ahu - shekullorë. Edhe këta mund të shpallen monument natyre. Një burim uji sa një pikërrimë, me një lëfyt të vogël, është i pashtershëm në shekuj. Atje njeriu është aq lart, sa i duket vetja si në aeroplan. Atje je, vërtet triumfator. Dhe Ademi u mallëngjye fort, - tregonte Jonuzi.

Mbase u larguam nga ajo që donim të thoshim: intuita e hollë e mësues Ademit. Diku afër Kroit të Shëngjergjit – atij burimit të vogël, është një kodër që quhet Shkodër. Kur u kthye në fshat, na tha ne mësuesve e studentëve: Në Krye të Zabelit ka një vend që quhet Shkodër. Asht interesant ky emën. Ato livadhet, bregajat, gropat tektonike, vise të tjera në fushë e në katund kanë emna. I mblidhni sepse emnat e vendeve kanë vleftë fort edhe për gjuhën, edhe për historinë. Një mësim tjetër i vyer i mësues Ademit. Këshilla e bëri punën e vet. Qe në momentin e vet. Sot emërvendet e Vleshës janë në një kartotekë të posaçme në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë. Po kaq me vend kishte qenë këshilla e tij në një drekë në një familje në vitet e para të mësuesisë. Domatet hahen edhe sallatë, - i kishte thënë zonjës së shtëpisë. Dhe ajo kishte mësuar si bëhej sallata. Ishin fjalë mësuesi. Dhe mësuesi dëgjohej me përkushtim. Shumë vjet më pas kishte pyetur për atë familjen: A hanë veças, në pjata të veçanta? I kishin thënë: Po. Ishte lumturuar.

Vlesha, katundi i tij i lindjes, e nderonte shumë. Kur vinte Ademi në Vleshë tek i vëllai (edhe ky, një njeri shumë fisnik), brenda pak minutash do ta merrte vesh e tërë mëhalla. Do ta merrnin vesh edhe gratë e fëmijët. Fjala kishte këmbë: "Ka ardh Ademi". Sepse Ademi ishte njeri me autoritet e i ditur. Nuk fliste shumë, por çdo fjalë e kishte të mençur. Dhe njerëzit hapnin sy e veshë se ç'thoshte Ademi.

Mësues Ademi shquhej për integritetin e tij. Ishte Adem e jo dokushdo. Ai dallonte edhe në paraqitje e në veshje. Tregojnë, kur ishte mësues në fshat: Ai kurrë nuk hyri në klasë me çizme. Diku, te këndi i tij i mësuesit mbante këpucët. Dhe hiqte çizmet e mbathte këpucët pa baltë. Sepse mësuesi udhëheq me shembullin e tij edhe në veshje e në paraqitje.

Në Vleshë, si për shaka, në biseda më të lirshme, djalit Adem do t'i kujtonin edhe ndonjë nga ato çapkënëritë e moshës. Ndoshta s'kanë qenë çapkënëri, por ka qenë ajo gjallëria e një temperamenti sanguin. Ademi pruri në vendlindje kërcimin sportiv me shkop. Kur vinte për pushime, ai e demonstronte para të tjerëve: kërcente mbi avllitë. Shkopi nuk mund të ishte sigurisht prej bambuje. Ishte nga drurët e fortë të vendlindjes. Në një mjedis tjetër e në rrethana të tjera, Ademi mund të ishte bërë sportist me emër. Ani. Edhe çfarë qe, i mjafton. Më vonë, kur doli në pension, u bë amator i përkushtuar peshkimi në Dri. Sport i bukur dhe ky. Për njerëz të fortë e të duruar si Ademi.

Mësues Ademi luante shah shumë mirë. Kjo, - do të thoshte dikush, - s'ka të bëjë me mësuesin e me mësimin, as me inspektorin e me inspektimin. Po, s'ka të bëjë. Por ka të bëjë me një thënie të mençur të Adem Shehut, ngulitur nga mësues Durmishi, gjithashtu, njeri i shahut e i lojës së shahut: "Në lojë njihet njeriu." A nuk është kjo një aksiomë?

Ademi dhe e shoqja, Nazmija, një zonjë grua nga fisi Gugushka në Dibër të Madhe, rritën gjashtë fëmijë. Ata janë njëri më i mirë se tjetri. Domosdo. Sepse u rritën e u edukuan në një familje mësuesi e nga një zonjë Dibre, si Nazmija.

Anglezët kanë një fjalë të urtë: "I vetmi ilaç që një familje mund ta mbajë në shtëpi është gëzueshmëria." Familja e mësues Ademit shquhej për gëzueshmëri e alegri. Mësuesi kishte kulturë të gjerë muzikore. Me instruementin e tij të dashur - violinën luante muzikë të lehtë dhe klasike. Nga kompozitorë të mëdhenj shqiptarë dhe botërorë: Jakova, Zadeja, Bah, Bet'hoven, Shubert, Moxart, Verdi etj. Aty në shtëpi. Spektatorë ishin fëmijët dhe e shoqja. Mjaft shpesh, mësuesi improvizonte në shtëpi kor. Kori ishin gjashtë fëmijët (katër vajzat dhe dy djemtë). Drejtuesi i korit: babai me violinë. Ia nisi kori i Ademit, - do të thoshin me kënaqësi fqinjët e kalimtarët dhe do të vinin vesh për të dëgjuar. Përveç violinës, të shtrenjtë pati mësuesi edhe radion "Philips". Me të shëtiste nëpër botë. Informacionet ekonomike, politike, kulturore etj. dhe ngjarje të rëndësishme botërore, - thotë Urani, i biri, - i vërtetësonte gjithnjë përmes burimeve të tjera (të ndaluara për kohën), si Zëri i Amerikës, stacionet franceze dhe italiane.

Mësues Ademi lexonte shumë. Nuk ka ndodhur ndonjëherë, - kujton Urani, - që babi të ketë fjetur pa lexuar. Biblioteka e tij qe shumë e madhe dhe e larmishme për kohën. Kishte libra artistikë, shkencorë, pedagogjikë, historikë, filozofikë etj. Librat kishin nënvizime pa fund. Anët e faqeve mbusheshin me shënime. Po t'i shohësh ato, do të shohësh kulturën e gjerë dhe përsiatjet e mprehta të mësues Ademit.

Ky ishte mësues Ademi.

reportazh

Banorët jetojnë vetëm përmes bimëve medicinale. Punohet 6 muaj në vit për të jetuar edhe 6 muajt e tjerë.

Ilnica, *historia e një fshati të humbur*

Nga **MARIN MEMA***

Një pamje e zymtë të shfaqet vetëm disa qindra metra, pasi devijojmë nga rruga nacionale që të drejton për në Peshkopi. Shtëpitë e para i përkasin Melanit, një fshat thuajse i braktisur.

Rruga është një shteg i masakruar, ku çdo mjet do ta kishte të vështirë të kalonte. Pesë kilometra nga pjesa e fundit e shtruar, në këmbët e majës së zbardhur të Velivarit ngrihet Ilnica, me shtëpitë e mbledhura që bien në sy për madhësinë e tyre.

"Ilnica do të mund të ishte padyshim një fshat i zhvilluar, por nga dëshira në realitet, ndryshimi sigurisht është i madh. Sot ky fshat, që ngrihet jo larg qytetit të Peshkopisë, ofron pak ose aspak për banorët e tij".

Deri në vitet '90, fshati ka pasur mbi 60 familje, ndërsa sot ato janë rreth 20. Nuk është e vështirë të kuptosh se përse janë larguar. Infrastruktura e rrënuar dhe shumë mungesa të tjera nuk u dhanë alternativë tjetër.

"Nuk ka rrugë, s'ka asnjë gjë prej gjëje. Kjo është ajo që detyron të largohet e gjithë rinia, sepse nuk kanë një të ardhme këtu në vendin e tyre. Këtu diskutohet buka e gojës, në këtë fshat rrezikohet buka e gojës", thotë Klodian Alia.

Nëse ke një rast urgjent, një të sëmurë apo një problem tjetër, duhet të paguash jo më pak se 200 lekë për në Peshkopi. Ndërsa lëvizja normale bëhet me furgon, që banorët e paguajnë 150 lekë. Për disa, shuma të tilla mund të duken qesharake, por në një fshat ku të ardhurat mungojnë tërësisht, ato janë të konsiderushme.

"Shikojeni rrugën si është, gjithçka e tregon vet ajo. Edhe ti (Marinit) vet ke ardhur me makinë, e tregon vet rruga si është. Mendo, unë që shkoj përditë", thotë Myfit Nurçe.

Ilnica, edhe pse nuk ka shumë toka, prodhonte jo pak produkte. Banorët përpiqen edhe sot, por mungesa e ujit vaditës e bën të pamundur, që bujqësia t'u garantojë të ardhura të mjaftueshme.

"Toka punohet siç e punonin gjyshërit tanë përpara, apo edhe stërgjyshërit tanë. Kemi probleme me ujin e vaditjes. Nga ana ekonomike, ma merr mendja që shihet edhe vet, nuk ka nevojë ta përshkruash më tepër me fjalë. Edhe shtëpitë, banesat tregojnë anën ekonomike", thotë Remzi Istrefi.



Foto © Zaim Elezi

"Toka jonë është komplet në të thatë, nuk jep asnjë lloj prodhimi. Me vështirësi shumë të mëdha jetojmë, një pikë ujë me zor ke. Ky është një fshat i thatë, pa ujë. Për jetesën, marrim një thes miell dhe nja dy gjëra të tjera sa për të jetuar, sa për të kaluar radhën", thotë Xhelal Istrefi.

Të mbijetosh në këtë fshat është më shumë se e vështirë. Thuajse të gjitha familjet janë në varfëri të plotë. Shtëpitë e vjetra thuajse po bien, e mes tyre, banorët do ta kenë të vështirë të shpëtojnë. Mjafton të shikosh kudo në rrugicat e fshatit, e do të të duket sikur je rikthyer në kohë, ose sikur ke marrë imazhe nga filmime të vjetra të shekujve më parë. Kudo rrënim.

"Më katastrofë nuk ka ku të gjesh, çdo gjë mos më keq. Nga shteti nuk kemi asnjë përkrahje, çfarë të themi", thotë Përparim Shehu.

Në këto kushte, banorët jetojnë vetëm përmes bimëve medicinale. Punohet 6 muaj në vit për të jetuar edhe 6 muajt e tjerë. Të gjithë, të mëdhenj e të vegjël merren me këtë punë, për të garantuar minimalen e mundshme. Mjafton të shikosh fitimin, për të kuptuar se me sa pak duhet të mbahen këta njerëz. Të tjerë kanë vetëm ndihmën sociale.

"Në 6 muajt e verës mund të mbledhësh 2-3 milionë lekë, më shumë s'ka. E këto pastaj i hamë dimrit që vjen. Vetëm me këto lekë duhet të jetojmë për një vit të tërë", thotë Ermal Alia.

"Me një asistencë mbahem, 3 mijë lekë në muaj. Me këto i bie të mos mbaj as veten, vetëm për bukë", thotë Asllan Nurçe.

Për investime nuk bëhet fjalë, madje as për premtime. Banorët thonë se politikanët nuk kanë interes, pasi e konsiderojnë Ilnicën një fshat shumë të vogël. Sot, ata janë pjesë e Bashkisë së Peshkopisë, por thjesht zyrtarisht, sepse praktikisht nuk dinë se ku të kërkojnë të drejtat e tyre.

Ky komunitet ka mbetur në mes, në njërin krah skamja që i ka vënë përposhtë, e në tjetrin që askujt nuk u shkon ndërmend të sjellin investime në këtë vend, në këtë zonë.

Por, a kanë edhe këta njerëz të drejta? Si duhet të jetojnë gjithë këta fëmijë të vegjël dhe, a duhet të përgjigjet dikush të paktën për ta?

"Dy makinë zhavorr nuk i sjell njeri për të mbushur një gropë. Sapo fillon bora, këtu bllokohet gjithçka. Shkolla problem. Këtu nuk jetohet, sepse po nuk lëvize, nuk jetohet. Si do të dalë për ushqim këtu. Toka këtu s'prodhon, veç të mbash një lopë, me vështirësi edhe atë. Tjetër gjë për të jetuar nuk ka", thotë Refik Shehu.

Në Ilnicë, ndoshta është e tepërt të flasësh edhe për varfëri, sepse edhe ajo vet dukshëm do të kishte frikë të jetonte këtu...

Marrë nga "Shqipëria Tjetër". Shih videon në linkun: http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=319619

Në Ilnicë, ndoshta është e tepërt të flasësh edhe për varfëri, sepse edhe ajo vet dukshëm do të kishte frikë të jetonte këtu...

Deri në vitet '90, fshati ka pasur mbi 60 familje, ndërsa sot ato janë rreth 20. Nuk është e vështirë të kuptosh se përse janë larguar. Infrastruktura e rrënuar dhe shumë mungesa të tjera nuk u dhanë alternativë tjetër.

Krasitja *do t'u rikthejë blirëve* **bukurinë**

(Vijon nga faqja 12)

Projekti i kryerjes të punimeve duhet të ishin bërë të ditura qytetarëve, të paktën një muaj përpara nëpërmjet, shpalljeve me afishime të shkruara, mjeteve të komunikimit etj

Duhet që të ishin vendosur tabelat e ndalim qarkullimit gjatë kryerjes së operacioneve krasitës etj.

Të shoqërohesh prerja me transportimin e materialit drunor, pastrimin e pjesëve të shëtitores ku u krye krasitja. Kjo për arsye sigurie të kalimtarëve dhe për të mos mbjellë shqetësim e panik tek qytetarët për këto punime të pazbatuara ndonjëherë.

Meqenëse më parë nuk janë kryer operacione krasitje dhe bliret janë të një moshe rreth gjashtëdhjetë vjeçare, krasitja duhet të ishte më e moderuar, pra, me gjatësi degësh 1,5 -2 m. Sepse: *Kryerja e një krasitje të gabuar është tepër e vështirë të riparohet, megjithatë duhen marrë disa masa për të rifilluar zhvillimin natyral, edhe pse dëmtimet, defektet do të mbeten, duke qenë të dukshme për gjithnjë.,,* (Salus Arboris. Potatura alberi ornamentali. Internet 15 Aprile 2010)

Nuk është ruajtur parimi i simetrisë së kurorave, duke dëmtuar pamjen e shëtitores të qytetit të Peshkopisë.

Nuk është kujdesur për të "fshehur" në një farë mënyre pasqyrën e prerjeve, duke dëmtuar pamjen e kurorave të mbetura të blireve, si dhe fole për zhvillimin e kërpudhave e bakterieve.

Këto ishin disa mendime rreth kryerjes të krasitjeve të blireve të shëtitores, duke operuar mbi fotografitë dhe mendimet e shprehura në rrjetet sociale.

KUJDESIMET QË DUHEN KRYER

Tanimë Bashkia e qytetit të Peshkopisë duhet të gjejë burime financiare për të ndjekur vazhdimësinë e vegjetimit të blireve të krasitur. Kjo është domosdoshmëri jo vetëm për të korrigjuar gabimet e kryera, por edhe për të papriturat klimatike që mund të ndodhin gjatë vitit të parë.

Gjatë muajve në vazhdim duhen kontrolluar pasqyrat prerëse, ku me të parë kalbje nga lagështira, instalimi i kërpudhave, kalbje nga bakteriet, çarje nga ngricat, të pastrohet me thika shartimi ose sharrë dore më dhëmbë shumë të imët, duke ia hequr me shumë kujdes e delikatesë, pjesën e infektuar ose të kalbur. Pastaj të lyhet me një lëndë plastike, që luan rolin e dyllit të bletës, i cili përdorej në shartime, për të eliminuar rishfaqjen apo rivendosjen e tyre nëpërmjet izolimit me këtë substancë.

Të kryhet ujitja e atyre blireve në muajt qershor deri në gjysmën e shtatorit që shfaqin dobësi në sasinë filizave të dala në të gjithë pjesët e kurorave, si dhe në madhësinë e rritjes. Me ujë të bollshëm. Si dhe të shoqërohet me plehra kimike, nitrat për të nxitur vegjetacionin. Doza duhet të këshillohet me literaturën ose me udhëzuesin që shoqëron ambalazhi i plehut.

Me t'u shfaqur në gjethe, insekte që hanë gjethet ose sëmundje bakteriale apo kërpudhore të kryhet dezinfektimi sipas llojit të sëmundjes apo dëmtuesit.

Për arsye të krasitjes së sforcuar, përreth trupit, rrënjëve në sipërfaqe do të vegjetojnë filiza të shumta, të cilat duhet të priten vazhdimisht, sepse pakësojnë rritjen e filizave në kurorën e drurëve.

Në dimrin e ardhshëm të kryhet krasitja me gërshërë lulishtari tek bliret me kurorë të zhvilluar pak ose të prerë më shumë se bliret e tjerë, të ulet dendësia duke hequr filizat më të shkurtër, por duke ruajtur dendësinë dhe parashikuar formimin e një kurore natyrale, të plotë dhe simetrike. Ndërsa për blirët e krasitur më pak ose me filiza të zhvilluar me një ritëm vegjetativ të vrullshëm të hiqen filizat më të gjatë dhe më të trashë. Kjo kryhet për të formuar një peizazh kurorash përafërsisht simetrike ose për t'i arritur ato sa më shpejt Kjo lloj ndërhyrje duhet të vazhdojë derisa të formohet kurora natyrale.

Po qe se thahen degë të trasha, pra, nuk vegjetojnë, të priten pa pritur pushimin e vegjetacionit, por është e detyrueshme lyerja e pjesës së prerë me substancën izoluese për ta mbrojtur nga faktorët klimatikë, bakteriet e kërpudhat. Kjo për arsye estetike.

* * *

Iniciativa të tilla të krasitjes së drurëve zbukurues në shëtitoret e qyteteve, rrugëve brenda e jashtë tyre, lulishteve, parqeve, duhet të kryhet në gjithë Shqipërinë, sepse jo vetëm:*"...Prerja e degëve nxit zgjimin e sytheve të fshehur, e atyre ekzistues..*,,(F. M. Fziu Calend.giard. f. 28 Milano 2001), por edhe lulishtarët, drejtuesit e bashkive mësohen me këto veprime biologjik-formuese të domosdoshme, zgjatje moshe të drurëve, fitimi i pamjeve më të bukura, të pastra e të shëndetshme. Gjithashtu, këto lloj krasitjesh janë të këshillueshme për llojet drunore zbukuruese si: akacien, plepat, rrapat, ilqen, caracin, lojfatën, panjën amerikane, soforat, glediçjen etj,. ndërsa për halorët këshillohet vetëm ulja e dendësisë së degëve, pa prerë majën e trupit kryesor dhe të degëve.

Këto operacione pune do të punësonin njerëzit, do të kualifikojnë kryerësit e krasitjeve, do të nxisin kualifikimin e shkollimin, do të njohin mjete e vegla të reja për të kryer, shpejt, mirë e lirë këto punime lulishtarie për të cilat Shqipëria është e fundit në Europë.

Firence 22 02. 2016

Rruga e Arbërit nr. 118
botime

Autorët e këtij libri, hidrologët Tofik Jegeni dhe Molnar Kolaneci, si dhe juristi Saimir Shatku kanë sjellë një vështrim shumëplanësh mbi çështjen me botimin e librit "Dibra e Madhe dhe Radika"

Lumi **Radika**, një vështrim hidrologjik, ekologjik dhe legjislativ

Nga **TOFIK JEGENI**

Për një djalë gjashtëvjeçar udhëtimi me autobus nga Tirana për në qytetin e Dibrës, që zgjaste gjashtë deri në shtatë orë, duke ndjekur rrugën nacionale për në Rrëshen, Klos, Bulqizë, Ura e Topojanit, Bllatë dhe përfundimisht në vendmbërritje, ishte si një aventurë e shumëpritur drejt një vendi të dashur, përmendur aq shpesh në familje, si një pjesë e rëndësishme e saj, por që për shkak të rrethanave mbetej ende për t'u zbuluar. Tirana e nxehtë nuk ishte aspak vend joshës në verën e vitit 1942. Njerëzit, nga vapa torturuese, i bënin bisht qytetit gjatë sezonit dhe familja, përshi këtu dhe ato të axhëve, deri në këtë kohë kishte kërkuar shpëtim nga tendencat e zhvës së termometrit drejt majës në qytezën liqenore të Pogradecit, që, përveç liqenit të freskët, falë lartësisë gjeografike, ofronte temperatura më të moderuara se sa kryeqyteti.

Por vera e 1942 ishte ndryshe. Parë me sytë e tanishëm, ngjarja e krijimit të Shqipërisë së Madhe atë vit, qoftë edhe pse nën tutelën e Italisë së Musolinit, kishte ngazëllyer zemrat e mbarë shqiptarëve, sidomos të atyre që Lufta Ballkanike dhe vendimet e marra pas saj i kishin dënuar të mbeteshin jashtë kufirit të shtetit amë. Shqiptarët e Malit të Zi, të Kosovës, pjesës perëndimore të Serbisë së Jugut (të Maqedonisë sot) dhe Çamërisë më në fund patën mundësinë të realizojnë ëndrrën e bashkimit të territoreve të tyre me Shqipërinë. Po kështu për ata shqiptarë nga këto troje, që për t'i shpëtuar kasaphanës së luftërave ballkanike 1912/13 dhe mizorive të serbëve, malazezëve, grekëve dhe palëve të tjera ndërluftuese, kishin përfunduar si refugjatë në qytetet e ndryshme të Shqipërisë së porsakrijuar. Vendlindja po i thërriste.

Të pretendosh se ekzaltimi i çastit ia la vendin lumturisë kur mbërritëm në qytetin e origjinës së familjes, Dibrën e Madhe, fare mirë mund të interpretohet si shtirje. Mjerimi i qytetit, që nuk kishte parë një ditë të bardhë që kur Perandoria Otomane, në dobësinë e vet kronike, ia kishte lëshuar vendin hordhive gjakatare serbe, për të përjetuar rrënimin e vazhdueshëm, në mbretërinë sllave, dhe tërmeteve të pandashme, bëhej edhe më i dhimbshëm nga fakti se familja duhet të sillte me vete të gjitha ushqimet nga Tirana, e cila në atë kohë jetonte në një begati relative, falë subvencionimit italian. Atë kohë në Dibër s'kishe ç'të haje. Të trishtueshme ishin lotët e heshtur të tim eti, i cili nuk kishte qenë aty prej shumë kohësh dhe që, sigurisht, ndjente dhimbje të fortë për qytetin dhe banorët e tij.

Jam i sigurtë se nuancat e veçantisë së këtij momenti historik apo degradimi shoqëror dhe ekonomik i këtij qyteti, që, në më pak se pesëdhjetë vjet më parë thuhej se kishte pasur deri në 30 000 banorë dhe se kishte qenë qendra administrative e sanxhakut të Dibrës, ishin të pakuptueshme për një fëmijë vetëm gjashtë vjeç. Por nga kujtimet e rralla që i ruaj në mendje edhe tani në muzg të jetës ishte udhëtimi i përditshëm me kalë nga shtëpia e familjes deri te ura e Spiles, për të notuar në lumin e qytetit, në Radikë. Me gjithë mungesën e motrave adoleshente, të cilat kishin preferuar të rrinin në shtëpi, dhe të vëllait të vogël, që se për çfarë arsye kishte mbetur në Tiranë, nuk e përshkruaj dot kënaqësinë e atij fëmije kur zhytej në ujin e kristaltë të atij lumi të magjishëm.

Vështirë që atë kohë të mendoja se një ditë, në skajin tjetër të jetës sime, do të vrisja mendjen për këtë lumë dhe rrezikun që i kanoset ujit të tij. Pas verës së vitit 1942 dhe të vitit 1943 Radika do të fshihej në një skutë të zemrës dhe të mendjes sime për vite të tëra, falë kapriçove të historisë, që, pas Luftës së



DIBRA E MADHE DHE RADIKA
Autorët: M.Sc.Tofik Jegeni
Prof. Dr. Molnar Kolaneci,
PhD. Saimir Shatku
Redaktore: Lumturi Prizreni
Përkujdesja grafike: Bujar Karoshi
Në kopertinë: Ujërat e Radikës.
Foto: © Gazmend Kërkuti
ISBN: 978-9928-172-67-9
Çmimi: 1000 lekë / 10 USD

Dytë Botërore, vendosi t'i ndajë njerëzit e një gjaku me mure të lartë, si ai i Berlinit. ose me gardh të përshkuar nga korrenti, si ai që ndante Dibrën e Shqipërisë me atë të Jugosllavisë.

Një ditë tjetër, kur historia vendosi të korrigjonte gabimet e të shembte murin e Berlinit, unë përsëri u ktheva në Dibrën e Madhe, pas dyzet e sa vjetësh. Këtu ia vlen të ndalem për një digresion të shkurtër dhe për një korrigjim. Unë u mora me mbledhjen e të dhënave hidrologjike që Instituti Hidrometeorologjik, ku punoja, i dërgonte palës shqiptare në mbledhjen e jashtëzakonshme për ekonominë ujore ndërmjet Shqipërisë dhe RSFJ-së (Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë), në korrik të 1962-shit, ku, ndër të tjera, ishin edhe të dhënat për Radikën, Drinin e Zi dhe Liqenin e Ohrit. Pas kësaj, takimi tjetër me Radikën do të ishte në fillim të vitit 2013, kur gjatë vizitash në këtë qytet për rrugën e Arbrit, që do të lidhë Tiranën me distriktin e Dibrës, unë u njoha, nëpërmjet bisedave me Argëtim Fidën dhe Ruzhdi Latën, dy personalitetet të njohura të qytetit të Dibrës, me projektet e Lukovo Pole-s dhe të Boskov Most-it, e sidomos me atë të parin, që planifikon të marrë edhe më shumë ujë nga Radika, për ta dërguar drejt sistemit energjetik të Mavrovës dhe më pas në lumin Vardar për t'u derdhur në Detin Egje.

Siç doli jo vetëm ata, por edhe shumë dibranë të tjerë ishin të shqetësuar për faktin se Dibrës përsëri po ia bënin me hile, duke marr ujë nga lumi i saj dhe duke e derdhur gjetiu, duke rrezikuar liqenin e Dibrës dhe sasinë e ujit që u duhet bujqve për vaditje. Një përvojë e mëparshme e hidhur, tepër e ngjashme, kishte ndodhur në vitin 1967, kur u ndërtua hidrocentrali i Spiles, që përmbyti fushën e Udovës. Dibranët humbën tokën e bukës dhe fjala e dhënë për sigurimin e ujit për vaditje nuk u mbajt kurrë. Me gjithë marrëveshjen e Ohrit, 2001, ndasitë etnike mes shqiptarëve etnikë dhe sllavëve vijojnë të kenë rëndësi në këtë vend dhe një pjesë e vendasve këto vepra ose projekte i shohin si konspiracion sllav kundër Dibrës dhe shqiptarëve. Mendimi i përgjithshëm ishte se sasia e ujit prej 2.5m³/s, që pretendohet të merret nga Radika për projektin e Lukovo Pole-s, është pjesë e 8m³/sek ujë, rënë dakord në mes Republikës së Shqipërisë (RSH) dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në vijim vetëm RSFJ), nuk pasqyron realitetin, pasi autoritetet jugosllave (maqedonase) sasinë e ujit rënë dakord me vendin fqinj prej 8m³/sek ujë e kanë marrë në vitin 1958. Aktualisht duan të marrin edhe më shumë.

Nga fundi i 2013-s dhe fillimi i 2014-s, opinioni publik në Shqipëri u njoftua më mirë për këtë problem, ndonëse në Maqedoni kishte kohë që protestohej nga grupe të ndryshme ambjentaliste, sidomos për rrezikun ndaj parkut të Mavrovës (Maqedoni), ku pjesërisht shtrihen të dyja këto projekte, dhe kanosjen e biodiversitetit, që u shoqërua me një mori artikujsh në shtypin kombëtar dhe, në disa raste, edhe në programet televizive të stacioneve kryesore të vendit. Me hyrjen në lojë të shoqërisë civile, pakënaqësia kundër projekteve gjeti formën në protesta publike, në rrugë, pasi njerëzit ndjeheshin të prekur për atë që e konsideronin marrje e padrejtë e ujërave, të cilat, normalisht, duhet të rrjedhin në Shqipëri e të derdhen në Adriatik e jo në Egje.

Pozicioni im si inxhinier ujërash, i specializuar për lumenjtë, por edhe i kolegut tim Molnar Kolaneci, i cili do të luajë një rol tepër të rëndësishëm në të gjithë debatin për atë, që, në mes të shqiptarëve, njihet si çështja e Radikës, nuk më lë të qetë. Si ekspertë, bazuar në të dhënat hidrologjike të vjetarëve, të matjeve që kryem vetë në vend, në dy raste, si dhe nga studimi i marrëveshjeve ujore në mes dy vendeve, nuk reshtëm së shkruari artikuj në gazeta dhe së dhëni intervista në televizion. Në të njëjtën kohë ne ishin të vetëdijshëm se argumenti më i mirë për të përcaktuar sasinë e ujit të devijuar nga Radika apo lëshuar nga liqeni i Ohrit, ishin të dhënat hidrologjike të prurjeve mesatare vjetore, shumëvjeçare, prej të cilave ne kishim vetëm një pjesë. Ndaj për një vlerësim të saktë u desh që pjesën tjetër ta kërkonim në arkivat e ish-vendeve të RSFJ-së.

Përpos argumentit hidrologjik, u bë e qartë shumë shpejt se disa nga problemet kryesore të këtyre projekteve cenonin rëndë mjedisin, siç ishte theksuar nga shumë shoqata mjedisore dhe shkencëtarë. Rrezikohej parku i Mavrovës, si dhe shumë krijesave të rralla, psh rrëqebulli i Ballkanit. Arsyetimet dhe

> Devijimi i mëtejshëm i ujit të lumit Radika do të kishte pasoja të dëmshme për banorët vendas të Dibrës si edhe për rregjimin e lumit Drin.

mendimet e shprehura për këto probleme nga specialistë të fushave përkatëse u gjykua që duheshin përgatitur në mënyrë koherente, për t'ia vënë përpara lexuesit shqiptar. Aspekti i legjislacionit, ndërkombëtar dhe kombëtar, për përdorimin e ujërave ndërkufitare ishte një fushë tjetër po aq e rëndësishme sa ai hidrik e ekologjik, gjë që kërkonte një trajtim më vete, në çdo punim shkencor, për të qenë të paanshëm.

Gjithashtu, do të ishte krejt e padrejtë që, për të gjitha aspektet e mësipërme, të paraqiteshin vetëm faktet apo mendimet e palës protestuese. Këto dy projekte energjetike janë pjesë e planeve strategjike për një pavarësi energjetike të Maqedonisë, si dhe për të rritur sasinë e energjisë rinovuese, synime këto që përkrahen nga organizata të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit, si Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, kështu që për hir të së vërtetës u gjykua e nevojshme të kryhej një proces krahasimi e shqyrtimi të dokumenteve dhe argumenteve kryesore të projekteve, për të vënë në dukje të mirat apo dobësitë që ato mbartnin, sipas rastit.

Problemet që shqetësojnë publikun në lidhje me këto dy projekte, Lukovo Pole-n dhe Boshkov Most-in, në varësi të këndvështrimit, paraqiten si shqetësime, që do të cenonin rëndë ekonominë e asaj treve, biodiversitetin e parkut të Mavrovës, si përsa i takon florës, po aq edhe faunës, bujqit dibranë dhe rrëqebullin e Ballkanit. Pakësimi i ujit për tokat bujqësore në Dibër, për hidrocentralet shqiptare do të kishte pasoja të rënda ekonomike këndej dhe andej kufirit. Kështu që problemi i tejkalonte caqet e të qenit një çeshtje e brendshme e Maqedonisë dhe do të shndërrohej në një problem të ujërave ndërkufitare mes atij vendi e Shqipërisë. Për këtë arsye në këtë libër krahas trajtimit të ujërave ndërkufitare u gjykua të pasqyrohej edhe një histori e shkurtër e pozitës gjeopolitike të Republikës së Maqedonisë, nga krijimi i këtij shteti deri në ditët e sotme, duke pasur parasysh se njëra nga grupet etnike kryesore përbërëse të popullsisë së këtij vendi janë shqiptarët.

Ky libër, si një përmbledhje për ujërat ndërkufitare mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, erdhi si revoltë e miratimit të projekteve Boshkov Most dhe Lukovo Pole, për realizimin e të cilëve u mor vendimi për të devijuar më shumë ujë nga Radika, lumi kryesor që do të ndikohet e cenohet nga vendimi i mësipërm. Pjesa kryesore e hidrologjisë është punim shkencor origjinal, që përpiqet të tregojë, në bazë të të dhënave shumëvjeçare, prurjet e Radikës dhe sasinë e ujit të shfrytëzuar, respektivisht, nga pala jugosllave dhe ajo maqedonase.

Pjesa që trajton problemin ekologjik është një përmbledhje analizash, që u janë bërë projekteve nga organizata të njohura mjedisore evropiane, si dhe të dokumenteve e arsyetimeve ku mbështeten ELEM1, Banka Botërore dhe BERZH.

Pjesa e legjislacionit hedh dritë mbi të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare kryesore për përdorimin e ujërave ndërkufitare, që nga konventa e Helsinkit, e vitit 1992, e, në mënyrë më specifike, mbi marrëveshjet konkrete, si ajo e 1962-shit, mes Shqipërisë e Jugosllavisë, apo Memorandumi i Mirëkuptimit për Administrimin e Basenit të Zgjeruar Ndërkufitar të Drinit, e vitit 2011.

Pjesa e fundit, një vështrim i shkurtër për historinë e Maqedonisë dhe të shqiptarëve, që jetojnë në pjesën perëndimore të saj, sjell përmbledhje botimesh nga studiues të ndryshëm të historisë së Ballkanit, siç citohen në bibliografitë e pasqyruara në fund të çdo pjese.

ese

Letër gjyshes me rastin e ditëlindjes...

Dua të bëhem doktoreshë si ti, **Sashenka Nazifi!**

Nga **JERA ISAKAJ**



Portet i dr. Sashenka Nazifit. © Zaim Elezi (Zaya)

... ajo që bën ti nuk është diçka e vogël. Ti ke shpëtuar njerëzish dhe ke qenë aty kur i dhurohet jetë një fëmije të vogël. Ti ke sakrifikuar shumë për punën tënde, për mua, për familjen e shumë të tjerë dhe nuk e kursen asnjëherë mirësinë e dashurinë tënde...

Eshoh fletën e zbrazët, bosh dhe si rrallë herë nuk di se ç'të shkruaj. Kjo me siguri ndodh për shkak se ti më ke mësuar e më ke treguar aq shumë, sa nuk di nga t'ia nis. Ti je një botë më vete plot dashuri, mirësi, thjeshtësi e histori të paharrueshme, të pafundme. Kujtoj në vete ditët e ftohta të dhjetorit, kur jashtë binte shi dhe era frynte e pështpëriste këngë të heshtura. Në ato ditë isha ende i vogël dhe ulesha pranë zjarrit të madh e të nxehtë. Ulesha e qëndroja duke parë flokët magjikë e madhështorë të zjarrit se si kërcenin me njëra-tjetrën derisa faqet më skuqeshin dhe e mbaroja pjatën me mjaltë e me arra që ma përgatisje ti. Si fëmijë që isha, më pëlqenin shumë historitë, sidomos ato të tuat, që i dëgjoja në mjaft kërshëri. Më tregoje me durim zënkat dhe lojërat e nënës dhe dajës. Më tregoje për jetën tënde këtu në Shqipëri, por edhe në Gjermani. Më bëje të qeshja me historitë e Nona Metes dhe lojërat që të bënte Daja Adi më tregoje për punën tënde, pasionin dhe dashurinë që kishe për të. Të gjitha këto e shumë të tjera, i ruaja në memorie si një libër. Edhe sot historitë e tua më duken sikur të mi kesh treguar dje. Por ditët ikin, dhe ajo e djeshme kthehet në vite. Ama kjo gjë s'më mërzit aspak. Çdo që kalon, unë i shtoj faqe librit që kam krijuar në memorie. Faqe plot aventura, si atëherë kur gjatë rrugës për në pishinë, nuk dëgjohej asgjë përveç zërit tim, tëndit dhe të ... që këndonim këngë që m'i mësoje ti. Si atëherë kur më mësove të notoja. Si atëherë kur më krehje e gërshetoje flokët. Si atëherë kur më gatuaje ëmbëlsira që e dije që më pëlqenin shumë. Si atëherë kur më thërrisje "majmunkë" kur bëja zhurmë. Si atëherë kur më merrje poshtë në klinikën tënde e unë ulesha në një karrige që atëherë më dukej gjigante dhe vizatoja në fletët e bardha. Nganjëherë i ndiqja me vëmendje veprimet e tua dhe sillesha vetë si doktoreshë kur ti nuk shihje. Atëherë çdo gjë ishte aq e thjeshtë. Ngrihesha herët në mëngjes dhe e dija që ti ... do të ishit duke më pritur në ballkon. Dilja në ballkon me pizhame e ulesha bashkë me ju teksa ju pinit kafenë e mëngjesit. Tundesha në lisharëse e vendosja që atë ditë do të bëhesha balerinë, e të nesërmen mund të isha ose një astronaute ose një kuzhiniere e mirë si ti. Tani, dhe pse unë nuk e besoj, jam rritur e pas ca vitesh, do të më duhet të bëj zgjedhje që do ta ndryshojnë vërtet jetën time. Shpeshherë kam frikë kur e mendoj se nuk do të marr çdo gjë që dua vetëm duke ia kërkuar mamit e babit, por do të më duhet të punoj fort për të. Besoj se ti e di që ëndrra dhe qëllimi im është të bëhem mjeke. Dhe kjo jo për shkak të emisioneve e filmave aspak real në televizor, por prej tej. Më tregoje se si iu shpëtoje jetën njerëzve. Më tregoje se të gjithë lodhjes e të gjithë djersës që derdhje nuk e bëje aspak për një shpërblim, por për të parë ata njerëz të lumtur. Për të parë atë mirënjohje në fytyrat e të afërmve të tyre. Për të dëgjuar atë fjalë që ne e përdorim vend e pa vend por që mbart një kuptim të madh: "Faleminderit!" Pasi ajo që bën ti nuk është diçka e vogël. Ti ke shpëtuar njerëzish, dhe ke qenë aty kur i dhurohet jetë një fëmije të vogël. Ti ke sakrifikuar shumë për punën tënde, për mua, për familjen e shumë të tjerë dhe nuk e kursen asnjëherë mirësinë e dashurinë tënde. Dhe tani që i rendis këto fjalë, e kuptoj se nuk dua të bëhem thjesht një doktoreshë e zonja. Unë dua të bëhem si ti, e ti je shumë më shumë se aq. Dua të bëhem një grua e fortë që në një farë mënyre, të di si të veproj e se çfarë të them në mënyrën e kohën e duhur. Të përpiqem të çel buzëqeshje në fytyrat e njerëzve e të sakrifikoj për ta. Duhet të jetë shumë e vështirë, por unë shpresoj që një ditë t'ia arrij të kem shumë njerëz që i dua e më duan, si ti. Nuk e kuptoj se si mund të jesh kaq e përsosur e të dish ç'të bësh në çdo situatë. Pra, tani, po të më pyesin, unë dua të bëhem si ti. E mos u shqetëso për vitet që kalojnë kaq shpejt e papritur, pasi kjo thjeshtë do të shtojë faqe e aventura në librin tonë. Ndihem krenare që ti je gjyshja ime. Të dua e të falënderoj shumë për çdo gjë që ke bërë për mua, që kur hodha hapet e parë e deri tani kur po të lexoj këtë libër. Qofsh përjetësisht e lumtur, ky është urimi ynë për ditëlindjen.

Krenari dibrane

Nga **SUELA LALA**

Më bën përshtypje ndjenja e komunitetit dhe sensi i identitetit tek dibranët. Duket se të qenët dibranë, nuk është vetëm tregues i një përkatësie krahinore, por edhe një emërues i përbashkët i vlerave që mbart ky komunitet.

Në botën e sotme gjithmonë e më globale duket se indentiteti krahinor është tashmë i tejkaluar.

Unë, jam lindur e rritur në Burrel, por gjysma e prejardhjes time, dmth babai është dibran. Me lëvizjen e familjes sime shumë vite më parë në Tiranë, na takoi të jetonim në një komunitet me prejardhje të ndryshme krahinore, ndër to një pjesë e konsiderueshme edhe dibranë.

Ndryshe nga jetesa në një qytet të vogël si Burreli, ku njerëzit nuk kanë shumë ndryshime në mënyrën e jetesës dhe në tradita, Tirana është një ansambël komunitetesh me tradita dhe kultura të ndryshme, madje duket sikur ka një përballje midis tyre. Në këtë ansambël, dibranët si komunitet zënë një vend nderi. Si gjysmë dibrane, them gjysmë duke qenë se besoj te barazia në familje e për këtë arsye babai dhe nëna janë njëlloj të vlefshëm, shpresoj të jem disi më e drejtë nëse marr përsipër të argumentoj se pse dibranët kanë vërtet disa vlera.

E para vlerë e rëndësishme për dibranët është vlerësimi që kanë për arsimin. Arsimi është baza e zhvillimit të një komuniteti. Mjafton të sjell shembullin e hebrenjve, megjithëse një komb pa territor, ishte pikërisht përkushtimi i tyre për dijen që i bëri ata të suksesshëm.

Gjyshja ime, nuk jeton më, por peng më të madh në jetë kishte mungesën e arsimimit të saj dhe paaftësinë për të shkruar dhe lexuar. Pavarësisht këtij fakti, ajo qe shtysë që fëmijët përpos varfërisë e nevojës për të siguruar të ardhura sa më parë, t'i orientonte drejt arsimimit. Ky i fundit frytet i ka më të vona. Ashtu si babai, xhahxhallarët e hallat e mia, të cilët nën frymëzimin e gjyshes analfabete por arsimdashëse, unë njoh me dhjetra e qindra dibranë të cilët kanë parësore tek fëmijët e tyre arsimimin maksimal edhe duke sakrifikuar për të.

Njoh shumë vajza e djem dibranë të shkolluar brenda dhe jashtë vendit, të cilët çuditërisht e ruajnë sensin e përkatësisë dibrane, madje edhe dialektin duke e përdorur atë, kuptohet në një rreth më të ngushtë dibranësh. Përveç arsimit, një vlerë tjetër e padiskutueshme është puna, jo punë dosido, por punë cilësore dhe e kualifikuar.

Dibra është ndër të paktat rrethe në Shqipëri që e shfrytëzijnë maksimalisht tokën bujqësore, për të prodhuar produkte që janë të një cilësie siperore. Mjafton të kujtoj këtu qepët e kuqe, fasulet, arrat, mollët, lajthitë etj. të cilat janë vërtet të mira, sidomos kur janë të Dibrës. Kudo ku kanë emigruar dibranët, falë përkushtimit të tyre për punën, kanë ndërtuar një të ardhme të mirë e dinjitoze për familjen e tyre por edhe një emër të mirë për shqipëtarët.

Arsimi i mirë dhe përkushtimi në punë janë çelësi I suksesit. Dibranët e kanë kuptuar këtë gjë shumë më herët se të tjerët, ndaj sot ata janë të shquar veçmas si individë të suksesshëm por edhe si komunitet arsimdashës dhe punëtor.

Në një shoqëri globale ku theksi është te bashkëjetesa dhe ndërvartësia me njëritjetrin duket se ka vend edhe për ruajtjen e një identiteti krahinor, kur ky identitet është shembull vlerash e cilësish të mira të cilat pasurojnë ndërveprimin me të tjerët. Dibranët janë shembull i një krenarie të merituar krahinore.



Suela Lala

Suela ka lindur në Burrel më 05.04.1983. Babai i Suelës është nga Fushë-Muhurri, Dibër. Në moshën 14-vjeçare iu desh të përballej me një dëmtim në shtyllën kurrizore, si rezultat i ngjarjeve të vitit 1997. Si rrjedhojë, Suela është person me aftësi të kufizuar dhe përdor karrike me rrota. Suela ka një diplomë masteri në të Drejtën Publike, nga Universiteti i Tiranës. Ka kryer Akademinë 1 vjeçare të Studimeve Politike të Këshillit të Europës. Gjithashtu është diplomuar në të Drejtë Angleze duke kryer studimet 4 vjeçare në distancë. Suela flet disa gjuhë të huaja dhe punon si eksperte, konsulente, trajnere mbi çështjet e aftësisë së kufizuar për organizata kombëtare e ndërkombëtare dhe për institucione shtetërore.

Rruga e Arbërit nr. 118

Xhafer Martini, i ndihmuar edhe nga profesioni i shkrimtarit,
di si ta paraqesë çdo dukuri me pika takimi sado e vështirë të duket në pamjen e jashtme.

recensë

"Shekspiri dhe Kanuni" - një libër model për të gjithë studiuesit

Nga Dr. **FEJZULLA GJABRI**

Shkrimtari Xhafer Martini, në kuadrin e preokupimeve të tij studimore, kohët e fundit na ka dhënë një libër shumë interesant, i një lloj të veçantë, që për specifikën që ka, hyn në studimet krahasuese të kulturave të ndryshme, për të hetuar shtratin e përbashkët kulturor që mund të jetë Ballkanik, por edhe Evropian dhe më gjerë. Xhafer Martini ka marrë në analizë gjashtë tragjeditë më të njohura të Shekspirit ("Hamleti", "Makbethi", "Jul Cezari", "Romeo e Zhuljeta", "Mbreti Liri", "Rikardi III") dhe i ka krahasuar ato në motive, në ato pika takimi, të plota dhe të pjesshme, me Kanunet Shqiptare. Merita e shkrimtarit qëndron në faktin se ka rrokur një temë të patrajtuar, që ndikon në thellimin e punës për njohjen mëtejshme të kodeve tona zakonore, por, në të njëjtën kohë, na bën më të asimilueshme, më të dashur dhe më aktuale edhe krijimtarinë e Shekspirit, duke dhënë kështu një ndihmesë në studimin e dy kulturave në aspekte të veçanta të tyre. Këto kultura, sado që duken të largëta gjeografikisht, kanë mjaft pika takimi, si për shembull: në mënyrën se si realizohej gjakmarrja ose si kryhej një vrasje, duke pasur parasysh të njëjta rregulla, detyrime dhe sjellje ndaj aktit në fjalë; qëndrimi ndaj nxitjes së gjakut; roli i fantazmave dhe të magjistricave në psikologjinë e jetën e popullit; statusi i lajmëtarit si njeri që u shërben të dyja palëve të konfrontuara; sjellja ndaj mikut dhe armikut; mosveprimi në asnjë rrethanë kundër Nënës; e drejta e secilit për strehim; vetëvrasja dhe filozofia e saj; vrasja në gjumë; truarja e fëmijëve që dëmtojnë rëndë imazhin e familjes dhe të fisit etj.,etj.

Strukturimi i lëndës i ka dhënë mundësi autorit të japë një vepër bindëse për nga ana shkencore, të thjeshtë dhe të kuptueshme për nga ana funksionale. Studimi prihet me një kapitull pak a shumë i gjatë për historinë, kulturën e gjuhën e popullit shqiptar që fillon me Pellazgët dhe, me vazhdimësi dokumentare, nëpërmjet historisë, gjuhës dhe kulturës së Ilirëve,vjen deri në ditët tona, duke u bërë e natyrshme lidhja Pellazgë-Ilirë-Shqiptarë në të gjitha aspektet e saj.

"Vetëm në një pikë të Pellazgëve, që mbetën pa u asimiluar, u krijua kombi shqiptar, e kjo pikë ishte nga dega e Ilirëve... Shqiptarët u krijuan nga Ilirët e lashtë. Gjuha e Pellazgëve të vjetër është gjuha e shqiptarëve" – nënvizon autori. Dhe këtë e bën duke u mbështetur në autorë shumë autoritarë në fushën e shkencës, kryesisht të huaj, si dhe në enciklopedi prestigjioze. Krijimi i bindjeve për këtë kulturë të lashtë dhe gjuhë të lashtë të të parëve tanë është në funksion të forcimit të anës shkencore të veprës, mbasi Pellazgët kanë qenë shtrirë anë e kënd botës, pa përjashtuar nga hapësira e tyre e qarkullimit edhe Amerikën e Jugut. Në këto vende mbahen në kujtesë për mirë të "bardhët e urtë dhe të mençur", siç i konsideronte popullsia e këtij rajoni Pellazgët. Lexuesi, kur mëson se çfarë shtrirjeje kishin Pellazgët në të gjitha kontinentet, kur mëson që gjuha e tyre ishte "gjuhë mëmë" për shumë gjuhë të tjera, kur njihet me kulturën dhe dritën që përhapën ata, nuk i vjen aspak çudi për pikat e shumta të takimit të kulturës sonë, në rastin konkret të Kanunit, me kulturat e tjera, qoftë edhe me veprat e Shekspirit të madh. Autori e njeh mirë organizimin e një vepre shkencore. Ai di çfarë jep, si e jep dhe sa e jep.

Ai nënvizon jo pa qëllim se Shekspiri të gjitha temat për tragjeditë e veta i ka marrë nga kulturat popullore të popujve të ndryshëm, çka nuk përjashton aspak mundësinë që të jenë të të njëjtit fondament me kulturën shqiptare të hershme që i ka rrënjët tek kultura e Pellazgëve dhe Ilirëve. Kështu, si



shembull, lëndën për tragjedinë "Makbethi" Shekspiri e ka marrë nga një kronikë e Holinshedit; për të shkruar tragjedinë "Jul Cezari" është mbështetur tek Plutarku duke kopjuar, siç shprehet Noli, "Jetë Paralele" të autorit të lashtë; lëndën për tragjedinë "Hamleti" e ka marrë nga një sagë daneze, por e ndryshuar dhe e zhvilluar me mjeshtëri; subjektin dhe lëndën për tragjedinë "Romeo e Zhuljeta" e ka marrë nga një legjendë veroneze; tragjedinë "Mbreti Lir" e ka shkruar duke u mbështetur në një sagë angleze të keltëve britanikë. E vetmja tragjedi që ka më shumë bazë historike është "Rikadi III", me historinë ambicioze të luftërave për pushtet midis dinastive të fuqishme feudale të Lankastrit dhe të Jorkut. Siç dëshmohet nga kjo që thamë, Shekspiri për tragjeditë e veta ka shfrytëzuar me gjenialitet një lëndë të madhe folklorike që ka qarkulluar në zona të shumta kontakti me kulturat e tjera që gjithnjë marrin dhe japin midis tyre. Natyrisht, nuk shtrohet problemi në mënyrë naive dhe vulgare: a mori Shekspiri nga kodi ynë zakonor, apo kodi ynë zakonor mori nga Shekspiri. Fundja, kështu edhe nuk ka pse të shtrohet se burimi ka qenë i përbashkët. Kemi të bëjmë me zhvillime të brendshme të kulturave që karakterizohen edhe nga kontaktet me kulturat e tjera, herë në zona fare të ngushta, herë në zona shumë të gjëra. Edhe këto kontakte janë pjesë e zhvillimit.

Gjuha shqipe, megjithëse buron nga pellazgjishtja përmes ilirishtes, është shkruar shumë vonë. Por kjo nuk do të thotë që në këtë gjuhë nuk janë krijuar dokumente të mëdha kulture. Këto janë formuar përmes gjuhës së folur, folklorit. Folklori hynë tek Kanuni që është monumenti më i madh jo vetë juridik, por edhe historik e kulturor i popullit tonë, është enciklopedia e jetës së shqiptarëve që nga muzgu i historisë e deri në ditët tona. Xhafer Martini këtë që sapo thamë, e ka bërë shumë të qartë në veprën prej rreth 500 faqesh "Kanun"(2014).Një popull që ka shkrimin të hershëm, nuk ka përparësi në disa anë nga një popull që e ka të vonë. Kjo sidomos për sa i përket veprave që janë krijuar sipas gjedheve të kulturës popullore. Kështu, sagat e mëdha, franceze, spanjolle, gjermane etj., meqë janë regjistruar herët, me që kanë marrë pamjen shkrimore shumë herët, kanë "ngrirë", kanë përfunduar procesin e limimit dhe të zhvillimit, pasurimit dhe të perfeksionimit. Nga kjo ana kultura jonë popullore, Folklori, Kanuni, kanë përparësi se janë zhvilluar dhe përsosur deri kur gjuha jonë u shkrua.

Shtrirja e lëndës ka një rëndësi të madhe në këtë vepër, çka i jep asaj jo vetëm dimensionin shkencor por edhe e bën të lexueshme dhe të asimilueshme nga shtresa të ndryshme lexuesish. Tragjeditë e Shekspirit shqyrtohen me radhë, sikur i kemi renditur në fillim. Për çdo tragjedi jepet përmbajtja e shkurtër, me mendimin origjinal të autorit duke mos u mbështetur as në introduktet e Nolit dhe në asnjë parathënie të përkthyesve të tjerë. Por, përveç këtij kapitulli që është i njëjtë si formulim, kapitujt e tjerë janë të ndryshëm. Kështu, si shembull, kur shqyrtohet tragjedia "Hamleti", kapitulli i parë është ai me titull "Përmbajtja e shkurtër", pastaj kapitujt e tjerë janë në funksion të qëllimit nga është nisur autori për ta shkruar këtë vepër, d.m.th. të studimit të konkordancave të motiveve, temave, dhe zgjidhjeve tek Shekspiri duke i përqasur këto me temat, motivet dhe zgjidhjet tek kanunet shqiptare. Kapitujt e tjerë janë këto: "Vetëvrasja", "Martesa me gruan e vëllait", "Roli i fantazmave", "Përse shfaqen fantazmat?", "Qëndrimi ndaj nënës", "Beja dhe funksioni i saj". Siç shikohet, të gjitha këto probleme trajtohen edhe në Kanunet Shqiptare. Trajtimi që u bëhet tek Shekspiri, është i njëjtë ose me pak ndryshime. Të marrim si shembull vetëvrasjen. Ajo është e dënueshme si tek tragjeditë e Shekspirit ashtu edhe në praktikën jetësore shqiptare dhe që trajtohet edhe në Kanun. Ndryshimi qëndron në faktin se kundërshtimi i vetëvrasjes në tragjeditë e Shekspirit shkon deri tek mohimi i varrosjes si i krishterë i mirë. Ofelinë, tek tragjedia "Hamleti", nuk e varrosin pa urdhër nga lart, vetëm pse dyshohet që ajo ka vrarë veten. Kurse në kodin tonë zakonor ai që vret veten varroset me respekt si të gjithë të tjerët, në varrezat e përbashkëta. Nëse mbi vdekjen në këtë rast bije një hije e rëndë, kjo nuk është çështje trajtimi. Vetë akti është i rëndë, sepse vetëvrasja gjithnjë është e nëpërgojshme. Autori tregohet mjeshtër në dhënien e këtyre hollësive. Martesa me gruan e vëllait është një zakon që ndodh edhe në tragjedinë e Shekspirit edhe në Kanunin shqiptar. Qëndrimi është i njëjtë: me gruan e vëllait mund të martohesh, por vetëm mbas një viti nga dita e vdekjes së vëllait. Në këtë rast Kanuni Shqiptar nuk lëshon fare pe. Është absurditet që gruan e vëllait të vdekur ta marrë një tjetër pa u mbushur viti. Tek Shekspiri martesa bëhet pothuaj menjëherë mbas vdekjes. Tek tragjedia "Hamlet" ku ndodh një akt i tillë, dënohet martesa e shpejtë e vëllait me kunatën, vetëm e vetëm pse kjo bëhet për të uzurpuar fronin mbretëror. Po të kishte karakterin e një martese të thjeshtë, mbase nuk do të shtrohej me aq forcë. Me pak fjalë, Xhafer Martini shikon jo vetëm përqasjen e plotë, por edhe nuancat më të holla të ndryshimeve. Kjo mënyrë vështrimi e bën studimin shumë interesant. Martini shpjegon në mënyrë shumë mbushamendëse se ku e kanë burimin këto qëndrime të njëjta ose fare pak të ndryshme. Fantazmat luajnë një rol të rëndësishëm edhe në tragjeditë e Shekspirit, edhe në Kanunin shqiptar dhe përgjithësisht në kulturën tonë popullore. Qëndrimi ndaj Nënës është i njëjtë në të dyja kulturat, pra, edhe në veprat e Shekspirit, edhe në Kanunin shqiptar. Beja ka një rëndësi të madhe edhe në tragjeditë e Shekspirit edhe në Kanunin shqiptar. Në veprat e Shekspirit beja më shumë është si fjalë e dhënë, por një element boshtor që ndikon në zhvillimin e ngjarjeve. Tek Kanuni shqiptar beja ka një ndikim më të madh jetësor, sepse bëhet edhe për të kaluarën, edhe për të ardhmen. Beja vendos gjithçka. Përtej besë nuk ka më asgjë, thuhet në Kanun.

Kur merren në analizë tragjeditë e tjera, shqyrtohen problem të tjera që kanë lidhje me konkordancat dhe pikat e takimit. Nuk ka përsëritje. Eliminimi i përsëritjeve, trajtimin e një dukurie në një kapitull dhe vetëm një herë, ka krijuar unitetin e veprës dhe ka ndikuar në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit. Në çdo tragjedi të Shekspirit ka vrasje, madje jo një, por shumë. Nëse do të trajtohej çdo vrasje, studimi do të bëhej jo vetëm i mërzitshëm, por edhe pa sens. Autori vrasjet i ka grupuar në dy kapituj të veçantë: "Fisnikëria e vrasjes" dhe "Filozofia e vrasjes". Në këto dy kapituj jepen të gjitha vrasjet kryesore të tragjedive të Shekspirit duke i përqasur këto me Kaunin Shqiptar parë në dy aspektet që shtruam.

Xhafer Martini, i ndihmuar edhe nga profesioni i shkrimtarit, di si ta paraqesë çdo dukuri me pika takimi sado e vështirë të duket në pamjen e jashtme. Le të marrim si shembull "Këngën e Rexhës " që ndër shqiptarët pothuaj nuk a njeri që nuk e di. Këngë e ka emrin,por në fakt është një baladë e famshme. Këtë krijim e kanë kënduar këngëtarët tanë popullorë nga më të njohur duke filluar nga Nexhmie Pagarusha, Liri Rasha e shumë të tjerë. Është një këngë shumë emocionuese pavarësisht se motivi i saj nuk është aspak heroik, madje është i rëndomtë dhe banal, sepse Rexha vritet nga kali në grazhd. Ky rast, përveçse një fatkeqësi njerëzore, nuk kishte shans të prodhonte një art të pavdekshëm. Këtë bindje e kanë të gjithë dëgjuesit e saj, por pa mundur ta shpjegojnë se si ka ndodhur një gjë e tillë. Xhafer Martini është i pari për mendimin tim që ka shpjeguar me nivel të lartë artistik dhe thellësi mendimi dukurinë artistike që e mban lart këtë krijim. "Kënga është shumë e thjeshtë, - shkruan autori, - por e mbrujtur me filozofinë e të papriturave që sjell jeta, me ato shndërrime të shpejta dhe të befasishme që ndryshojnë tablotë e jetës dhe fatet njerëzore, duke u dhënë atë kahje që nuk e merr dot me mend. Tabloja e parë ka të bëjë me dasmën, që me të gjitha shfaqjet dhe ritualet e saj përbën kulmin e gëzimit dhe të haresë në jetën e njeriut; tabloja e dytë që krijohet me shpejtësi dhe befasi është vdekja dhe morti që vinë papritur në valën e madhe të haresë dhe të gëzimit. Shndërrimet e shpejta dhe të njëpasnjëshme: dasma – në mort, kënaqësia - në dhimbje, gëzimi - në zi, kënga - në vaje, altari - në varr, krijojnë konturet e një tragjedie të madhe si në veprat e Shekspirit. Është ndër krijimet e rralla ku ndeshen dhe përplasen të kundërtat, që jeta i ka në pambarim, por, kur i shfaq ashtu rrëmbimthi, njëra pas tjetrës, kemi aq shumë helm dhe tragjizëm sa nuk e gjen as në fushat e luftimeve ku bien qindra dhe mijëra vetë njëherësh. Fati sikur u thotë njerëzve: ju nuk jeni veçse miza dheu; dua, kaloj pa u shkelur, ose u vë këmbën dhe u humbasë në tokë!" (f. 169, 170)

Ky libër monografik është i çmuar për studuesit, për gjuhëtarët, për historianët, për letrarët, për brezat dhe cilindo që do të lartësojë historinë e vërtetë dhe kombin.

Përpos kësaj thellësie mendimi, studiuesi është i aftë të krijojë përqasjen me veprat e Shekspirit edhe për këtë rast, si për të gjitha dukuritë dhe rastet e tjera. Nuk e krijon me artifice, në mënyrë të sforcuar, por fare natyrshëm sikur veprat e krijuara nga populli shqiptar dhe nga Shekspiri të jenë vazhdimësi logjike dhe artistike e njëra-tjetrës dhe sikur protagonistët dhe personazhet tragjikë të jenë të njëjtët. Tek "Romeo e Zhuljeta" krijohet e njëjta skenë si tek Kënga e Rexhës. Dy të rinjtë, Romeo e Zhuljeta, që sapo kishin vënë kurorë dhe do të martoheshin, vdesin papritur dhe gjithë gazi i zemrave kthehet në helm, gjithë pritja e dëshiruar kthehet në llahtar, gjithë ëndrrat e së ardhmes shkrihen si vesa në diell. Vijojnë edhe në tragjedinë e Shekspirit po ato shndërrime krejt të kundërta që i lënë vendin njëra-tjetrës në mënyrë të papritur që logjika e jetës i pranon, por logjika e njeriut që i provon, nuk mund t\i kuptojë. Ja si shprehet Shekspiri i madh:

KAPULETI:

"Çdo gjë përgatitim për dëfrim,
Tani do na shërbejë për varrim.
Banketi i dasmës, darkë e pështpëritjes
Himnet e shenjta, vaje të përzishme
Lulet e nuses, kurora qivuri.
Të gjitha kthejnë faqen për së prapthi".
("Romeo e Zhuljeta", f. 379)

Siç shikohet, pikërisht "kthimi i faqes për së prapthi", pasqyrimi i të kundërtave, shndërrimet e befta, njësoj si përzierja e helmit me mjaltë, janë ato që shkaktojnë emocione të mëdha njerëzore. Ngjarja është shumë tragjike, se është e ndërtuar mbi kontraste të fuqishme, si: muzika e dasmës me këmbanat e varrimit, banketi i dasmës me kurbanin. Në themel të këtyre shndërrimeve qëndrojnë, nga njëra anë: njerëzorja, tokësorja, realja, jeta, kurse, nga ana tjetër: hyjnorja, qiellorja, universalja, vdekja.

Në vdekjet tona ka ngushëllime fine, elegante, shumë të bukura, por ka edhe qortime kur masa kalohet. Në çdo fatkeqësi duhet të ketë masë. Në këngën e Rexhës ka edhe dy vargje të tillë:

" O ju krushq hani e pini
Nesër në dhe Rexhën ma shtini". Shikoni sa natyrshëm jepen këto vargje që nuk shprehin as urdhër, as dëshirë (se nuk qe një gjë e dëshiruar),nuk shprehin asnjë ndjenjë. Ato janë thjesht një komunikim që kanë kuptimin që të përballojmë çdo gjë që na lëshon jeta mbi supe.

Ngushëllime lapidare dhe qortime për teprim në fatkeqësi ka edhe tek Shekspiri. Ja si u thotë prifti Laurens Kapuletëve që tronditën vendin me vajin e tyre:

"Pushoni, turp! Shërimi i dëshpërimit
Nuk vjen me dëshpërim. Ju këtë vajzë
E kishit bashkë me perëndinë,
Kurse tani e ka qielli
Ju s\mund t\ia mbani vdekjes pjesën tuaj"
(f. 379)

Ngjashmëritë midis Këngës së Rexhës, realitetit shqiptar, dhe atij realiteti që krijon Shekspiri tek njëra prej tragjedive më të famshme, karakterizohen jo vetëm nga tablotë, por edhe përshkohen nga të njëjtat parime estetike.

Janë të pafundme përqasjet midis tragjedive të Shekspirit dhe të Kanuneve Shqiptare. Shembuj janë nga të dyja këto vepra. Ky libër, veç të tjerave, është edhe një antologji e fjalës së zgjedhur, mendimit me peshë, si nga prozat e mrekullueshme shqiptare ashtu edhe nga citimi i vargjeve brilante të Shekspirit. Xhafer Martini ka aftësinë për të zgjedhur tek më e përzgjedhura.

Të gjitha këto sa thamë dëshmojnë se Xhafer Martini është një studies i atij niveli ku shkenca dhe arti bashkëjetojnë në mënyrën më harmonike. Këtë ekuilibër dhe harmoni ai e ka në të gjitha librat e tij studimorë, por te Shekspiri dhe Kanuni e ngre në një lartësi të re.

Shëlliu dhe Gjoka *i Skënderbeut,* *një monografi* **nga Ali Gjoka**

Nga **MEVLUD BUCI**

Ky libër monografik është pasqyrim i traditës dhe kulturës së Shëlliut të Matit. Autori ka pasqyruar të vërtetat historike, traditat, mirësinë, kulturën popullore dhe figurat e shquara të brezave që kanë dhënë ndihmesë në Shëlli, në Mat dhe më gjerë. Libra të tillë janë vërtet minimuze, arkiv dhe vlera të çmuara për kombin dhe brezat që vijnë. Ali Elez Gjoka, geni i fisnikërisë matjane, vëllai i Hysen, Liman, Adem, Kurt, e Skënder Gjokës i motrave Lihe, Mihane, Zebede e Nafie Gjoka, xhaxhai i Liman Gjokës së ri, birit human të Matit, ka pasqyruar Shëlliun, historinë, fiset, varoshin, , betejat për mbrojtjen e varoshit, varrin e mirë, fragmente nga bota historike, këngë për mbrojtjen e varoshit ku thotë midis të tjerash:

Mu n'varosh ke shkami kuq
puqen shpatat shqipe Turq,
shuhet zani i borisë,
thyhet forca e Turqisë.

ky libër pasqyron pozitën gjeografike të Shëlliut, gjurmët e jetës, mëhallat e fshatit, vigjun, pronat, zikzaket e ekonomike, organizimin e familjes, drejtimin e fshatit, ndërtimin e shtëpive, dialektin dhe fjalën e veçantë e plot të tjera, të cilat japin lexuesit, dëshmitë e të vërtetave historike.

Studiusi Gjoka ka pasqyruar në mënyrë mjeshtërore, realiste dhe objektive toponimet në Shëlli-Vig.

Autori na jep thesare të kulturës fisnore ku pasqyron mjaft bukur fiset si Minxhozi, Vani, Çiba, Hysa, Kasmaliu, Alla, Memiu, Nuzi, Koxha, Hoxhosmani, Gjyla, Fiçorri, Neli, Dreni, Brahimeta, Cila, Karaj, Xhura, Mecuçi, Kurti, Gjoka, Cenaj, Beshku, Hysenlika, Mata, Balla, Kurbiba, Karrosi, Ceka, Hysuka, Pupla, Muralika, Buci, Zogu etj.

Autori ka pasqyruar me realizëm drejtuesit e fshatit, mësuesit nga Shëlliu, drejtuesit e kooperativës bujqësore, EmriN Krye-Prell. Autori shkruan:

Po thurr vargje, po thurr lavdi
që t' mos harrohen Shllinjotët e mi
i pikllu me pikat të lotit
si u helmuan Gjoka i Kastriotit
të gjithë krenohen me emrin Shlli
në shqip u shkrua n;Shën-Trini.

Në këtë monografi pasqyrohet historia e Shëlliut, besa e Muralikës, pushtimi osman



Në këtë libër të rrallë monografik pasqyrohet 545 vjetori i shqipes së shkruar, lapidari kushtuar formulës pagëzimit, lufta kundër serbit, lufta në kepin e rojsëve...

dhe roli i Dali Hysës, Shën -Trinia dhe kodiku 37, çfarë shkruan Dilaver Kurti? Ku i paharruari, korifeu i shkencës, studiuesi i talentuar matjan e kombëtar thotë: "Dokumenti më i vjetër i gjuhës shqipe deri më sot njihet të jetë formula e pagëzimit". Në këtë libër të rrallë monografik pasqyrohet 545 vjetori i shqipes së shkruar, lapidari kushtuar formulës pagëzimit, lufta kundër serbit, lufta në kepin e rojsëve, kontribute të veçanta ku pasqyrohet atdhetari Xhemal Hajri (Hysenlika), pasqyrohen Minxhozët si Beqir Minxhozi e fisi i tij atdhetar, Zenel Murati, mësuesi dhe artisti Ramadan Gjoka, lufta për dije, xhamia kult fetar dhe arsimor, Shëllinjakët jashtë Shëlliut, traditat e fshatit, dasmat, argëtimet, këngët, hidhërimet, vargjet e vajit, orenditë shtëpiake, kulti i të parëve, gurrat dhe krojet, mullinjtë e Shëlliut, farkëtari i fshatit mali i Shëlliut, veshjet, lojrat popullore, aksioni i Vigut, fjalë të urta, vlera dhe bukuri të rralla, rrugë Burrel-Lis-Varrosh, fisi Gjoka fakte dhe gojëdhëna, porta e Gjokës, tragjedia e Gjokës, varret dhe vendbanimi i Gjokës së Vigut, gjoka në Shëlli, lidhjet dhe virtytet e fisit Gjoka, zgjerimi i trojeve, trashëgimia gojore e plot të tjera. Ky libër ka vlera të rralla, sepse është vërtet një muze, ku sot muzeumet e krahinave janë të shkretuara, kultura kombëtare ka nevojë që korrigjohet historia dhe studiuesi, intelektuali, Ali Elez Gjoka i Matit na ka dhënë një thesar, një vlerë të çmuar për historinë, për Shëlliun, për Matin, për Kombin, për brezat dhe të vërtetat historike. Shëlliu i Matit ka fise e kulla të cilat janë lavdia e Matit dhe e Kombit. Në Shëlli kanë lindur Beqir, Tahir Minxhozi, e Imer Minxhozit, akademikut, fizikantit e filozofit, humanit të drejtësisë Arsimore Agim Minxhozi, poetit të shquar, Hajnesit të Kombit Hamdi Hysuka, poetit studiuesit e intelektualit të talentuar Qemal Cenaj, të mësuesve të talentuar për mësim dhënje e drejtim si Adem Kasmi e Servet Hysa, të mësuesve të përvojave si Ramadan Gjoka, Ahmet Beshku, Isuf Neli, Lume Dreni, Nafie Gjoka e plotë të tjerë. Shëlliu është vendi i oficerit madhor e studiuesit Ramiz Fiqorri, Ambasadorit të RSH Qemal Minxhozi, gazetarit të talentuar Skënder Minxhozi, të intelektualëve të shquar Sali Kasmi, Hamdi Beshku e Avni Pupla, doktorit të talentuar Zyber Pupla, fshati i Beshkëve, Drenëve, Muratajve, Puplave, Gjokajve e plotë fiseve të shquara për Atdhetari e bujari. Ky libër për nga tematika e faktet, të cilat na i arguenton intelektuali i shquar Ali Gjoka është dhe mbetet një dritare historie, një vlerë e shtuar në botimet kombëtare .

Ky libër monografik është i çmuar për studuesit, për gjuhëtarët, për historianët, për letrarët, për brezat dhe cilindo që do të lartësojë historinë e vërtetë dhe kombin. Intelektuali matjan Ali Gjoka na ka dhënë një libër arkivor, studimor, historik, letrar e mbi të gjitha një thesar për brezat që vijnë, me shpirtin dhe zemrën e intelektualit, me mprehtësinë e studiuesit dhe genin e krijuesit e të atdhetarit të vërtetë. Nderim paç Ali Elez Gjoka i Matit, gen i shqiptarisë, intelektuali i vlerave të demokracisë, të historisë dhe të Matit të fisnikërisë.

OFROJMË

redaktime - korrigjime
- ftesa - fletëpalosje
- fotokopje - kartvizita
- printime - lidhje libri duke
filluar nga 1 kopje e vetme!
Çmime të favorshme dhe
shpejtësi!
Telefono: 068 65 08 441

Ftesë për bashkëpunim

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për vitin e ardhshëm disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.

Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.

Për më shumë informacion mund të shkruani në email
mbbotime@gmail.com, rrugaearberit@gmail.com
ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603.**
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 / 068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>

Familjarë, miq dhe të afërmë e përcollën me të gjitha nderimet që meritonte birin e shquar të Zall Dardhës

Lamtumirë Miftar Ndreu!

Nga **HALIL RAMA**

Para një viti, kur me bashkeautorin Sakip Cami, ishim në përgatitjet e fundit për monografinë "Bajram Ndreu i Zall Dardhës, bir i shquar i një familje të madhe", një tjetër pinjoll i këtij fisi emërndritur, ia shtoi vlerat kësaj monografie. Ishte pikërisht Miftar Ndreu, ky burrë fisnik që unë arrita t'i bëja foton që shoqëron këto pak radhë për të, atë ditë mbresëlënëse. Rrëfimet brilante të këtij simboli të mënçurisë dhe urtësisë dibrane janë ngulitur thellë në memorien time.



PARTIZAN NË BRIGADËN E V-TË SULMUESE

Njohja me Rexhep Dodën, ndikimi i kushuririt të tyre, Dali Ndreu dhe i Faikut dhe Esatit, i futën natyrshëm dhe me bindje në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. U mobilizuan në luftë katër djem nga kjo derë, Selim Hysen Ndreu në Brigadën e IV-t Sulmuese, Bajram Ndreu e Miftar Ndreu në Brigadën e V-të Sulmuese, dhe Sulë Ndreu në Brigadën e IV-t Sulmuese. Sipas dëshmisë së Miftarit (sa qe gjallë): "Para se të rreshtohej në Brigadën e V-të Sulmuese, Bajrami ka qenë rreshtuar me forcat e çetës së Muharrem Bajraktarit. Ishte fundi i vitit 1943 dhe fillimi i vitit 1944, periudhë kjo, kur luftëtari nacionalist, Kolonel Muharrem Bajraktari luftonte i vetëm kundër pushtuesve gjermanë dhe nuk lejonte që Luma dhe Kukësi të pushtoheshin nga gjermanët. Në një nga këto luftime, Bajrami plagoset dhe kurohet në spitalin e Bicajt. Për një kohë të shkurtër, për të marrë vehten, kthehet në shtëpi dhe më pas rreshtohet në Brigadën e V-të Sulmuese" .

SHTËPI KAFEHANE

Para një viti Miftari 90 vjeçar, na rrëfeu se si shtëpia e tyre ka qenë shtëpi kafehane. Shtëpitë kafehane kanë qenë të rralla në Dibër. Ato ishin veti e shtëpive të mëdha dhe të qena. Shtëpia e Hysenit të Dardhës, dhe më pas e Mustafës dhe e Bajramit kanë qenë shtëpi kafehane.

Për ta sqaruar për lexuesin e gjërë, shtëpitë kafehanë nuk ishin lokale me pagesë, sepse të tilla nuk ekzistonin në malësi. Shtëpitë kafehane ishin shtëpi që lironin pjesë të kullës në dimër, bahçet në verë, që njerëzit e thjeshtë, rrugëtarët, vizitorët, miqtë të pushonin dhe të pinin një kafe të mirë, një kafe Stambolli, që e dispononinvetëm shtëpi të tilla me emër.

Njerëz të ndryshëm që i zinte nata, që lodheshin nga rruga e gjatë për në Kukës dhe Mirditë, pushonin dhe pinin kafe pa para. Tingëllon keq kur thuhet pa para sot në kohën e ekonomisë së tregut, por bujaria dhe mikpritja tingëllonin më fort dhe më bukur në ato kohë të vështira, kur kafeja dhe ushqimi i bollshëm ishin luks.

KALVARI I MUNDIMSHËM I FAMILJES NË DIKTATURË. SI I SHPËTUAN INTERNIMIT TË DYTË?!

Pothuajse më shumë se gjysma e familjarëve të fisit Ndreu ishin internuar në Lushnjë, Llakatund, Memaliaj etj. Por qeveria komuniste nuk mund të pajtohej as me gjysmën tjetër të mbetur akoma në fshat në gjendje të goditur dhe pothuajse të paralizuar. Frika se këta (Ndreajt) janë të tmerrshëm për tu riaktivizuar dhe për tu bërë përsëri familje e shquar siç kishin qenë ekzistonte tek pushtetarët vendorë, të cilët pas "rënies" së Ndreajve u kishte ardhur rradha për të drejtuar. Parimi i tyre ishte "shtyj, spiuno Ndreajt dhe familjet e tjera të qena dhe ngrihu në detyrë".

Ata kishin pikasur dhe kishin vendosur që të largonin edhe Bajramin dhe Miftarin, dy ish partizanët dhe ish ushtarakët sepse ata ishin "dikushi" dhe nuk "përballoheshin" nga të paqenët që tashmë drejtonin.

Në mbledhjen e tre fshatrave Zall, Shllesh dhe Laçe kishte ardhur i deleguar, një instruktori i Komitetit të Partisë. Ai tha se Partia dhe Pushteti kishte vendosur që Bajram Ndreu të punonte larg fshatit, në Tartaj dhe Miftar Ndreu në Lashkizë.

Bashkëfshatarët bënë çudi me këtë propozim.

I pari që diskutoi dhe mbajti anën e Bajramit dhe të Miftarit ishte Brahim Kuta (Hoxha).

Nuk ka përse të largohen nga fshati, tha ai. Të qëndrojnë këtu. Ne kemi respekt dhe i duam ata.

Diskutuan edhe dy - tre bashkëfshatarë të tjerë, të cilët edhe ata folën me respekt për Bajramin dhe Miftarin. Pothuajse të gjithë kërkuan që të votojnë për qëndrimin e tyre në fshatin e lindjes, Zall Dardhë.

I deleguari i Partisë, një kuadër nga zona, që e njihte mirë familjen Ndreu, tha se nuk është nevoja për votim, pasi sipas tij dhe sipas parrullës komuniste të asaj kohe, "Partia bën çfarë don populli", dhe meqenëse populli dëshiron që Bajrami dhe Miftari të qëndrojnë, atëherë ato do të qëndrojnë këtu midis jush.

Kështu Bajrami dhe kushëriri i tij, Miftari, i shpëtuan një internimi të dytë edhe më të keq, pasi do tu duhej që të punonin larg fshatit dhe në kushte shumë të vështira, të papërballueshme.

SI UA KTHEU KARTAT E FRONTIT JASHAR MENZELXHIU

Familjen e Mustafë Ndreut, në vitin 1952, pushteti i asaj kohe e shpalli "familje kulaku", ndonëse, dy djemtë e tij, Selimi dhe Bajrami qenë partizanë dhe kjo familje u bë Bazë e Luftës Nacionalçlirimtare! Ndonëse Selim Ndreu ishte dëshmori i parë i Dardhës që kishte dedhur gjakun dhe në moshën 16-vjeçare kishte rënë në altarin e lirisë së atdheut!

Në memorien e Muharrem Ndreut, sot 75-vjeç ruhet e freskët ajo kohë e zymtë, kur po niste rrënimi i kësaj familje të madhe patriote.

"Kur i kishin thënë ish Sekretarit të Parë të Komitetit të PPSH-së, Dibër, Jashar Menzelxhiut se kishin shpallur "kulak" familjen e Mustafë Ndreut, ai i ish përgjigjur lajmësit me ironi: -Po ku do të ulemi ne tanimë në Zall Dardhë?! Kjo për faktin se, si gjatë Luftës NCÇl dhe në vitet e pasçlirimit, dyert e konakut të Mutafe Ndreut ishin të çelura për këdo që vinte në Zall Dardhë në emër të interesave të dernjanëve dhe për miqtë e udhëtarët e shumtë që i zinte nata në Dardhë".

Kishin kaluar shtatë vjet, - kujton Muharremi, kur Jashar Menzelxhiu kishte porositur Nebi Ndreun: I thuaj Bajramit të na dërgojë një letër! (Kjo me gjuhën e Dibrës....). Dhe të nesërmen në mëngjez, kur ish sekretari i parë po dilte nga shtëpia e tij për në punë, tek dera e shtëpisë ndeshet me Bajram Ndreun!

Pa u përshëndetur sipas zakonit, Jashari i thotë Bajramit: - Hë, a e solle letrën?!

Pas një jave, në Dardhë vjen Banush Goxhaj – ish Kryetar i DPB të rrethit Dibër për t'i sjellë kartat e Frontit familjes së Mustafë Ndreut, çka nënkuptonte se me urdhër të partisë, ajo nuk do të ishte më familje "kulaku". Por Mustafa, me urtësinë dhe mençurinë e rrallë që e karakterizonte, nuk e pranon këtë akt formalisht, ndaj dhe këmbënguli që dhënia e kartave të frontit të bëhej në një mbledhje të zgjeruar të popullit të Dardhës. Por edhe pse ky akt nënkuptonte çuarjen në vend të dinjitetit të kësaj familje, Muharremi kujton persekutimin e gjatë 40-vjeçar nga ish sigurimsat e regjimit ogurzi, kur ua mbajtën çekiçin mbrapa kokës të gjithë djemve të familjes, duke ua kujtuar në vijimësi nofkën "kulak". Më shumë se kushdo, pasojat e këtij regjimi, ndër më gjakatarët që ka njohur historia e njerëzimit, i vuajti Bajram Ndreu, por edhe kushëriri i tij, Miftari, i njohur për mençurinë dhe vizionin e tij perëndimor për jetën dhe atdhedashurinë e zjarrtë. Dhe megjithë vështirësitë e shumta gjatë sistemit diktatorial, ai krijoi një familje të mrekullueshme, e nderuar dhe e respektuar jo vetëm në Dardhë, por në krejt Dibrën.. dhe tani së fundi në Pakuqan, Kamëz, Tiranë e gjetkë.

Ndarja e tij nga jeta para pak ditësh më shkaktoi vërtetë dhimbje të thellë, ashtu si edhe mijëra familjarëve, miqve dhe të afërmve të tij, që e përcollën me të gjitha nderimet që meritonte birin e shquar të Zall Dardhës.

Parajsa qoftë vendbanimi i tij i përjetshëm!

Requiem për mësuesin, mundësin e Korabit dhe pushtetarin e Okshtunit, **Mentor Moglica**

Nga **SAKIP CAMI**



Në mëngjesin e 8 shkurtit 2016 në shtëpinë e tij në Lagjen Kodra e Kuqe, në Babrru, Tiranë u nda nga jeta mësuesi, mundësi, ish-pushtetari i Okshtunit, stërnipi i patriotit shqiptar Hasan (Hoxhë) Moglica, Mentor Moglica.

Një sëmundje kanceroze në stomak i mori jetën parakohe. Mentori la pas një djalë, Jurgenin dhe katër vajza, Edlirën, Elonën, Elvinën dhe Vilmën. Poashtu, ai ka lenë nga pas bashkëshorten Lefterie, nënën Hide, motrat Violeta, Lindita, Shkëndije dhe vëllezërit Fidajet, Aqif, Bardhyl, Elliott-Hasan si edhe pesë nipër e mbesa (Ervis, Ridi, Xhesika, Amada, dhe Asja).

Mentori u lind në Moglicë të Okshtunit/Dibër (tashmë Moglicë, Elbasan) më 1 dhjetor 1953 në *'Kullën Moglica'*. Ai rrjedh nga një familje atdhetare që ka bërë gjithcka për cështjen Kombëtare. Ai kishte dashuri të madhe për kombin shqiptar, për arsimin, sportin, dhe për gjithë njerëzit - dhe si i tillë ai ishte vëllai i të gjithëve.

Si stërnip i burrit të madh Hasan (Hoxhë) Moglica (1854-1915) – Mentori e mbajti të ndezur pishtarin e diturisë. Ai ndoqi dhe mbaroi studimet e larta në fakultetin e Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër në degën Matematike-Fizikë në vitin 1974-1978 duke u titulluar *mësues*. Më pas, ai punoi mësues në Ternovë dhe Okshtun të Dibrës si edhe Paskuqan, Kamëz dhe Zallherr të Tiranës. Mentori i shërbeu arsimit shqip për afërsisht 34 vite me punë dhe përkushtim (mesues dhe drejtor shkolle).

Gjithashtu, populli fisnik i Okshtunit e nderoi Mentorin duke e zgjedhur edhe Kryetar të pushtetit lokal për rreth katër vitesh. Kështu që, besimin e marrë ai ju'a shpërbleu me përkushtim, punë të palodhur dhe respekt. Për punën e tij të ndershme, ai eshte nderuar me nje sërë certificatash dhe titujsh nderi.

Mentori ishte jo vetëm mësues i përkryer dhe nderuar por edhe mundës i shquar. Ndërsa ndiqte studimet universitare në Shkodër ai u aktivizua me ekipin e Vllaznisë së Shkodrës. Më pas ai përfaqësoi ekipin e Korabit duke u kthyer në një mundës i shquar i Dibrës. Si rezultat, Shoqata Kombëtare e Mundjes Shqiptare, Klubi Sportiv Korabi, Bashkia Peshkopi, e kanë nderuar Mentorin me këto tituj: "Nderi i Mundjes Shqiptare", "Nderi i Mundjes Dibrane", dhe "Nderi i Klubit Sportiv Korabi".



Mentori jo vetem nuk ju nda mësimdhënjes, sportit, gjuetisë, por edhe veprimtarisë Atdhetare. Në mënyrë të vazhdueshme ai ka dhënë kontributin e tij në komunitetin e zonës dhe për mbështetjen e aktiviteteve atdhetare në Dibër dhe në vecanti të zonës së Gollobordës. Në vitin 2015, me rastin e 100 vjetorit të Masakrës në Fushë të Klenjës, ai kontriboi finaciarisht për organizimin dhe ngritjen e Memorialit përkujtimor për nder të dëshmorëve të rënë në luftën ndaj pushtuesve serb.

Me veprimtarinë e tij atdhetare, Mentori ka nderuar babagjyshin e tij, Hasan (Hoxhë) Moglica, gjyshin e tij Osman Moglica - nxënës i parë i Shkollës Normale në Elbasan dhe mësues, babain dhe nënën, motrat dhe vëllezërit, mbarë Moglicën, Okshtunin, Gollobordën, Dibrën dhe më gjerë.

Me 9 shkurt qindra veta përcollën me dhimbje të thellë në banesën e fundit në varrezat e Kodrës së Kuqe në Tiranë, babain, vëllain, bashkëshortin, gjyshin dhe mikun e zemrës, Mentor Moglica.

Mentori iku por pishtari i mësueserisë nuk është shuar në familjen Moglica qysh prej shekullit të 19-të. Vajza e tij, Vilma, punon mësuese në Tetove Maqedoni.

Vëllai i Mentorit , poeti shqiptaro-kanadez Elliott Moglica, jep mësim në Toronto, Kanada. Në mërgim, poeti e perjetoi me dhimbje të thellë vdekjen e parakoshme të vëllait, i ulur në buzë të liqenit të Ontario-s, në Toronto/Kanada, duke shkruar vargje dhimbjeje :

Unë e ndjej që po m'shikon
prej n'hava,
Ndaj erdha n'buzë t'liqenit
me të qa,
Mali i mërgimit për vite na ka nda,
Përjetë të kam në zemër, o vëlla.

Intelektuali i shquar dibran, Zenel Sula jetoi dhe u nda nga jeta duke mbetur i paharruar në jetë të jetëve në Dibër dhe më gjerë.

Zenel Sula, *portret i njeriut të ditur*

Nga **SHEMSI MANJANI**

Më 31 janar 2016, në moshën 85 vjeçare, ndërroi jetë intelektuali i shquar dibran, Zenel Sula, duke lënë në pikëllim të thellë familjen e tij, dy fëmijët, të kthyer urgjent nga Gjermania, për të qënë pranë tij dhe mamasë së tyre në momentet e fundit të jetës, së bashku me të afërmit që e deshën kaq shumë. Me dhimbje u prit kjo humbje e madhe nga të gjithë ata që e njohën, që punuan e drejtuan me të, ish nxënësit e shkollës pedagogjike dhe ne mësuesit e saj, përfshi dhe disa mbi tetëdhjetë-vjeçarë, që kanë qënë pranë tij në jetë. Mbi tetëdhjetë-vjeçarë që kanë mbetur si lisa të gjatë të rralluar, të përmalluar për njëri-tjetrin, të respektuar e të nderuar nga ish-nxënësit e pedagogjikes në Dibër, shkollë e quajtur si "Universiteti i Zonës Verilindore". Është shkolla ku Zeneli ishte nxënës, mësues e drejtor, gjithmonë mbi ne të tjerët për aftësitë e tij dhe vyrtytet e shumta që rrallë mund të jenë të grumbulluara tek i njëjti person, i njëjti kuadër, si tek ai.

Unë, një nga njohësit më të mirë të tij nga vitet e shumta që kemi qënë pranë, përfshi dhe vitet kur ai ishte punonjës në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës dhe unë në seksionin e Arsimit dhe Kulturës në Dibër, me kurajo, *shpreh konsideratën, se ai, të gjitha etapat e jetës i kaloi me një shkëlqim të veçantë. Kurajo kjo e mbështetur dhe te opinioni i shëndoshë për të në vite dhe njohur nga ne"*.

Djaloshi zerqanas, Zenel Sula, i lindur në vitin 1931, i dalluar në mes të fëmijëve të vendlindjes do të gjendej në një nga konviktet e para që u hapën pas Luftës, me bursë, në atë të Normales së Elbasanit. Aty qëndroi vetëm një vit, për të ardhur në konviktin e Peshkopisë, të hapur në vitin 1946 e për të vazhduar më pas Pedagogjiken, së bashku me shumë nxënës të tjerë nga Dibra, zona verilindore apo ndonjë rreth tjetër. *Siç kujton vetë Zeneli, hapja e Pedagogjikes u prit plot entuziazëm jo vetëm nga nxënësit e Unikes (kështu quhej shkolla 7-vjeçare), por nga mbarë populli*. Rezultatet shumë të mira të tij e të shokëve të klasës së parë, para se gjithash, u dedikohen mësuesve të parë, Rexhep Kadzadei, Pandi Cici (të dy ish drejtorë), Jorgji Sinjarit, Shefik Osmanit, Ali Demetit, Yrish Selfos, Kleanthi Qendros, Llazar Mbreshtanakut e të tjerëve, pa lënë në harresë kujdesin prindëror të drejtuesve të konviktit. Ata ngjallën dëshirën për dije e kulturë, rrezatonin dashuri, mirësi, urtësi, dhe një bagazh vlerash që ndikuan në pasurimin e botës shpirtërore...

Vetë Zeneli është konsideruar nga ne si nxënësi më i shquar i Pedagogjikes në çdo drejtim.

Ish shoku i tij i klasës, Shefqet Hoxha nga Kukësi, gjithashtu i shkëlqyer, sot kujton: "*Në mes të shokëve të klasës sonë dallohej Zenel Sula për inteligjencen dhe karakterin e tij. Ishte djalë i qeshur, gjakëmbël, i dashur me të gjithë, nuk nxehej kurrë, megjithëse skuqej në fytyrë. Lexonte libra, prandaj shprehej qartë e bindshëm me gojë e sidomos me shkrim. I pëlqente letërsia, shkruante vjersha e hartime të mira, të cilat na i lexonte profesori në klasë. Në konkurset letrare, zakonisht zinte vendin e parë. Qe organizator i mirë i aktiviteteve jashtëshkollore, sidomos i mbrëmjeve kulturore e të vallëzimit. Këto cilësi ai i ka ruajtur dhe më vonë, prandaj për mua ka mbetur burrë i mirësjellë dhe i nderuar, një dibran për tu pasur zili, një shok dhe mik besnik*".

Zeneli, pas mbarimit të shkollës Pedagogjike, për rezultatet e tij të shkëlqyera si



Zenel Sula

dhe për prejardhjen familjare, një familje patriotike e arsimdashëse, shumë e nderuar, u dërgua, si i pari dhe i vetmi nga Dibra në atë kohë, për studime të larta në ish B.S në degën gjuhë-letërsi ruse, siç e kishte kërkuar, nisur nga përkushtimi dhe prirja në këtë lëndë që në Pedagogjike. U dërgua dhe me interesimin e posaçëm të Ministrit të Arsimit të asaj kohe, Kahreman Ylli, që pati rastin ta dëgjojë në një nga provimet e maturës. I kapërceu shpejt vështirësitë e fillimit të gjuhës në sajë të një pune sistematike, këmbëngulëse si dhe ndihmës së shokëve rus të grupit, të cilët krijuan shpejt simpati për të. Zeneli u dallua që në provimet e para që pasuan me përfundimin e studimeve në mënyrë të shkëlqyer. Veç mësimeve i takoi të përkthente dhe në Shkollën e Lartë të Partisë dhe të ishte shoqërues delegacionesh nga Shqipëria. Dha mësim të gjuhës shqipe në Bibliotekën Kombëtare, në Radio-Moska, etj. Në pranverën e vitit 1956 u gjend para një rastësie të çuditshme: Takohet përsëri me Kahreman Yllin që tani drejtonte problemet e arsimit në K.Q të Partisë. Porosia e tij, për ata që mbaronin studimet, ishte të merrnin sa më shumë literaturë, se do të punonin në Institutet e Larta dhe Universitet, ku këta do të ishin ndër kuadrot kryesorë. Zenelin e kishin projektuar në një nga institutet e larta si pedagog të letërsisë, por ndodhi një ndryshim i papritur. Një kërkesë këmbëngulëse e shokëve të Peshkopisë e çoi në Peshkopi, në shkollën Pedagogjike si mësues. E filloi punën me zell edhe pse iu ndërpre puna më me perspektivë si pedagog në fakultet. Si mësues e drejtues la përshtypje të veçantë me kërkesa ndaj vetes e pastaj ndaj nxënësve, kolegëve të punës, drejtuesve e punonjësve të tjerë të konviktit. Që në fillim iu ruajt diktatit, apo urdhërit arrogant në marrëdhëniet me punonjësit. Konsultohej për çdo gjë. I pëlqente të rrinte me ta e të bënte biseda serioze me karakter shkencor, filozofik, artistik, sportive etj. Zgjidhi shumë probleme për shkollën e konviktin të pazgjidhura deri në atë kohë. Të gjithë e admironin. Nxënësit, që në fillim, krijuan përshtypjen më të mirë për të si mësues e drejtues. Po kështu edhe prindërit, qytetarët e Peshkopisë e kuadrot drejtuese në rreth. Pas disa vitesh me ra rasti të njihem me një vlerësim të ish nxënësit të tij, Xhaferr Martini, shkrimtar i njohur i cili perifrazonte: " *Tek Zeneli ishin shkrirë në një dhe shfaqeshin kurdoherë bashkë, përgatitja e lartë shkencore me metodikën e shprehjes, mendimi i kthjellët me pasionin e zjarrtë, natyrorja me të kultivuarën, tradicionalja me modernen, e madhërishmja me të thjeshtën, çlirimi i energjisë me sensin e ruajtjes së masës, inteligjenca me vullnetin, sinqeriteti me dashurinë dhe mbi të gjitha aftësia e tij e rrallë për të krijuar marrëdhënie të ngrohta njerëzore, si bazë për të ruajtur harmoninë, ekuilibrin dhe zhvillimin e lirë të personalitetit të njeriut*"...

Nuk mund të lihet pa përmendur përpjekja që bëri për të pranuar në Pedagogjike disa nxënës të shkëlqyer, me biografi të keqe. Për këtë u lidh me drejtuesin kryesor të Rrethit, Jashar Menzelxhiun, i cili kishte konsiderata të jashtëzakonshme për drejtor Zenelin. Kështu veproi dhe për disa nxënës të Medresesë të zgjedhur, duke dhënë provime plotësuese. Një kritikë që iu bë për këtë, nga një ekip kontrolli i Ministrisë do të merrte përgjigje të tillë nga ana e Zenelit:"*Një hoxhë më pak e një mësues më shum*ë", përgjigje që i pëlqeu shumë Ministrit të Arsimit të asaj kohe.

Pas Pedagogjikes punoi një vit në Shkollën Bujqësore, pak kohë, Shef i Seksionit të Kulturës të sapokrijuar, që u shkri sërish, si dhe një fare kohe në gazetën "Bashkimi", duke përfunduar në Ministrinë e Arsimit e të Kulturës, me interesimin direkt të Ministrit të Arsimit të asaj kohe, fillimisht inspektor i kulturës masive, pastaj shef i sektorit të Punës me Librin. Kudo, por veçanërisht në Ministri puna po i ecte mire. Veç punës së zakonshme të sektorit, përgatiste materiale të ndryshme për ministrin apo instancat më të larta. Aty dhe u dekorua si një ndër punonjësit më të mire, gëzoi respekt të vecantë, u zgjodh dhe me detyra të tjera drejtuese. Pikërisht në kohën kur në të gjithë sektorët e Ministrisë punët po ecnin mirë ndodhi përmbysja e madhe...Sistemi filloi të mos qëndronte në këmbë. Duheshin gjetur armiq. Nisur nga disa gabime të njërit nga kuadrot kryesorë të kulturës, ku Zeneli ishte sekretar organizate, dënohen 28 kuadro të Ministrisë, te cilët zëvëndësohen nga kuadro të tjerë, disa të ardhur nga klasa punëtore. Zeneli u largua nga institucioni vetëm për "mungesë

Tek Zeneli ishin shkrirë në një dhe shfaqeshin kurdoherë bashkë, përgatitja e lartë shkencore me metodikën e shprehjes, mendimi i kthjellët me pasionin e zjarrtë, natyrorja me të kultivuarën, tradicionalja me modernen, e madhërishmja me të thjeshtën, çlirimi i energjisë me sensin e ruajtjes së masës, inteligjenca me vullnetin, sinqeriteti me dashurinë dhe mbi të gjitha aftësia e tij e rrallë për të krijuar marrëdhënie të ngrohta njerëzore, si bazë për të ruajtur harmoninë, ekuilibrin dhe zhvillimin e lirë të personalitetit të njeriut"...

vigjilence", veprim që u bëri përshtypje të gjithëve. Kjo ndodhi pak kohë pasi Rektori i Universitetit i ishte drejtuar Ministrit të Arsimit për t'ia dhënë Zenelin për pedagog në Universitet. Në atë kohë Zeneli, krahas punës në Ministri, jepte leksione si pedagog i jashtëm në Institutin e Arteve.

Ndjemë shumë dhimbje për dënimin dhe largimin e padrjetë të Zenelit nga Ministria, dhimbje që u ndje dhe nga të gjithë punonjësit e tjerë në Minsitri. Për tu përmendur është fakti se gjatë atyre ditëve në ambientet e Ministrisë si dhe jashtë tyre apo dhe nga vetë disa të dënuar përsëritej shprehja: " *Po me Zenelin ç'patën* ?!...

Në 80-vjetorin e lindjes së Zenelit së bashku me pedagogjikasit Xhetan Strazimiri e Xhavit Lashi, organizuam kremtimin e kësaj date me ish mësues e nxënës të Pedagogjikes. Në atë drekë për tu mbajtur mend, përshëndetën disa prej tyre duke përdorur superlativa për Zenelin. Nga Ministria, ish kuadër në ato vite me Zenelin, u ftua dhe i nderuari dhe i mirënjohuri dhe sot Z. Fadil Kepi, i cili përshëndetjen e tij të shkurtër e përfundoi me fjalët : " *Në Ministri në vite kemi pasur disa Dibranë, por Zeneli ishte i vecantë*".

I dënuar, i përjashtuar nga Partia, u dërgua si mësues në një fshat, në Kurdari. Të denuarit e tjerë, sidomos drejtuesit e Ministrisë edhe më keq. Goditje e rëndë, shumë e pamerituar për Zenelin. Në Burrel e gëzoi shumë pritja e mire e fshatarëve te Kurdarisë. Puna e tij si mësues e sidomos ndihma e dhënë për aktivitetet kulturore e artistike filloi të krijojë përshtypje e trajtim tjetër.

Pas një rehabilitimi u bë propozimi për t'u kthyer pranë fëmijëve, por dokumentet, siç thotë Zeneli, ia ktheu prapë Ministria. Me insistimin e drejtorit të Shtëpisë Botuese, Thanas Leci, ndihmës vendimtare të Haxhi Lleshit, u emërua definitivisht këtu, ku prej kohësh kishte punuar si recezent apo redaktor i jashtëm. Në Shtëpinë Botuese studoi e redaktoi dhjetëra vëllime, punoi me autorë te shquar, si Sterjo Spase, Ali Abdihoxha, Sulejman Krasniqi, Teodor Laço e shumë të tjerë. Në vitin 1991 doli në pension. Gjithcka që mundi të bëjë e bëri. Duke perifrazuar thënien e një filozofi të shquar, Zeneli, thekson: "*Nuk kam bërë as sa një të njëqindën e asaj që mund të bëja*".

Me pak fjalë dua ta mbyll këtë shkrim, duke ritheksuar se: "*Intelektuali i shquar dibran, Zenel Sula jetoi dhe u nda nga jeta duke mbetur i paharruar në jetë të jetëve në Dibër dhe më gjerë*".

Rruga e Arbërit nr. 118

Letër për lexuesit!

Një pajtim vjetor, si deri më tani kushton 600 lekë. Nëse paguani 1000 lekë, ju mund të merrni kopjen fizike dhe atë elektronike në email.

I nderuar lexues,

Duke Ju uruar një Vit të Mbarë, do të donim t'Ju prezantonim me gazetën "Rruga e Arbërit".

Ju mund të keni pasur rast të takoheni me gazetën edhe herë të tjera më parë. Ne shpresojmë që ajo të jetë e pëlqyeshme për ju!

Gazeta "Rruga e Arbërit" këtë vit mbush dhjetë vjet nga dalja e numrit të saj të parë, dhe çdo muaj përcjell informacione, komente, opinione, reportazhe, recensa dhe rubrika të tjera për artin, kulturën, historinë etj.

Gazeta është një botim i pavarur dhe këtë e ka dëshmuar gjatë këtyre dhjetë viteve me integritet dhe profesionalizëm.

Siç ju mund ta dini, gazeta të vetmet burime financiare ka pajtuesit e rregullt të saj dhe botuesit e gazetës, të cilët mbulojnë shpenzimet mujore. Për vazhdimësinë e botimit të saj, me të njëjtin përkushtim, paanshmëri e profesionalizëm, në Ju ftojmë të pajtoheni, duke e vlerësuar këtë si një kontribut Tuajin të rëndësishëm.

600 lekë në vit

Do ta vlerësonim ndihmën tuaj nëse ndikoni edhe te miqtë, kolegët apo të afërmit, në mënyrë që edhe ata të vepronin njësoj si Ju.

Gazetën në jua sjellim pranë shtëpisë suaj kudo në Tiranë dhe Peshkopi.

Me këtë rast, dëshirojmë t'ju theksojmë se jemi gjithmonë të hapur për sugjerimet tuaja, jo vetëm në trajtimin e tematikave që ne shkruajmë, por edhe për të shkruar mbi veprimtari, individë apo organizata që veprojnë, kontribuojnë apo kanë lidhje me qarkun e Dibrës.

Gjithashtu, gazeta ofron faqet e saj për njoftime apo reklama të ndryshme. Pajtuesve në gazetë ju jepet mundësia të bëjnë njoftime falas gjatë vitit. Ne ofrojmë zbritje të konsiderueshme për ata që bëjnë reklama apo njoftime me qëllime promocioni.

Një pajtim vjetor, si deri më tani kushton 600 lekë. Nëse paguani 1000 lekë, ju mund të merrni kopjen fizike dhe atë elektronike në email. Ju lutem, mos paguani nëse nuk pajiseni me një faturë.

Për më shumë informacion, ju lutem mos hezitoni të na shkruani në email **<rrugaearberit@gmail.com>** ose të na telefononi në numrin **068 65 08 441.**

Për pajtime telefononi ose shkruani mesazh në **WhatsApp** dhe **Viber** në numrin: **068 46 63 270.**



Gazetën **Rruga e Arbërit** mund ta gjeni edhe në internet në adresën **www.rrugaearberit.com,** tashmë me disajn të ri.
Faqja në web është kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit" dhe lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër nga z. Agim Deva.

Kërkohen korrespondentë/menaxherë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Gazeta "Rruga e Arbërit" kërkon korrespondentë dhe menaxherë zyrtarë për **PESHKOPINË** dhe **DIBRËN E MADHE**.
Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin **069 20 68 603.**

Redaksia

Delegacioni i Bashkimit Evropian

eco nord project

This project is funded by the European Union

ALBANIAN LOCAL CAPACITY DEVELOPMENT FOUNDATION

Thirrje për aplikime

Fondacioni Shqiptari i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale (ALCDF), ne kuadër të projektit "Rritja e kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Shqipërinë e Veriut për përmirësimin e biodiversitetit dhe mbrojtjes së mjedisit" – projekti **EcoNord** - që financohet nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri si pjesë e programit "Instrumenti për Shoqërinë Civile – Iniciativat Civile dhe Rritja e Kapaciteteve, Shqipëri, hap raundin e dytë të thirjeve për grantet e **Fondeve të Iniciativave Lokale.**

Ftohen të aplikojnë ***organizatat e shoqërisë civile aktive lokale*** nga Shqipëria e Veriut (respektivisht në qarqet Dibër, Kukës, Shkodër dhe Lezhë) që punojnë apo sjellin zgjidhje për çështje mjedisore dhe biodiversitetin. Gjithashtu mund të aplikojnë grupet prodhuese dhe komunitare të formalizuara si Shoqatat e pyjeve, të vaditjes, bimëve mjekësore, bujqësisë, bletarisë, etj., nga Shqipëria e Veriut.

Projekt – propozimet do të pranohen të dorëzuara dorazi deri më datë 23 Mars 2016, në orën 17:00, tek zyrat e ALCDF në adresën që jepet më poshtë:

Albanian Local Capacity Development Foundation (ALCDF)
Rr. Shyqyri Ishmi, Pallati Shpresa
(mbrapa shkollës së Baletit), Ap. 24/4
Tiranë, Shqipëri.

Për informacion të detajuar vizitoni faqet e internetit të ALCDF **www.alcdf.org**, ku eshte dhënë linku me guidën e aplikimit, kriteret, afatet kohore, formatet e aplikimit dhe kontaktet.

Gjithashtu mund të kontaktoni nëpërmjet e-mail Zj. Lindita Manga, Menaxhere Projektit EcoNord **lmanga@alcdf.org**; dhe Z.Besnik Alku, Kordinator i Fondit të Iniciativave Lokale: **balku@alcdf.org .**